



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 187

Tiranë – E hënë, 6 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 3.12.2021	Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar..... 16853
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 23, datë 1.12.2021	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”..... 16861
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 368, datë 23.11.2021	Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit, për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridike e fizike, formatin e regjistrimit për armët dhe municionet, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash..... 16862
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 4.11.2021	Kërkesa nr. 616/16, Dorian Matlija kundër Shqipërisë..... 16891
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 1.11.2021	Me objekt konstatimin e shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile nr. 11118-02028-00-2016 akti, datë regjistrimi 15.6.2016 dhe të çështjes nr. 7 regjistri, datë 30.12.2020, në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura. 16892

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 1.11.2021	Me objekt konstatimin e shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes administrative nr. 31003-00307-00-2018 akti, datë regjistrimi 7.2.2018 dhe çështjes nr. 8/3 regjistri, datë 18.9.2020 në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.....	16901
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 37, datë 5.11.2021	Me objekt konstatimin e shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj, konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes administrative me nr. 31003-03330-00-2017, regjistruar në datën 10.11.2017, në Gjykatën e Lartë dhe konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.....	16913
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 60, datë 24.11.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”	16928
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 24.11.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”	16930
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 62, datë 24.11.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”	16933
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 63, datë 24.11.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare, dhe për transportin e vlerave monetare”	16933
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 64, datë 24.11.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”	16934
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 559/4, datë 1.12.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 13.6.2013, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Tiranë–Elbasan’”	16935
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 560/4, datë 1.12.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Tiranë–Elbasan’ (shtesa)”	16937



AKT NORMATIV
Nr. 34, datë 3.12.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT
2021”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Nenet 1, 2, 3 dhe 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2021 është:

Të ardhurat	507 727 milionë lekë;
Shpenzimet	628 269 milionë lekë;
Deficiti	120 542 milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2021 është:

Të ardhurat	373 746 milionë lekë;
Shpenzimet	494 288 milionë lekë;
Deficiti	120 542 milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2021 është:

Të ardhurat nga të cilat:	
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	57 940 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	18 480 milionë lekë;
- transferta specifike për shlyerje detyrimesh	8 206 milionë lekë;
	500 milionë lekë

- transferta specifike për menaxhimin e mbetjeve urbane	39 milionë lekë;
- transferta specifike për emergjencat civile	564 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	30 151 milionë lekë;
Shpenzimet	57 940 milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2021 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta:

Të ardhurat, gjithsej	141 633 milionë lekë;
nga të cilat:	
- kontributet	89 340 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	46 573 milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	2 220 milionë lekë
- bonusi i pensionistit	3 500 milionë lekë;
Shpenzimet	141 633 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2021, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej	
nga të cilat:	7 532 milionë lekë;
- kontributet	1 931 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 421 milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	180 milionë lekë;
Shpenzimet	7 532 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 400 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.



Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 500 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Nga teprica e të ardhurave dhe fondi rezervë i sigurimeve shoqërore përdoren 4 000 milionë lekë për financimin e shpenzimeve si më sipër.”.

Neni 2

Paragrafi i parë, i nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2021 është:

Të ardhurat, gjithsej	
nga të cilat:	46 136 milionë lekë;
- kontributet dhe të tjera	15 084 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	31 052 milionë lekë;
Shpenzimet	46 136 milionë lekë.”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve, për vitin 2021, është:

Të ardhurat, gjithsej	
nga të cilat:	2 700 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	1 700 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	1 000 milionë lekë;
Shpenzimet	2 700 milionë lekë.”.

Neni 4

Në nenin 7, shifra e fondit të rindërtimit ndryshohet dhe bëhet “... 35 000 milionë lekë ...”.

Neni 5

Nenet 9 dhe 11 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Grantet	19 353 milionë lekë;
- Të ardhurat tatimore	332 793 milionë lekë;
- Të ardhurat jotatimore	21 600 milionë lekë.

Neni 11

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- shpenzime të buxhetit qendror	480 788 milionë lekë;
- fondi rezervë i buxhetit	9 000 milionë lekë;
- kontingjencë për risqet e borxhit	4 500 milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2 janë kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2022 dhe 2023. Transferata e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2021.

Të ardhurat e shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për dy vitet pasardhëse, me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit prej 740 milionë lekësh, të përcaktuar në shpenzimet korrente të programit buxhetor 04250 “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun”, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë, si dhe financimi i ngritjes së sistemit të shpërndarjes dhe monitorimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor 2021 në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkallimit të të ardhurave, transferohet në



llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë në masën jo më shumë se 3 miliardë lekë dhe përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.”

Neni 6

Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, zëvendësohen me tabelat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 7

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shuma 500 milionë lekë si transfertë specifike shpërndahet sipas bashkive, duke marrë si kriter peshën e detyrimeve të secilës bashki ndaj totalit të detyrimeve të prapambetura të muajit shtator 2021. Ky fond përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke nisur nga detyrimi më i vjetër i papaguar.”

2. Tabela nr. 3, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 8

Në nenin 20, paragrafi i fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave, në Bankën e Shqipërisë, çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet e mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por, në mbyllje të vitit buxhetor, gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore të planifikuara për atë vit buxhetor.”

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

AKTI NORMATIV 2021 - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

në 000/lekë

Kodi	Emërtimi i Institucionit/programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financim i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	Presidenca	242,500	6,000	0	6,000	248,500
01120	Veprimtaria e Presidentit	242,500	6,000	0	6,000	248,500
2	Kuvendi	912,840	108,000	0	108,000	1,020,840
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	380,680	108,000	0	108,000	488,680
01120	Veprimtaria Ligjvënëse	532,160	0	0	0	532,160
3	Kryeministria	388,000	123,000	0	123,000	511,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	388,000	123,000	0	123,000	511,000
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	5,575,539	3,317,588	4,471,364	7,788,952	13,364,491
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	299,850	10,000	0	10,000	309,850
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,408,989	116,430	125,209	241,639	1,650,628
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	742,000	1,896,218	985,299	2,881,517	3,623,517
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. prodh. bujq. bleg. agroind dhe market.	2,499,750	958,340	3,044,436	4,002,776	6,502,526
04860	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	469,600	117,600	0	117,600	587,200
05470	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	19,350	0	0	0	19,350
04230	Mbështetje për peshkimin	136,000	219,000	316,420	535,420	671,420
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	5,510,570	41,978,611	15,081,438	57,060,049	62,570,619
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	493,100	11,300	0	11,300	504,400
04520	Transporti Rrugor	2,900,000	25,612,923	8,206,132	33,819,055	36,719,055
04540	Transporti Detar	101,650	50,000	1,000	51,000	152,650
04550	Transporti Hekurudhor	414,130	300,000	800,000	1,100,000	1,514,130
04560	Transporti Ajror	9,640	94,000	0	94,000	103,640
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	0	20,000	20,000	20,000
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	465,500	13,449,016	3,027,306	16,476,322	16,941,822
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	600,000	1,924,972	899,000	2,823,972	3,423,972
04320	Mbështetje për Energjinë	26,950	250,000	2,128,000	2,378,000	2,404,950
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	138,000	125,000	0	125,000	263,000
04440	Mbështetje pre Industrinë	332,500	58,400	0	58,400	390,900
06180	Planifikimi Urban	29,100	103,000	0	103,000	132,100
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	65,393,865	3,546,492	622,618	4,169,110	69,562,975
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	560,000	414,768	149,000	563,768	1,123,768
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	368,534	0	0	0	368,534
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	322,500	2,000,000	0	2,000,000	2,322,500



01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,497,000	303,000	0	303,000	2,800,000
01150	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,369,310	143,220	63,690	206,910	3,576,220
01160	Lufta kundër Transaksioneve Financiare joligjore	79,000	2,000	0	2,000	81,000
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	576,300	38,500	70,000	108,500	684,800
04160	Mbështetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	295,040	16,000	0	16,000	311,040
10220	Sigurimi Shogëror	50,300,099	0	0	0	50,300,099
10550	Tregu i Punës	2,235,000	40,000	0	40,000	2,275,000
04170	Inspektimi në Punë	166,000	10,000	0	10,000	176,000
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	2,008,082	279,004	339,928	618,932	2,627,014
06190	Strehimi	2,617,000	300,000	0	300,000	2,917,000
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	38,670,073	1,837,600	200,003	2,037,603	40,707,676
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	667,000	70,000	0	70,000	737,000
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	21,705,073	276,000	3	276,003	21,981,076
09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	6,097,000	170,000	0	170,000	6,267,000
09450	Arsimi Universitar	9,000,000	826,000	100,000	926,000	9,926,000
09770	Fonde për Shkencën	380,000	195,600	100,000	295,600	675,600
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	821,000	300,000	0	300,000	1,121,000
12	Ministria e Kulturës	1,415,666	1,363,000	136,000	1,499,000	2,914,666
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	163,672	0	0	0	163,672
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	509,994	7,500	43,000	50,500	560,494
08230	Arti dhe Kultura	742,000	1,355,500	93,000	1,448,500	2,190,500
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	66,690,905	2,329,660	1,977,400	4,307,060	70,997,965
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,579,687	5,000	0	5,000	1,584,687
07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	6,804,700	267,098	73,000	340,098	7,144,798
07330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	25,747,727	1,990,862	1,883,400	3,874,262	29,621,989
07450	Shërbimet e Shëndetit Publik	3,087,281	3,300	0	3,300	3,090,581
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	309,950	14,000	0	14,000	323,950
10430	Përkujdesja Sociale	28,126,560	49,400	21,000	70,400	28,196,960
01190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,035,000	0	0	0	1,035,000
14	Ministria e Drejtësisë	7,484,268	527,610	110,000	637,610	8,121,878
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	356,700	96,510	110,000	206,510	563,210
03310	Ndihma Juridike	65,000	1,000	0	1,000	66,000
01120	Publikimet Zyrtare	40,518	10,000	0	10,000	50,518
01130	Mjekësia Ligjore	80,000	1,000	0	1,000	81,000
03440	Sistemi i Burgjeve	5,428,000	400,900	0	400,900	5,828,900
03350	Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor	135,600	10,000	0	10,000	145,600
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	10,450	200	0	200	10,650
01180	Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	1,224,500	6,000	0	6,000	1,230,500
03490	Shërbimi i Provës	143,500	2,000	0	2,000	145,500
15	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	2,735,876	59,000	143,780	202,780	2,938,656
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	132,600	7,000	0	7,000	139,600
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,307,776	31,000	0	31,000	2,338,776
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	195,500	0	0	0	195,500
01150	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritimit	100,000	21,000	143,780	164,780	264,780
16	Ministria e Brendshme	19,661,000	746,632	348,268	1,094,900	20,755,900
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,343,800	125,149	0	125,149	1,468,949
03140	Policia e Shtetit	15,656,000	476,483	339,868	816,351	16,472,351
03150	Garda e Republikës	1,665,000	110,000	0	110,000	1,775,000
01160	Prefekurat dhe Funkonet e Deleguara të Pushtetit Vendor	502,000	35,000	8,400	43,400	545,400
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	494,200	0	0	0	494,200
17	Ministria e Mbrojtjes	19,668,300	4,760,500	300,000	5,060,500	24,728,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,455,365	0	0	0	1,455,365
02120	Forcat e Luftimit	5,606,780	3,884,200	0	3,884,200	9,490,980
09430	Arsimi Ushtarak	620,000	25,275	0	25,275	645,275
02150	Mbështetja e Luftimit	5,380,575	511,280	0	511,280	5,891,855
07340	Mbështetja për Shëndetësinë	1,076,000	200,000	0	200,000	1,276,000
10270	Mbështetja Sociale për Ushtarakët	5,200,000	0	0	0	5,200,000
10910	Emergjencat Civile	329,580	139,745	300,000	439,745	769,325
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,690,000	50,000	0	50,000	1,740,000
03520	Veprimtaria Informativ Shtetërore	1,690,000	50,000	0	50,000	1,740,000
19	Drejtorja e Radio Televizionit	556,000	50,000	0	50,000	606,000
08310	Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit	220,000	0	0	0	220,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	216,000	50,000	0	50,000	266,000
08330	Prodhimet filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	60,000	0	0	0	60,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH-së dhe Kinematografisë	60,000	0	0	0	60,000
20	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	186,000	95,000	0	95,000	281,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	186,000	95,000	0	95,000	281,000
22	Akademia e Shkencës	115,950	1,000	0	1,000	116,950
01520	Veprimtaria Akademike	115,950	1,000	0	1,000	116,950
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	348,000	20,000	19,853	39,853	387,853
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH-së	348,000	20,000	19,853	39,853	387,853
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,067,430	471,500	868,500	1,340,000	2,407,430
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	192,000	6,000	0	6,000	198,000
05320	Programe për mbrojtjen e Mjedisit	397,600	152,800	475,000	627,800	1,025,400
04260	Administrimi i Pyjeve	323,000	79,900	355,500	435,400	758,400
04760	Zhvillimi i Turizmit	154,830	232,800	38,000	270,800	425,630
28	Prokuroria e Përgjithshme	2,115,000	180,000	0	180,000	2,295,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,115,000	180,000	0	180,000	2,295,000
29	Këshilli i Lartë i Gjyqësor	2,964,200	183,000	0	183,000	3,147,200



01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	275,200	22,000	0	22,000	297,200
01140	Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	8,500	0	0	0	8,500
03310	Buxheti Gjyqësor	2,680,500	161,000	0	161,000	2,841,500
30	Gjykata Kushtetuese	146,000	4,000	0	4,000	150,000
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	146,000	4,000	0	4,000	150,000
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	66,500	6,000	0	6,000	72,500
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-së	66,500	6,000	0	6,000	72,500
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	142,000	17,000	0	17,000	159,000
01110	Veprimtaria e KLP-së	142,000	17,000	0	17,000	159,000
40	Partitë Politike	150,200	0	0	0	150,200
01110	Mbështetje për Partitë Politike	140,000	0	0	0	140,000
01120	Mbështetje për Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbështetje për Organizatat e Veteraneve me Status	2,200	0	0	0	2,200
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	369,119	30,000	0	30,000	399,119
03390	Veprimtaria e SPAK-ut	369,119	30,000	0	30,000	399,119
50	Instituti i Statistikës	546,740	17,300	232,000	249,300	796,040
01320	Veprimtaria Statistike	546,740	17,300	232,000	249,300	796,040
55	Shkolla e Magjistraturës	245,500	8,400	0	8,400	253,900
09820	Veprimtaria Arsimore	245,500	8,400	0	8,400	253,900
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	13,100,000	6,029,000	19,129,000	19,129,000
06210	Programe Zhvillimi	0	9,270,000	6,029,000	15,299,000	15,299,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	3,430,000	0	3,430,000	3,430,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	400,000	0	400,000	400,000
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	136,000	1,000	1,000	2,000	138,000
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	136,000	1,000	1,000	2,000	138,000
63	Institucionet e sistemit të drejtësisë	582,000	36,700	0	36,700	618,700
03320	Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	132,100	23,700	0	23,700	155,800
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	230,700	5,000	0	5,000	235,700
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	149,000	8,000	0	8,000	157,000
03360	Veprimtaria e Komisionerit Publik	70,200	0	0	0	70,200
66	Avokati i Popullit	116,000	3,000	0	3,000	119,000
03320	Shërbimi i avokatisë	116,000	3,000	0	3,000	119,000
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	57,800	2,000	0	2,000	59,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	57,800	2,000	0	2,000	59,800
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	165,000	2,436,500	0	2,436,500	2,601,500
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	165,000	16,500	0	16,500	181,500
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	2,420,000	0	2,420,000	2,420,000
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	153,600	3,000	0	3,000	156,600
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	153,600	3,000	0	3,000	156,600
77	Autoriteti i Konkurrencës	76,240	1,000	0	1,000	77,240
04120	Mbikëqyrja e tregut & Garantimi i konkurrencës	76,240	1,000	0	1,000	77,240
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	12,700	1,000	0	1,000	13,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	12,700	1,000	0	1,000	13,700
87	Institucione të tjera qeveritare	5,270,823	1,954,319	396,776	2,351,095	7,621,918
01320	Shërbime Qeveritare	250,000	80,000	0	80,000	330,000
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	56,800	1,000	0	1,000	57,800
01120	Shërbimi për diasporën	120,600	71,000	0	71,000	191,600
05640	Administrimi i ujërave	80,400	12,000	93,000	105,000	185,400
03310	Shërbimi i Avokatisë Shtetërore	223,400	2,000	0	2,000	225,400
01150	Shërbime të tjera	439,500	31,756	0	31,756	471,256
01140	e-Qeverisja	3,600,123	1,649,563	100,000	1,749,563	5,349,686
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	366,500	106,000	203,776	309,776	676,276
08480	Mbështetje për Kultet Fetare	133,500	1,000	0	1,000	134,500
88	Mbështetje për Shoqërinë Civile	112,500	1,000	0	1,000	113,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	112,500	1,000	0	1,000	113,500
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	65,500	1,000	0	1,000	66,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	65,500	1,000	0	1,000	66,500
90	Komisioni i Prokurimit Publik	70,000	1,000	0	1,000	71,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	70,000	1,000	0	1,000	71,000
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	51,700	4,000	0	4,000	55,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	51,700	4,000	0	4,000	55,700
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	32,000	1,000	0	1,000	33,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	32,000	1,000	0	1,000	33,000
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	93,176	10,200	90,000	100,200	193,376
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	93,176	10,200	90,000	100,200	193,376
TOTALI		252,053,080	79,393,612	31,028,000	110,421,612	362,474,692



Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2021

Tab. 3

Në mijë lekë

Nr.	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2021	Shtesë nga Kuvendi, "Transferte e pakushtëzuar për vitin 2021"	Shtesë me AN "Transferte e pakushtëzuar"	Transferrat e pakushtëzuara sektoriale														Transferte specifike					Totali
					Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor		Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Shtesë me AN për rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	Shtesë nga Kuvendi + AN "Transferte e pakushtëzuar sektoriale për investime në rrugë dhe ujë-kullim"	Shtesë me AN "Transferte e pakushtëzuar sektoriale për investime në rrugë"	Shtesë me AN për menaxhimin e mbetjeve urbane	Shtesë me AN për mbrojtjen civile	Mbrojtja civile	Shtesë me AN për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura			
						Ndarë me formulë për personelin mësimor	Për stafin mbështetës																	
1	Belsh	121,058			0	25,140	1,492	1,235	13,333	0	895	7,828		10,157						2,074	29,064	212,275		
2	Berat	298,960			27,374	97,221	38,785	13,987	31,466	23,731	5,666	4,824		15,095						8,135	16,440	581,684		
3	Bulqizë	265,670	10,000		0	50,199	9,715	0	14,426	0	9,619	28,565		13,611						5,184	600	407,590		
4	Cërrik	143,620	15,000		4,595	40,811	5,352	4,694	13,501	0	1,276	1,798		14,353						3,146	6,711	254,856		
5	Delvinë	66,428			0	19,106	4,848	1,791	13,459	0	2,553	3,372		10,157						1,472	4,553	127,739		
6	Devoll	193,299			0	50,797	3,412	2,496	13,690	0	4,521	10,385		11,641						4,007	1,787	296,035		
7	Dibër	416,544			24,070	112,440	28,603	9,539	23,592	0	8,275	14,002		14,353						6,470	11,873	669,760		
8	Divjakë	215,016			0	50,678	1,455	1,306	12,765	0	900	7,754		30,288						3,971	9,754	333,886		
9	Dropull	81,507	10,000		0	2,370	504	1,135	13,333	0	4,469	5,020		6,323						1,423	15	126,096		
10	Durrës	848,218	15,000		22,735	172,049	48,966	18,788	49,857	0	3,212	23,932		45,598			39,000			26,000	13,111	1,326,466		
11	Elbasan	689,211	15,000		28,446	209,187	56,238	33,157	31,816	21,108	12,193	17,421		15,095						16,677	5,878	1,151,427		
12	Fier	599,977			21,273	159,437	40,239	10,999	34,076	26,000	4,049	8,494		59,570						15,605	1,065	980,784		
13	Finiq	120,908	10,000		0	8,275	1,478	0	12,765	0	3,575	2,798		15,837		97,000				2,734	3,454	278,824		
14	Fushë Arrëz	79,240		3,000	0	21,744	9,696	4,618	13,501	0	11,825	13,388		2,869						1,530	596	162,007		
15	Gjrokastrë	213,504			18,070	75,372	24,240	6,045	29,441	0	7,053	7,639		9,777					64,000	5,325	79	460,546		
16	Gramsh	216,544	15,000		6,455	65,041	8,726	3,712	14,266	0	11,636	19,367		10,157		98,000				4,214	981	474,100		
17	Has	144,202			6,729	29,331	3,412	2,943	15,147	0	8,922	1,589		10,157						2,366	1,267	226,064		
18	Himarë	120,771	15,000		0	13,777	988	620	12,883	0	7,907	4,448		10,157						3,087	2,474	192,115		
19	Kamzë	508,693			0	126,940	20,865	10,041	47,766	0	550	0		3,611						14,733	18,478	751,677		
20	Kavajë	218,718			12,721	66,595	16,484	6,582	17,039	0	900	5,585		20,032						7,217	78,847	450,718		
21	Këlcyrë	61,104	10,000		0	7,703	1,455	2,850	13,501	0	3,186	7,639		10,157						1,266	0	118,860		
22	Klos	140,406			0	24,380	5,333	1,805	13,333	0	7,082	10,028		2,869						2,375	2,632	210,243		
23	Kolonjë	122,401			9,717	28,633	5,333	4,090	13,612	0	12,270	8,895		16,195						2,271	613	224,030		
24	Konispol	60,772	10,000		0	10,250	1,492	0	13,333	0	1,740	1,722		10,899						1,248	533	111,989		
25	Korçë	452,393			21,881	134,459	42,178	18,838	29,964	0	15,197	6,521		45,737						13,691	689	781,548		
26	Krujë	289,525	10,000		0	77,748	16,017	3,632	15,469	0	6,006	7,086		16,579						6,785	2,570	451,417		
27	Kuçovë	165,194			0	54,925	17,938	6,965	14,611	2,622	1,476	2,006		13,611						3,815	6,893	290,055		
28	Kukës	323,448			19,437	84,440	30,542	4,934	46,950	2,498	10,537	19,147		6,323						5,506	7,682	561,444		
29	Kurbin	229,878			0	73,731	17,956	15,283	13,983	0	2,844	3,857		20,774						4,009	672	382,988		
30	Lezhë	329,841			9,300	89,387	26,665	15,766	29,860	0	7,925	5,158		23,000						10,968	20,221	568,091		
31	Libohovë	41,574			0	5,625	1,492	1,145	13,333	0	2,732	6,329		2,877						779	559	76,445		
32	Librazhd	278,961	15,000		0	63,860	9,715	3,157	14,266	0	8,826	24,003		13,611						5,238	757	437,395		
33	Lushnjë	403,199			9,249	129,240	30,077	11,382	15,006	0	1,747	7,304		47,221						9,865	6,647	670,937		
34	Malësi e Madhe	296,777	10,000	3,000	4,208	44,048	2,909	5,268	19,327	0	13,167	12,868		12,383						4,853	32,320	461,128		
35	Maliq	299,169			0	73,267	3,916	10,319	13,333	0	5,806	8,645		40,057		30,000				5,314	168	489,994		
36	Mallakastër	159,892			0	55,554	15,029	6,773	14,947	0	2,881	7,138		13,611						6,247	717	282,790		
37	Mat	191,371		2,000	12,604	50,620	17,938	5,942	14,426	0	8,142	25,057		10,157						4,051	1,597	343,904		



38	Memaliaj	105,382			0	29,332	4,848	7,463	13,333	0	3,300	4,365		2,877					1,855	1,394	174,149	
39	Mirditë	202,793		2,000	21,883	43,963	15,513	7,577	16,180	0	13,557	18,662		13,611					3,660	4,228	363,626	
40	Patos	129,143	15,000		0	39,721	12,120	3,574	14,947	0	1,100	1,798		15,136					4,280	0	236,820	
41	Peqin	130,815	10,000	2,000	0	33,329	4,867	3,902	13,981	0	1,453	4,289		10,157					2,500	3,623	220,915	
42	Përmet	119,715		3,000	6,564	20,629	4,848	4,757	13,858	0	5,845	6,766		10,157					2,104	429	198,673	
43	Pogradec	361,564	15,000		0	118,433	7,291	9,548	14,082	0	12,539	20,303		10,899		55,000	46,000		7,422	24,064	702,144	
44	Polican	100,051		3,000	0	23,986	6,669	4,071	13,853	0	3,539	3,400		2,877					1,635	5,660	168,741	
45	Përrenjas	174,058	10,000		0	37,886	4,886	2,962	13,501	0	5,834	18,293		10,157					2,412	849	280,837	
46	Pukë	112,704		2,000	13,676	27,727	12,120	6,904	14,899	0	11,585	6,408		2,869					1,979	3,775	216,646	
47	Pustec	35,257		3,000	0	5,527	312	0	16,227	0	882	309		2,869					553	42	64,978	
48	Roskovec	111,973			0	28,055	2,443	2,343	13,333	0	1,100	3,928		7,065					3,743	10,125	184,107	
49	Rrogozhinë	143,309	15,000		0	29,550	5,836	2,382	12,765	0	1,429	0		10,157					2,779	6,536	229,744	
50	Sarandë	130,312	15,000		18,371	41,878	12,605	3,650	18,268	0	2,612	0		6,323					6,153	3,043	258,215	
51	Selenicë	170,738			0	23,946	4,382	7,905	13,333	0	4,583	2,726		13,611					2,881	5,258	249,364	
52	Shijak	137,140	10,000		0	34,604	6,303	3,011	12,765	0	900	47		6,323					3,125	36	214,255	
53	Shkodër	652,826			57,888	115,426	51,390	24,914	35,474	36,164	11,409	18,580		28,318					17,803	235	1,050,428	
54	Skrapar	124,814		5,000	11,080	32,972	10,784	6,532	13,978	0	4,356	12,543		10,157					2,413	1,757	236,386	
55	Tepelenë	83,842			6,729	30,666	7,757	3,548	13,858	0	5,098	6,111		2,873					1,790	2,409	164,681	
56	Tiranë	2,438,117			89,902	566,413	251,129	88,120	115,013	0	9,955	19,628		21,640		32,000			174,653	61,052	3,867,621	
57	Tropojë	207,974		2,000	0	37,620	11,150	3,595	15,146	0	13,152	8,646		2,869					2,993	5,378	310,522	
58	Dimal	138,412			0	43,853	504	1,624	13,459	0	882	3,736	10,000	18,929		20,000			3,076	10,275	264,749	
59	Vau i Dejës	224,557			8,720	37,237	1,007	2,362	12,765	19,190	6,677	5,661		12,383					5,823	669	337,051	
60	Vlorë	548,229			25,769	191,903	63,509	31,985	35,381	0	6,037	2,696		40,000					15,172	10,368	971,049	
61	Vorë	121,328			0	40,204	2,443	5,071	12,765	0	895	484		10,157					5,544	46,499	245,390	
Totali		16,113,043	250,000	30,000	519,442	4,039,238	1,076,195	489,637	1,220,539	131,313	350,284	520,992	10,000	907,318		32,000	300,000	46,000	64,000	500,000	500,000	27,139,000



TREGUESIT FISKAL TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021
FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2021

në milion lekë (in million lek)

Nr.	EMËRTIMI	AN dhjetor 2021	Në % të PBB- së	ITEMS
I	TOTALI TË ARDHURAVE	507,727	29.3%	TOTAL REVENUE
I	Të ardhura nga ndihmat	19,353	1.1%	Grants
	<i>Nga të cilat: mbështetje buxhetore</i>	<i>9,353</i>	<i>0.5%</i>	<i>from which: Budget Support</i>
	<i>Nga të cilat: projekte të destinuara për investime</i>	<i>10,000</i>	<i>0.6%</i>	
II	Të ardhura tatimore	466,773	26.9%	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	332,792	19.2%	From tax offices and customs
	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	160,061	9.2%	V.A.T
	Tatimi mbi Fitimin	33,631	1.9%	Profit Tax
	Akcizat	51,400	3.0%	Excise Tax
	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	41,200	2.4%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe të tjera	39,500	2.3%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	7,000	0.4%	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	25,926	1.5%	Local Taxes
	Taksa Lokale	20,278	1.2%	Local Taxes
	Tatimi mbi Pasurinë (ndërtesat)	5,648	0.3%	Property Tax
II.3	Të ardhurat nga Fondet Speciale	108,055	6.2%	Revenues from Special Funds
	Sigurimi Shoqëror	91,271	5.3%	Social Insurance
	Sigurimi Shëndetësor	15,084	0.9%	Health insurance
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,700	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III	Të ardhura jotatimore	21,600	1.2%	Nontax Revenue
	Tran. Fitimi nga Banka e Shqipërisë	1,000	0.1%	Profit transfer from BOA
	Të ardhura nga Institucionet Buxhetore	12,000	0.7%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	300	0.0%	Divident
	Tarifat e Shërbimeve	2,800	0.2%	Services Fees
	Të tjera	5,500	0.3%	Others
I	TOTALI I SHPENZIMEVE	628,269	36.2%	TOTAL EXPENDITURE
I	Shpenzime Korrente	473,048	27.3%	Current Expenditures
1	Personeli	89,913	5.2%	Personnel expenditures
	Paga	69,932	4.0%	Wages
	Kontributi për Sigurime Shoqërore	11,531	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i veçantë i pagave	250	0.0%	Bonus fund
	Politika të reja pagash	7,500	0.4%	Contingency for new wage policies
	Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta	700	0.0%	Higher Education from its own revenues
2	Interesat	40,800	2.4%	Interest
	Të Brendshme	23,600	1.4%	Domestic
	Të Huaja	12,700	0.7%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	4,500	0.3%	Contingency for debt related risks
3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje nga të cilat:	55,794	3.2%	Operational & Maintenance of which:
	<i>Të qeverisjes qendrore</i>	<i>52,444</i>	<i>3.0%</i>	<i>Central government</i>
	<i>Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta</i>	<i>800</i>	<i>0.0%</i>	<i>from revenues of Higher Education System</i>
	<i>Të tjera jashtë limitit</i>	<i>2,550</i>	<i>0.1%</i>	<i>from Exceptional Revenues</i>
4	Subvencionet	1,600	0.1%	Subsidies
5	Shpenzime për Fondet Speciale	198,001	11.4%	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqërore	146,765	8.5%	Social insurance
	<i>nga të cilat: Bonusi i Pensionistëve</i>	<i>3,500</i>		<i>Pensioners' Bonus</i>
	Politika të reja pensionesh	2,400	0.1%	Contingency for new pension policies
	Sigurime Shëndetësore	46,136	2.7%	Health insurance
	Shpenzime për Kompensimin në Vlerë të Pronarëve	2,700	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	57,940	3.3%	Local Budget expenditure
	Transfertat nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	27,789	1.6%	Central Government Grant for Local Government
	<i>Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme</i>	<i>18,480</i>	<i>1.1%</i>	<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (Grant specifik)</i>	<i>8,206</i>	<i>0.5%</i>	<i>Specific Grant</i>
	<i>Transfertë për emergjencat civile dhe shlyerje detyrimesh</i>	<i>1,103</i>	<i>0.1%</i>	
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	25,926	1.5%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa të ndara	970	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jotatimore)	2,700	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor	555	0.0%	Local foreign financing
7	Shpenzime të tjera	29,000	1.7%	Other expenditures
	Pagesa e Papunësisë	800	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia	25,000	1.4%	Social assistance and disability
	<i>nga të cilat: Pagesa e vendimeve gjyqësore të PAK</i>	<i>300</i>		
	Kompensim për ish të përndjekurit politik	1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,200	0.1%	Birth Bonus
II	Fondi Rezervë	9,000	0.5%	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezervë	8,000	0.5%	Reserve Fund
	Rezerve për zgjedhjet	1,000	0.1%	Contingency for deficit financing
III	Shpenzime kapitale	146,221	8.4%	Capital expenditures
	Financimi i Brendshëm	79,394	4.6%	Domestic financing



	<i>nga të cilat: Projekte zhvillimore AIC</i>	2,000	0.1%	
Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë		800	0.0%	From Higher Education System's own revenues
Financimi Hua		31,028	1.8%	Foreign financing
<i>nga të cilat: Energjia</i>		1,900	0.1%	from which: Energy
Fondi i Rindërtimit		35,000	2.0%	
DEFICITI		-120,542	-6.9%	Cash Balance
FINANCIMI I DEFICITIT		120,542	6.9%	Financing (Cash)
Brendshëm		-12,152	-0.7%	Domestic
Të ardhura nga privatizimi		49,900	2.9%	Privatization receipts
Huamarrje e brendshme		-62,052	-3.6%	Domestic borrowing
Të tjera, nga të cilat:		-68,052		Other
	<i>Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA</i>	6,000		
	<i>Ndryshimi i gjendjes së depozitës sig. shoq. & shënd.</i>	132,694	7.6%	Foreign
I Hua		109,396	6.3%	Long-term Loan(Drawings)
Hua afatgjatë (e marrë)	<i>nga të cilat: Eurobond</i>	85,217		
Ndryshimi i gjendjes së arkës				Chang. of stat. Account
Ripagesat		-34,120	-2.0%	Repayments
Mbështetje buxhetore		57,419	3.3%	Budget support
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)		1,735,040	100.0%	Gross Domestic Product (GDP)

UDHËZIM

Nr. 23, datë 1.12.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 12, DATË 10.6.2021,
“PËR PROCEDURAT E PRANIMIT E TË
EMËRIMIT TË MËSUESIT NË NJË
VEND TË LIRË PUNE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE
PËR ADMINISTRIMIN E PORTALIT
‘MËSUES PËR SHQIPËRINË’”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, pas pikës 4, të kreut 2, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Nuk mund të aplikojnë për konkurrim, për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që:

a) janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale kundrejt të miturve;

b) janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që lidhet me institucionet arsimore.”.

Shtojca 5 e udhëzimit zëvendësohet me shtojcën 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA 5

**VETËDEKLARIMI I GJENDJES
GJYQËSORE**

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:

i/e padënuar

i/e dënuar

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një veprë penale që lidhet me institucionet



arsimorë, apo i rehabilituar për këto vepra penale.

Emër, mbiemër: _____

Nënshkrimi: _____

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale, në vijim të përdorimit të këtij autorizimi, do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

UDHËZIM

Nr. 368, datë 23.11.2021

PËR PROCEDURAT, DOKUMENTACIONIN DHE AFATET E SHQYRTIMIT, PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM PËR ARMË TË SUBJEKTEVE JURIDIKE E FIZIKE, FORMATIN E REGJISTRIT PËR ARMËT DHE MUNICIONET, PËR SUBJEKTIN E LICENCUAR PËR VEPRIMTARITË ME ARMËT, PËR RREGULLAT, PROCEDURAT DHE FORMULARIN QË PLOTËSOHET NË KOHËN E REALIZIMIT TË QITJES EKSPERIMENTALE DHE ADMINISTRIMIN E GËZHJOJËS NË NJË BANKË TË DHËNASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; në zbatim të nenit 11, pika 2, të nenit 22, germa “dh”, të nenit 34, pika 2, të ligjit nr. 74, datë 10.7.2014, “Për armët”, të ndryshuar, me qëllim përcaktimin e procedurave, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim, për veprimtari me armët të subjekteve juridike e fizike, për përcaktimin e regjistrit të armëve nga subjektet e licencuara dhe formatin e regjistrave, për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale, si dhe administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash,

UDHËZOJ:

KREU I

PROCEDURAT, DOKUMENTACIONI DHE AFATET E SHQYRTIMIT PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM PËR ARMË TË SUBJEKTEVE JURIDIKE E FIZIKE

1. Procedurat për pajisjen me autorizim për blerje/mbajtje arme, ndahen në procedura për persona juridikë dhe në procedura për persona fizikë.

2. Procedurat për pajisjen me autorizim për blerje/mbajtje arme të personave juridikë/fizikë janë:

a) Personi fizik ose juridik, privat/publik, shtetasi shqiptar ose i huaj, rezident në Republikën e Shqipërisë, që kërkon të pajset me autorizim të lëshuar nga Policia e Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 74, datë 10.7.2014, “Për armët”, të ndryshuar, dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, dokumentacionin e përcaktuar në këtë udhëzim;

b) Struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit për pranimin e kërkesës, shqyrton nga ana formale nëse kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret ligjore, përkatësisht:

- të ketë mbushur moshën 25 vjeç dhe të mos jetë mbi 70 vjeç në kohën e aplikimit për t’u pajisur me autorizim për mbajtje arme;

- ndaj tij të mos jetë caktuar masë sigurie ose të mos jetë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve të ndryshme;

- të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;

- të mos ketë qenë i evidentuar për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësit publik, për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes, si dhe për sjellje që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet;

- të jetë i aftë nga ana fizike e mendore, si dhe të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, të vërtetuara këto me raportin mjekësor përkatës;

- të zotërojë dëshminë për kryerjen e kursit të aftësimi teorik dhe praktik për përdorimin e armës;



- të mos jetë debitor në shlyerjen e gjobave për kundërvajtjet administrative të parashikuara sipas këtij ligji;

- të gëzojë besueshmëri, në kuptim të këtij ligji;

- të mos jetë revokuar licenca/autorizimi me një afat jo më të vogël se 3 vjet.

Struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit për pranimin e kërkesës, bazuar në të dhënat që disponon, plotëson dosjen me verifikimin e shlyerjes së gjobave për kundërvajtjet administrative (nëse ka), verifikimin e revokimit të licencës/autorizimit me një afat jo më të vogël se 3 (tre) vjet, si dhe besueshmërinë dhe ia dërgon sektorit përkatës në Drejtorinë Vendore të Policisë për vlerësim;

c) Struktura vendore e shërbimeve ndaj të tretëve, pasi vlerëson dokumentacionin, e përcjell atë për miratim/refuzim në komisionin përkatës vendor/qendror të ngritur, sipas llojit të armës që do të blihet/mbahet;

ç) Për armët e kategorisë “B” dhe armët e kategorisë “C” me vjaska, komisioni qendror ngrihet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndërsa për armët e kategorisë “C” e “D”, komisioni vendor ngrihet dhe funksionon në Drejtorinë Vendore të Policisë;

d) Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit e komisionit përgjegjës për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armët, përcaktohet me urdhër të ministrit të Brendshëm;

dh) Dokumentet e dorëzuara nga personat juridikë e fizikë, për pajisje me autorizim, për blerje/mbajtje dhe ripërtëritje autorizimi për armë zjarri të kategorisë “B”, “C”, “D”, si dhe armë të tjera të këtij lloji, që njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, pasi protokollohen në sekretari, i kalojnë strukturave përkatëse për verifikim e plotësim dhe për veprime të mëtejshme komisionit përgjegjës për pajisje me autorizim për blerje/mbajtje arme;

e) Afatet e shqyrtimit, për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridike e fizike, janë:

i. afati i lëshimit të autorizimit për blerje arme zjarri, është 90 ditë nga dita e aplikimit;

ii. afati i lëshimit të autorizimit për blerje / mbajtje arme gjahu/të ftohta, si dhe armë të tjera të këtij lloji, që njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, është 30 ditë nga dita e aplikimit;

iii. autorizimi për mbajtje arme zjarri, gjahu/të ftohta, lëshohet brenda 15 ditëve nga dorëzimi i dokumenteve të blerjes së armës;

iv. ripërtëritja e autorizimit për mbajtje arme zjarri, arme gjahu/të ftohta, si dhe armë të këtij lloji që do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, bëhet brenda 30 ditë nga dita e aplikimit.

KREU II

DOKUMENTACIONI QË DORËZOJNË SUBJEKTET JURIDIKE E FIZIKE PËR T’U PAJISUR ME AUTORIZIM PËR BLERJE ARME ZJARRI, PJESË TË TYRE DHE MUNICION NË ORGANIN PÛRKATËS TË POLICISË.

1. Subjekti i licencuar për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike duhet të dorëzojë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, kërkesën për të blerë armë, në të cilën të përcaktohet lloji/kategoria e armëve, numri i armëve dhe municionit, si dhe emri i personit përgjegjës të SHPSF-së për administrimin e armëve.

2. Subjekti i licencuar për poligon civil qitjeje duhet të dorëzojë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesën me shkrim për të blerë armë, ku të përcaktohet lloji/kategoria e armës;

b) emrin e personit përgjegjës (drejtuesit teknik) për administrimin e armëve.

3. Autoriteti portual dhe Banka e Shqipërisë duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, kërkesën për të blerë armë, në të cilën të përcaktohet lloji/kategoria e armëve, numri i armëve dhe municionit, si dhe emri i personit përgjegjës për administrimin e armëve.

4. Subjektet e autorizuar si koleksionistë duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, kërkesë me shkrim nga zotëruesi i autorizimit si koleksionist për të blerë armë, e cila duhet të përmbajë: llojin/kategorinë e armëve, tipin, kalibrin, modelin, fabrikën e prodhimit të armës ose të dhëna të tjera, të shoqëruara me fotografi, ku të dallohet numri serial i armës.



5. Subjektet juridike publike, të cilave me ligj të veçantë iu jepet e drejta e mbajtjes së armës, në rastin kur armën do ta blejë institucioni, duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, kërkesën për të blerë armë, në të cilën të përcaktohet lloji/kategoria e armëve, numri i armëve dhe municionit, si dhe emri i personit përgjegjës për administrimin e armëve.

6. Federatat sportive të qitjes sportive, për t'u pajisur me autorizim për blerje/mbajtje të armëve sportive duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, kërkesën për të blerë/mbajtur armë, në të cilën të përcaktohet lloji/kategoria e armëve, numri i armëve dhe municionit, si dhe emri i personit përgjegjës për administrimin e armëve.

7. Për t'u pajisur me autorizim për import të armëve të gjahut dhe sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre (model 16), subjekti duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesën për import, në të cilën të përcaktohet lloji/kategoria e armëve, numri i armëve pjesëve kryesore dhe municionit të tyre, si dhe emri i personit përgjegjës për administrim e tyre, së bashku me informacionet që përfshijnë:

- vendin nga ku do të kryhet importi;
- vendin ose vendet e treta nga të cilat armët do të kalojnë tranzit;
- marrësin;
- përdoruesin fundor, nëse dihet në kohën e dërgesës;
- të dhënat që mundësojnë identifikimin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe të komponentëve kryesorë të tyre dhe municioneve, numrin identifikues të armëve që janë porositur te prodhuesi, si dhe sasinë e tyre, duke përfshirë të paktën para dërgim;

- markimin e vendosur në armët e zjarrit;

b) fotokopje të letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi;

8. Dokumentacioni që dorëzojnë personat fizikë, për t'u pajisur me autorizim për mbajtje arme zjarri dhe municioni, ndjek këtë procedurë:

Drejtuesi teknik, punonjësi i shërbimit në SHPSF, në port, në poligon qitje, në subjekt të aftësimit teorik, në bankë, për t'u pajisur me armë nga subjekti, duhet t'u miratohet e drejta e mbajtjes së armës së zjarrit në organin përgjegjës të policisë

dhe duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim për mbajtje arme, ku të përcaktohet lloji/kategoria e armëve;

b) fotokopjen e letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi;

c) vetëdeklarimin “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore”;

ç) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

d) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

dh) dëshminë “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës”;

e) përjashtohen nga germa “dh”, shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura.

9. Personat fizikë, që për shkak të veprimtarisë shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta, janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën, për t'u pajisur nga policia me autorizim për blerje/mbajtje arme e municioni, duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim për blerje/mbajtje arme;

b) fotokopje të letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi;

c) vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore”;

ç) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

d) dëshmi “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës”;

dh) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

e) përjashtohen nga germa “d”, shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura.

10. Personat fizikë, për t'u pajisur me autorizim për blerje arme për në vendbanim, duhet të



dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim për blerje arme;

b) fotokopje të letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi;

c) vetëdeklarim "Për verifikimin e gjendjes gjyqësore";

ç) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara më armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

d) dëshmi "Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës";

dh) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

e) përjashtohen nga germa "d", shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura.

11. Shtetasit që plotësojnë kriteret e ligjit për pajisjen me armë gjahu e sportive, për t'u pajisur me autorizim për blerje/mbajtje arme, duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim për blerje/mbajtje arme;

b) fotokopje të letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi;

c) vetë deklarim "Për verifikimin e gjendjes gjyqësore";

ç) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara më armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

d) dëshmi "Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës";

dh) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

e) përjashtohen nga germa "d" shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura.

12. Shtetasi i pajisur me autorizim për mbajtje armë gjahu, në rastet kur kërkon të blejë një armë gjahu tjetër, paraqet *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të gjithë dokumentet e përcaktuara në pikën 13 të këtij udhëzimi, me

përjashtim të dëshmisë për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës.

13. Personat juridikë e fizikë për t'u pajisur me autorizim, për blerje/mbajtje arme me vjaska gjuetie/sportive, duhet të dorëzojnë *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim për blerje/mbajtje arme;

b) vërtetimin nga ministria përgjegjëse për mjedisin/ministria përgjegjëse për sportin;

c) fotokopje të letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi;

ç) vetëdeklarim "Për verifikimin e gjendjes gjyqësore";

d) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara më armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

dh) dëshmi "Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës";

f) fotografi personale të shtetasit/personit fizik tregtarit të pajisur me NUIS/administratorit të personit juridik të pajisur me NUIS, të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

ë) përjashtohen nga germa "dh", shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura.

14. Personat juridikë apo fizikë, të cilët janë mbajtës të armëve të kategorive "B", që kërkojnë të blejnë një armë të kategorisë "C" apo "D" apo një lloj tjetër arme, duhet të dorëzojnë dokumentet *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim për blerje arme;

b) fotografi personale të shtetasit/personit fizik, tregtarit të pajisur me NUIS/administratorit të personit juridik të pajisur me NUIS, të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

c) fotokopje të autorizimit të mbajtjes së armës, të kategorisë "B".

15. Në rastin kur personi juridik apo fizik është pajisur me armë të kategorisë "C" dhe kërkon të blejë armë të kategorisë "B", procedurat do të kryhen sipas përcaktimeve në pikën 12 të këtij udhëzimi.



16. Pas përfundimit të afatit 5-vjeçar të autorizimit për mbajtjen e armës, personi juridik apo fizik, për ripërtëritjen e autorizimit për mbajtjen e armës, duhet të dorëzojë dokumentet *online*, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u ripajisur me autorizim për mbajtje arme;

b) fotokopje të autorizimit të mbajtjes së armës;

c) fotokopje të letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi;

ç) vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore”;

d) certifikatë mjekësore për veprimtarinë e lejuara me armë, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtarinë me armë, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

dh) fotografi personale të shtetasit/personit fizik, tregtarit të pajisur me NUIS/administratorit të personit juridik të pajisur me NUIS, të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë.

17. Shtetasit e punësuar në struktura shtetërore të armatosura, që kanë të drejtë të mbajnë armë, në rastet kur kërkojnë të pajisen me autorizim për blerje arme të kategorive “B”, “C” dhe “D”, apo një lloj tjetër arme, duhet të dorëzojnë dokumentet *online*, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim për mbajtje arme;

b) vërtetim nga institucioni ku ai kryen detyrën;

c) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

ç) vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore”;

d) fotokopje të letërnjoftimit/pasaportës, të njohur sipas legjislacionit në fuqi.

KREU III

PROCEDURAT DHE DOKUMENTET PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM TË PÛRKOHSHËM PËR MBAJTJE ARME

1. Autoritetet e huaja, të cilat pajisen me autorizim për mbajtje të armës së zjarrit në vendin tonë, paraqesin kërkesën në formë elektronike, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për mbajtje arme në rezidencë nga përfaqësitë diplomatike nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme;

b) formular me të dhënat e plota të personit fizik, detyra që kryen dhe të dhënat e armës së zjarrit;

c) i njëjti dokumentacion plotësohet edhe nga shtetas shqiptarë të punësuar mbi bazën e kontratës së punës me këto autoritete, që plotësojnë kriteret për mbajtje arme;

ç) fotokopje të pasaportës;

d) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë.

2. Shtetasit e huaj, të cilët kërkojnë të pajisen me autorizim provizor për mbajtje të armës së gjahut në vendin tonë, paraqesin kërkesën në formë elektronike, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për mbajtje arme;

b) fotokopje të pasaportës;

c) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

ç) kopje të lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;

d) kopje të lejes së armës të gjahut të shtetit të tij;

dh) formular aplikimi.

3. Shtetasi i huaj, rezident në Republikën e Shqipërisë, për të blerë armë të kategorisë “B”/“C”, në vendin tonë, paraqet kërkesën në formë elektronike, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesë për blerje arme të kategorisë “B”/“C”;

b) fotokopje të pasaportës;

c) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

ç) kopje të lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;

d) kopje e autorizimit për mbajtje të armës, të shtetit të tij;

dh) miratimi i shtetit të origjinës për blerjen e armëve të zjarrit të kategorisë “B”/“C”.

4. Dokumentet e huaja duhet të jenë me vullë apostile ose të legalizuara.

5. Pajisja me autorizim të përkohshëm për hyrje të personave juridikë dhe fizikë në Republikën e Shqipërisë me armë gjahu dhe municione për gjueti, për veprimtarinë e gjuetisë turistike, paraqesin kërkesën në formë elektronike, në



portalin unik qeveritar *e-Albania* (ose në pamundësi fizikisht), pranë zyrave të shërbimit të qytetarëve këto dokumente:

a) kërkesën ku përcaktohet data e hyrjes së shtetasve të huaj me armë në vendin tonë dhe data e daljes nga Republika e Shqipërisë;

b) ftesën nga subjekti legjitim për pjesëmarrje në një veprimtari gjyerie turistike;

c) kërkesën ku përcaktohet data e hyrjes së shtetasve të huaj me armë në vendin tonë dhe data e daljes nga Republika e Shqipërisë;

ç) autorizimin për mbajtjen e armës së gjahut nga shteti përkatës;

d) miratimin nga ministria përgjegjëse për mjedisin, për subjektet të cilave iu jepet e drejta për të zhvilluar veprimtarinë e gjyerie turistike;

dh) raportin me shkrim, nga specialistët përkatës të policisë, për plotësimin e kriterëve për ruajtjen e armës.

6. Pajisja me autorizim të përkohshëm për personave juridikë dhe fizikë, për ushtrimin e veprimtarisë së qitjes sportive apo për shkak të kryerjes së shërbimeve teknike të riparimeve pranë subjekteve të autorizuar për këtë qëllim, bëhet nëpërmjet dorëzimit *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, kërkesën ku të përcaktohet qëllimi, subjekti ku do të marr shërbimin me armë.

7. Brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e përfundimit afatit të këtij autorizimi, subjekti fizik apo juridik i autorizuar duhet të bëjë raportimin në strukturën përgjegjëse që ka lëshuar autorizimin provizor.

8. Pajisja me autorizim të përkohshëm për Federatat e Qitjeve Sportive, subjektet e licencuara, të huaja për të hyrë apo tranzit nëpërmjet vendin tonë me armë sportive/gjahu dhe municionet e tyre, bëhet nëpërmjet dorëzimit *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesën ku përcaktohet data e hyrjes së shtetasve të huaj (pjesëmarrës), së bashku me numrin identifikues të armës/armëve në vendin tonë dhe data e daljes nga Republika e Shqipërisë;

b) ftesën nga institucionet/subjekti legjitim organizator pritës i autoriteteve shqiptare.

9. Formatet e mëposhtme të autorizimeve për blerje arme, i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij:

a) autorizim për blerje arme zjarri të kategorisë “B” - model 1;

b) autorizim për blerje arme gjahu/sportive dhe

armë të këtij lloji, që njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj - model 2;

c) autorizim për blerje arme zjarri të kategorisë “C”, me vjaska, e municione përkatëse - model 3.

10. Formatet e mëposhtme të autorizimeve për mbajtje arme dhe autorizimeve provizore, i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, si vijon:

a) autorizim për mbajtje/blerje armë zjarri:

1. të posaçëm për mbajtje/për blerje - model 4/4a;

2. në vendbanim - model 5;

3. gjahu/sportive dhe armë të këtij lloji, që do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj - model 6;

4. të ftohta - model 7;

5. për përdorim skenik dhe kinematografik - model 8;

6. për koleksion - model 9;

b) autorizim provizor për:

1. nxjerrjen e armës nga vendbanimi - model 10;

2. shitje arme një shtetasi të huaj - model 11;

3. mbajtjen e armës nga misionet e huaja - model 12;

4. për transferim të përkohshëm të armëve të gjahut dhe sportive - model 13.

11. Formatet e mëposhtme të autorizimeve për mbajtje armë zjarri, për punonjësit e shërbimit të SHPSF-së, janë sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, konkretisht si vijon:

a) autorizim për mbajtje arme zjarri në shërbim për punonjësin e SHPSF-së - model 14;

b) autorizim për mbajtje arme zjarri në shërbim dhe lëvizje, për drejtuesin teknik/punonjësin e SHPSF-së (truprojë) - model 15.

KREU IV

LLOJET E ARMËVE PËR TË CILËT LËSHOHET AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARME

1. Subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike pajisen me autorizim, për mbajtje:

a) armë zjarri të kategorive “A16”, “A17”;

b) armë zjarri të shkurtra të kategorisë “B5”;

c) armë zjarri të gjata të kategorisë “B”;

ç) municion për armë zjarri të shkurtra deri në 50 fishekë për armë;



d) municion për armë zjarri të gjata deri në 200 fishekë për armë.

2. Në rast nevojë për fishekë shtesë, me kërkesë të subjektit dhe me arsyetim të policisë, jepet autorizim për 20 dhe 100 copë fishekë për armë.

3. Subjektet juridike dhe fizike, të cilëve sipas ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, u lind e drejta e pajisjes me autorizim për mbajtje arme, pajisen me autorizim për mbajtje arme zjarri të shkurtër, të kategorisë “B” dhe deri në 50 copë fishekë për armë.

4. Subjektet e licencuara për poligon civil qitjeje, të hapur ose të mbyllur, lejohet të mbajnë:

- a) armë zjarri të shkurtra të kategorisë “B”;
- b) armë zjarri të gjata të kategorisë “B4”, “B7”;
- c) armë pneumatike të kategorisë “C8”;

ç) municion sipas kërkesës, vetëm për përdorim në poligon, i cili (municioni) regjistrohet në autorizimin e blerjes;

d) municioni për poligonet dhe federatat sportive të jepet në varësi të dinamikës së tyre.

5. Subjekteve të licencuara për poligonin civil të qitjes me pjatel u lejohet vetëm mbajtja dhe përdorimi i armëve të gjahut të kategorisë “C”.

6. Subjektet juridike dhe fizike, të cilëve sipas ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, u lind e drejta e pajisjes me autorizim për mbajtje arme, pajisen me autorizim për mbajtje arme të kategorive “C” dhe “D”, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) subjektet juridike dhe fizike pajisen me armë të kategorisë “C2”, me autorizim të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;

b) subjektet juridike dhe fizike pajisen me armë të kategorisë “C1”, “C3”, “C4”, “C5”, “C7”, “C8” dhe “D3”, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

c) subjektet juridike dhe fizike pajisen me armë për alarm dhe sinjalizim, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.

7. Subjektet juridike dhe fizike të licencuara për koleksion armësh, lejohet të koleksionojnë:

a) armë zjarri të kategorisë “A”, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

b) armë zjarri të kategorisë “B” dhe “C”, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

c) armë të çaktivizuara, të certifikuara nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

8. Muzetë lejohet të koleksionojnë:

a) armë zjarri të kategorisë “A”, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

b) armë zjarri të kategorisë “B” dhe “C”, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

c) armë të çaktivizuara, të certifikuara nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

KREU V

FORMATI I REGJISTRIT PËR ARMËT, PËR SUBJEKTIN E LICENCUAR, PËR VEPRIMTARI ME ARMËT

1. Regjistrimi i armëve të kategorive “B”, “C” dhe “D”, në pronësi të personave juridikë dhe fizikë, bëhet në organin përgjegjës të policisë vendore në databazën elektronike, brenda 5 ditësh nga data e blerjes.

2. Regjistrimi i armëve të kategorive “B”, “C” dhe “D”, në pronësi të personave juridikë dhe fizikë, bëhet në organin përgjegjës të policisë vendore, duke paraqitur dokumentet si më poshtë:

a) vendimin e organit përgjegjës të Policisë së Shtetit për pajisje me armë zjarri;

b) dokumentin fletëdalje të subjektit që ka shitur armën ose aktin noterial të shitjes midis personave privatë, nëse janë brenda të njëjtës njësi të policisë vendore;

c) dokumentin fletëdalje të lëshuar nga njësia e policisë, kur shitësi dhe blerësi i armës së zjarrit nuk janë brenda të njëjtës njësi të policisë vendore, e shoqëruar me dokumentacionin sipas pikës “b”;

ç) përveç dokumenteve sipas pikave “a”, “b” dhe “c”, paraqitet fizikisht edhe arma së bashku me municionin.

3. Regjistrimi i armës nga subjekti i licencuar për tregtimin, import/eksportin e armëve bëhet në organin përgjegjës të policisë. Armët regjistrohen nga specialisti përkatës, pasi të ketë në dispozicion në formë të shkruar, këto dokumente:

a) licencën e lëshuar nga institucioni përgjegjës i licencimit;

b) kur armët janë blerë jashtë vendit:
- dokumentin fletëdalje të origjinës;



- dokumentin fletëhyrje të subjektit të firmosur nga titullari i licencës;

c) kur armët janë blerë brenda vendit;

- dokumentin fletëdalje të subjektit të licencuar vendas, shoqëruar me fletëdaljen e organit përgjegjës të policisë që administron subjektin shitës;

- dokumentin fletëhyrje të subjektit blerës të firmosur nga titullari i licencës;

ç) kur subjekti i licencuar regjistron armët e kategorisë B1 (pistoletë) dhe B4 (pushkë), dhe armët me vjaska të gjuetisë dhe ato të qitjes sportive, pronari i subjektit, përveç dokumenteve të rasteve në pikën “b” dhe “c”, dorëzon dhe dokumentin e qitjes eksperimentale sipas procedurës së përcaktuar në udhëzim të ministrit për këtë qitje prove (numrin unik të armës).

4. Regjistrimi i armëve të koleksionit dhe ato të muzeut kryhet në organin përgjegjës të policisë, kur në dispozicion të tij janë:

a) autorizimi i lëshuar nga komisioni për personin koleksionist apo personi i ngarkuar nga institucioni për administrimin e armëve të muzeut;

b) lista e armëve në pronësi të koleksionistit apo institucionit. Armët që nuk janë paaftësuar regjistrohen me të dhënat standarde: tipi, kalibri, fabrika, numri i serisë. Armët e paaftësuar vetëm tipi i armës dhe sasia në copë;

c) autorizimin për blerje arme koleksioni të lëshuar nga komisioni me dokumentet shoqëruese si në rastet e tjera të blerjes jashtë vendit ose në subjekte private.

5. Për çregjistrimin e armëve të kategorisë “C”, subjekti i licencuar për tregtimin e armëve, kur arma shitet jashtë vendit, subjektit të huaj i kërkohet të ketë dokumentacion të plotë nga vendi i tij, të përkthyer e noterizuar për blerje arme.

Në rastin kur subjekti vendas, i licencuar për tregtimin e armëve të gjahut, shet armë të kategorisë “C” një personi të huaj të pajisur me autorizim për blerje, vepohet si në rastin e shitjes së armëve, në pikën 37, të këtij udhëzimi.

6. Personi fizik, i cili ka në pronësi armë gjahu të kategorisë “C”, lejohet t’ia shesë një shtetasi të huaj, me autorizim të veçantë të lëshuar nga drejtoria vendore e policisë. Autorizimi për shitjen e armës është sipas formatit përkatës, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Procedura për shitblerjen është si më poshtë:

a) shtetasi i huaj paraqet dokumentin e

përkthyer dhe të noterizuar, që e autorizon të blejë armë;

b) personat fizikë që bëjnë shitjen e armës, paraqesin në organin përgjegjës të policisë vendore aktin noterial dhe armën e gjahut fizikisht për veprimet e heqjes së armës nga regjistri;

c) shtetasi i huaj, që ka blerë armën e gjahut, paraqet, në pikën e kalimit kufitar, autorizimin e lëshuar nga policia vendore dhe dokumentet shoqëruese;

ç) veprimet për ndryshimin e pronësisë së armës kryhen në zyrat noteriale.

7. Armët e municioni i blerë nga subjektet e licencuara, pasi regjistrohen në organin përgjegjës të policisë, të dhënat e tyre regjistrohen edhe në regjistrat e subjektit. Modeli i regjistrave do të jetë sipas aktivitetit që kryen subjekti.

8. Detyrimin për sigurimin dhe administrimin e armëve të zjarrit dhe municionit në subjekte e ka personi që është përgjegjës sipas ligjit.

9. Subjektet e licencuara për shërbimin privat të sigurisë fizike mbajnë këto regjistra:

a) regjistri me numra serie, i cili duhet të përmbajë të dhëna të armëve të zjarrit, tipi: kalibri, marka, modeli, prodhimi, numri serial i armës, viti i prodhimit (nëse nuk është pjesë e numrit). Për municionin kalibri, partia e prodhimit. Regjistri 37 (shtojca I);

b) regjistrin e daljes së përkohshme të armëve e municionit ku regjistrohen të dhënat e armës, municioni, personi që merr armën, ora dhe data, firma e përgjegjësit të autorizuar për regjistrimin e armëve. Regjistri 34 (shtojca I).

10. Regjistrat mbahen nga përgjegjësit/rojet e vendeve të shërbimit të caktuar nga drejtuesi teknik dhe janë subjekt i inspektimit të tij të paktën njëherë në muaj. Çdo inspektim duhet të përfundojë me raportin e nënshkruar nga drejtuesi teknik i subjektit të licencuar.

11. Personi juridik mund të modelojë dhe përdorë regjistrim elektronik për armët dhe punonjësit e shërbimit. Formatit elektronik duhet të përmbajë të dhënat e regjistratit të shkruar.

12. Subjektet e licencuara për import/eksport dhe tregtim për armët e përcaktuara në ligj mbajnë regjistra për armët, si më poshtë:

a) regjistër llogarie i dyqanit për armët dhe municionet, ku në të pasqyrohen veprimet hyrje-dalje në bazë të dokumenteve. Regjistri 9 (shtojca I);



b) regjistri i shitjes së armëve me numër serie dhe sasia e municionit, personave të autorizuar. Regjistri 10 (shtojca I);

c) dosjen e certifikatës së qitjes eksperimentale për armë të kategorisë “B” dhe “C”, të firmosur nga policia shkencore. Procedurat e marrjes së mostrave të municionit, përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Brendshëm.

13. Subjektet për transportin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbajnë dosje me dokumentet e armëve të transportuara, për llogari të subjekteve të licencuara për veprimtari me armë.

14. Subjekti i aftësimit praktik në poligon civil qitjeje, ka detyrimin ligjor të mbajë këto regjistra për armët:

a) regjistër për daljen e përkohshme të armëve e municionit, për aftësim teorik e praktik, nga vendi i ruajtjes ku regjistrohen të dhënat e armës, municioni, personi që merr armën, ora dhe data, firma e përgjegjësit të autorizuar për regjistrimin e armëve. Regjistri 34;

b) regjistër i personave që kryejnë qitje në poligon dhe sasinë e fishekëve të përdorur, me armët në pronësi të poligonit.

Regjistrohen edhe armët e personave që do të kryejnë qitje me armë në pronësi të tyre. Ky i fundit duhet të ketë me vete autorizimin për mbajtje arme.

Regjistrohet personi me të dhënat personale, lloji i armës, numri i serisë së armës dhe autorizimit që disponon, sasia e fishekëve të përdorur. Data dhe ora e qitjes.

15. Subjekti i pajisur me autorizim për mbajtjen e armëve, për përdorim kinematografik e skenik, ka detyrimin ligjor të mbajë regjistra për armët: regjistër me numra serie për armët e zjarrit luftarake (nëse ka) me të dhënat, tipin, kalibrin, markën, fabrikën, numrin e serisë, dhe armët e paaftësuara regjistrohen në copë. Regjistri 37.

16. Subjekti juridik ose fizik i pajisur me autorizimin për koleksionimin e armëve apo për armët e muzeut ka detyrimin ligjor të mbajë regjistër për armët me numër serie, për çdo kategori me të dhënat: tipi, kalibri, marka, fabrika, numri i serisë, ndërsa armët e paaftësuara regjistrohen në copë. Regjistri 37.

17. Formatet e regjistrave të përcaktuara në këtë udhëzim i bashkëlidhen dhe bëhen pjesë e tij.

KREU VI

RREGULLAT, PROCEDURAT DHE FORMULARI QË PLOTËSOHET NË KOHËN E REALIZIMIT TË QITJES EKSPERIMENTALE DHE ADMINISTRIMI I GËZHJOJËS NË NJË BANKË TË DHËNASH

1. Subjektet e licencuara për tregtimin/importin/eksportin e armëve kryejnë qitjen eksperimentale për gjithë armët e importuara të kategorisë “B” dhe kategorisë “C”, duke marrë 2 plumba dhe dy gëzhjoja për çdo tytë arme. Qitja për marrjen e provave kryhet kur armët regjistrohen në regjistrat e subjektit para se të kryhen veprime të shitjeve.

2. Personat fizikë të autorizuar për blerje arme jashtë vendit, brenda afatit të 5 ditëve të futjes së armës në Shqipëri, marrin masa për kryerjen e qitjes eksperimentale në laboratorët e policisë shkencore apo dhe në vende të tjera si poligone private apo poligone shtetërore, dhe dorëzimin e plumbave dhe gëzhjojave sipas procedurave të këtij udhëzimi.

3. Plumbat dhe gëzhjojat merren nga qitja provuese, duke plotësuar gjithë kushtet teknike në pajisje të mbushura me ujë nga personeli i trajnuar e kualifikuar, me masa të plota të sigurimit teknik. Plumbat e marra nga pajisja me ujë duhet të thahen para se të vendosen në kuti.

4. Drejtuesi teknik i subjektit të licencuar për veprimtari të lejuara me armët, kryen gjithë veprimet për realizimin e qitjes e administrimin e plumbave dhe gëzhjojave.

5. Pas qitjes eksperimentale drejtuesi teknik merr masa që të shënohen plumbat dhe gëzhjojat, sipër tyre me pajisje elektrike, me 4 numrat e fundit të armës që i ka qitur dhe vendosen në kuti.

6. Modelet e plumbave e gëzhjojave dorëzohen në Institutin e Policisë Shkencore, të vendosura në kuti kartoni ose plastike, të pajisura me një shirit ngjites për bllokimin e hapjes. Në kutinë e modeleve të plumbave dhe të gëzhjojave shkruhen të dhënat e armës që i ka qitur: tipi i armës, kalibri, numri serial, vendi i prodhimit, viti i prodhimit, i sigluar me emër e mbiemër nga drejtuesi teknik i subjektit që ka kryer qitjen e provës.

7. Kutitë me modelet e plumbave dhe gëzhjojave, dhe formulari për çdo armë dërgohen me dokument dhe shkresë zyrtare në policinë shkencore. Formulari hartohet në tri kopje dhe,



pasi konfirmohen nga policia shkencore, një kopje i qëndron policisë shkencore, dy kopje i kthehen subjektit, ku njëra prej tyre dorëzohet në organin përgjegjës të policisë vendore në kohën e shitjes së armës.

8. Modelet e marra nga policia shkencore kontrollohen për standardin e marrë dhe në rast se nuk janë të sakta, provat i kthehen subjektit për t'i përsëritur. Për saktësinë e modeleve bëhet kontroll i provave me përzgjedhje nga eksperti kriminalist i fushës.

9. Modelet e marra duhet të jenë të tilla që gjurma e lënë nga nxjerrësi i gëzhgojave të mos jetë mbi shkrimet e gëzhgojës. Gëzhgoja në fundin e saj të mos ketë gjurmë të tjera përveç atyre që lënë mekanizmat e armës.

KREU VII

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT QË KRYHEN PAS DORËZIMIT NË POLICINË SHKENCORE

1. Kartela e kompletuar (shkresa përcjellëse), formulari i plotësuar për të dhënat e armës, gëzhgojat dhe predhat, modele krahasimi) dorëzohen në sekretarinë e Institutit të Policisë Shkencore.

2. Sekretaria e Institutit të Policisë Shkencore regjistron hyrjen e kartelës në seksion të veçantë dhe ia kalon këto kartela shefit të sektorit të balistikës.

3. Eksperti që merr kartelën e studion atë dhe modelet, bindet për vlefshmërinë e tyre, për sa i përket vlefshmërisë së gjurmëve të lëna në to nga mekanizmat e armës, dhe, pas kësaj, vendos emrin e vet në formular në të tre kopjet duke e nënshkruar secilën prej tyre. Një prej kopjeve të formularëve mbahet në kartotekën balistike, duke e regjistruar në regjistr të veçantë dhe i bashkëngjitet modeleve, një i dërgohet organit që lëshon lejen dhe kopjen tjetër e merr subjekti.

4. Në kartotekën balistike të Institutit të Policisë Shkencore, kartelat balistike, ku përfshihen formularët e nënshkruar nga eksperti, që i ka ekzaminuar për vlefshmëri, dhe gëzhgojat e predhat modele krahasimi regjistrohen në libër të veçantë, i cili mbyllet në fundin e çdo viti kalendarik dhe ruhet përgjithmonë.

5. Imazhet e gjurmëve të lëna nga mekanizmat e armës në gëzhgojë regjistrohen në sistemin

informatik, në seksionin e armëve të regjistruara, duke krijuar një databazë për këtë qëllim.

6. Imazhet e gjurmëve të lëna nga mekanizmat e armëve në gëzhgojat modele, të marra nga qitjet eksperimentale me armët që shiten, do të regjistrohen sipas formularëve të sistemit informatik, ku tek të dhënat shënohet numri rendor, data e hyrjes, emri i pronarit, numri i armës, numri i gëzhgojave, eksperti që ka bërë vlerësimin.

7. Kartela me të dhënat dhe modelet ruhen në kartotekë përgjithmonë dhe mund të hiqet vetëm në rastet e parashikuara në këtë udhëzim. Kartela do të jetë e regjistruar në kartotekë dhe imazhet do të jenë të regjistruara në sistem deri në momentin kur Instituti i Policisë Shkencore merr njoftim zyrtar me shkresë, nga organi që lëshon lejen dhe konfirmimin zyrtar të subjektit, për shkatërrimin përfundimtar dhe të pariparueshëm të armës dhe të pjesëve të saj.

8. Në rast të përdorimit të gëzhgojave për identifikim të armëve si prova në çështje penale, gëzhgoja do të administrohet nga oficeri i policisë gjyqësore dhe do të veprohet njësoj, si dhe provat e tjera që shoqërojnë çështjen në gjyq.

KREU VIII

DISPOZITA TË NDRYSHME

1. Shtojca I, përbëhet nga regjistri nr. 9, regjistri nr. 10, regjistri nr. 34 dhe regjistri nr. 37, dhe modelet e autorizimeve, të cilat i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Përfshirja, kur për shkaqe teknike, kërkuar e ka të pamundur paraqitjen e kërkesës në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, kërkesa paraqitet drejtpërdrejt në zyrat e shërbimit të qytetarëve të komisarit të policisë ose Drejtorisë Vendore të Policisë, ku ka vendin e ushtrimit të aktivitetit ose selinë qendrore subjekti, vendbanimin shtetasi shqiptar ose shtetasi i huaj rezident në Republikën e Shqipërisë, ose kërkesa mund të paraqitet nëpërmjet postës së porositur.

3. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 277, datë 29.5.2015, "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridike e fizike, formatin e regjistrimit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimit e



gëzhojës në një bankë të dhënash”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Për njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen punonjësit e policisë, subjektet juridike dhe fizike që kryejnë veprimtari të lejuara me armët.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për kryerjen e procedurave, lidhur me hartimin e formës për ofrimin e shërbimeve, për pajisjen me autorizim, sipas përcaktimeve të këtij

udhëzimi *online*, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-*Albania*.

6. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

SHTOJCA I

Registri me numra serie

Regjistri 37

Kodi.....

[illegible]

Registri 9

Regjistër llogarie

Emërtimi	Kodi	Njësia e matjes	Çmimi
----------	------	-----------------	-------

Nr.	Dokumenti		Përshkrimi i veprimt	Hyrje	Dalje	Mbetje ndarë në Kategori		
	Nr.	datë				I	II	Shuma
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

Mbahet nga përgjegjësi material



Regjistri i shitjeve

Regjistër 10

Kategoria: (C1)....

Emërtimi: (Armë e shikurtër gjysëm automatike (B 1) Pistoletë 9X19 mm 92 FS Bereta, Italiane

Faqe 000001

Nr	Emër Atësi Mbledhës	Datëlindja	Vendbanimi			Arma e Furnizuar	Autorizimi i Policisë		Dokumenti Fletë - Dalje		Vërejtje
			Fshati	Qyteti (të gjithë)	Telefon		Nr	Datë	Nr	Datë	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											

Regjistri. 34

I daljes së përkohshme të armatimit

NR	Arma, municioni, Tipi, Kalibri, Modeli, Fabrika	Numri i armës	Njësia e matjes	Data dhe ora e dhënies	Sasia		Emër, Mbledhës Firma e marrjes	Kthyer		
					Me shifër	Me shkrim		Data/ora e kthimit	Sasia	Firma e marrësit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										

Ky libër mbahet dhe plotësohet nga personeli i ngarkuar me administrimin e armëve të gjata, për personelin që del në shërbim dhe nga magazinierët në raste të veçanta, të përcaktuara me rregullore.



Model 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETËTIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____,

AUTORIZIM**Për blerje armë zjarri e municione përkatëse**

Në zbatim të gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 24 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë ____.

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në Njësine Administrative _____, Rrugën _____, identifikuar me ID _____, të blejë **armë zjarri të kategorisë “B”**, e municione përkatëse pranë subjekteve të licencuara nga institucioni përgjegjës për tregtim të armëve si vijon:

- 1 (një) armë të shkurtër të kategorisë “B”

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën e shkurtër deri në 50 fishekë për armë

I autorizuari detyrohet **që** brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës. të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisaratin e Policisë _____ ku ka vendbanimin/ushtron aktivitetin.

Ky autorizim është i vlefshëm 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTORI



Model 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ Prot _____ më, _____,

AUTORIZIM

**Për blerje armë të gjahu/sportive dhe armë të tjera të këtij lloji që njihen si të tilla nga aktet
ndërkombëtare**

Në zbatim të gërmës “d”, të pikës 2, të nenit 24 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar, si dhe
Vendimit të Komisionit të Drejtorisë Vendore të Policisë Nr. _____, datë _____. _____.

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur
në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, Rruga _____, identifikuar me
ID _____, për të blejë armë të kategorisë “C”, “D” dhe armë të tjera
brenda dhe jashtë vendit si vijon:

- _____ armë të kategorisë _____

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën deri në _____ fishekë për armë

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj
në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisariatin e Policisë _____ ku ka
vendbanimin/ushton aktivitetin.

Ky autorizim është i vlefshëm 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTORI



Model 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____, _____

AUTORIZIM**Për blerje armë zjarri të kategorisë “C” me vjaska e municione përkatëse**

Në zbatim të nenit 24 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____ datë _____. _____.

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në Njësinë Administrative _____, Rrugën _____, identifikuar me ID _____, të blejë armë të kategorisë “C” **me vjaska** pranë subjekteve të licencuara nga institucioni përgjegjës për tregtim të armëve si vijon:

- _____ armë të gjatë të kategorisë “C” me vjaska

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën e gjatë deri në _____ fishekë për armë

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisaratin e Policisë _____ ku ka vendbanimin/ushtron aktivitetin.

Ky autorizim është i vlefshëm 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTORI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____, _____

AUTORIZIM**I posaçëm për blerje/mbajtje armë zjarri**

Në zbatim të gërmës “ç”, të pikes 2, të nenit 24 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë ____.

Autorizohet personi fizik _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, Rruga _____, identifikuar me ID _____, të mbajë armë zjarri si vijon:

- 1 (një) armë të shkurtër të kategorisë “B”

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën e shkurtër deri në 50 fishekë për armë

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisariatit e Policisë _____ ku ka vendbanimin/ushtron aktivitetin.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit të posaçëm për mbajtje arme, bazohet në vlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën, vlerësim i cili kryhet të paktën çdo 1 (një) vit.”

DREJTORI



Model 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ Prot

_____ më, _____, _____

AUTORIZIM**Për mbajtje arme të ftohtë**

Në zbatim të gërmës “c”, të nenit 24 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë Vendore të Policisë Nr. _____, datë _____. _____.

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, Rruga _____, identifikuar me ID _____, për të mbajë **armë të ftohtë** si vijon:

- _____ armë të kategorisë _____

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë, Komisariatin e Policisë ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin.

DREJTORI



Model 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETËTIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____,

AUTORIZIM

Për përdorim skenik të armëve

Në zbatim të gërmës “d” të nenit 12, gërmës “c”, të pikës 1, të nenit 24 dhe pikës 1 të nenit 32 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të i ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____. _____.

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, Rruga _____, identifikuar me ID _____, për të mbajë armë për përdorim skenik dhe dhe kinematografik si vijon:

- _____ armë të kategorisë _____

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë, Komisariatin e Policisë ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin.

Ky autorizim është i vlefshëm _____ nga data e lëshimit.

DREJTORI



Model 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____, _____

AUTORIZIM**Për koleksionim armësh**

Në zbatim të gërmës “ë” të nenit 12, gërmës “d”, të pikës 1 të nenit 24 dhe pika 3 të nenit 32 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____. _____.

Autorizohet për koleksionim armësh personi fizik/juridik _____, në emër të shtetasit _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, Rruga _____, identifikuar me ID _____, në adresë të vendit të koleksionimit të armëve::

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë, Komisaratin e Policisë ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin.

Ky autorizim është pa afat.

DREJTORI



Model 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË
KOMISARIATI I POLICISË _____

Nr. _____ Prot

_____ më, _____, _____

AUTORIZIM PROVIZOR**(DITOR)****Për nxjerrjen e armës nga vendbanimi**

Në zbatim të germës “c” dhe “ç”, të nenit 37 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, personi _____ i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, Rruga _____, identifikuar me ID _____, juridiksion i Komisarariatit të Policisë _____, i pajisur me autorizim mbajtje arme Tip _____, modeli _____, kalibri _____, me numër serie _____,

Autorizohet të nxjerrë armën nga vendbanimi për qitje sportive/shërbime e riparime teknike pranë subjektit _____ të licencuar “Për poligon civil qitje”/i licencuar për shërbime teknike, me adresë _____

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e perfundimit afatit të këtij autorizimi të bëjë raportimin në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisariatin e Policisë _____, ku ka vendbanimin.

Ky autorizim është i vlefshëm për datën _____, _____ dhe lëshohet jo më shumë se një ditë në muaj.

SHEFI I KOMISARIATIT

Vula



Model 11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ Prot _____ më, _____,

AUTORIZIM PROVIZOR

Për blerje e armës nga shtetas i huaj rezident

Në zbatim të pikës 5 të nenit 39 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____. _____.

Autorizohet **shtetasi i huaj rezident** në RSH, _____, me shtetësi _____, me document ID _____, i pajisur me autorizim për mbajtje arme të kategorisë “B”/“C” nga _____ me nr. _____, datë _____ të blejë armë të kategorisë “B”/“C” tip _____, modeli _____, kalibri _____, me numër serie _____, shtetasit _____, në përputhje me dokumentacionin ligjor nga vendi i origjinës.

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës. të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisariatin e Policisë _____ ku është i regjistruar rezidentë.

Ky autorizim është i vlefshëm 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTORI

Vula



Model 12

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____, _____

AUTORIZIM PROVIZOR**Për mbajtje arme personale nga autoritetet e huaja**

Në zbatim nenit 40 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____. _____. _____. _____.

Autorizohet Z/Grada _____, punonjës i _____, të mbajë armë personale model _____, kalibri _____, me numër _____, me _____ copë fishekë.

Autorizimi është i vlefshëm me pasaportë personale/dokument, nga data _____. _____. _____. deri më datë _____. _____. _____. _____.

DREJTORI

Vula



Model 13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____, _____

AUTORIZIM I PËRKOHSHËM**Për transferim të përkohshëm të armëve të gjahut dhe sportive**

Në zbatim nenit 19/3, 40 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____.

Autorizohet personi fizik/juridik/Federata e Qitjes Sportive _____, për lejin e transferimit të përkohshëm të armëve të gjahut/sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datat _____ deri në _____, hyrje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, dalje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, me të dhënat si më poshtë:

Armët e gjahut/sportive: 0.0

1. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
2. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
3. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
4. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
5. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
6. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;

DREJTORI

Vula



Model 14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ Prot _____ më, _____,

AUTORIZIM

Për mbajtje arme në shërbim për punonjësin e SHPSF-së

Në zbatim nenit 27 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____. _____. _____. _____.

Autorizohet për mbajtje armë zjarri në shërbim punonjësi i shërbimit:

Emër _____

Atësia _____

Mbiemër _____

Datëlindja _____

ID _____

Nr.Certifikatës _____

Autorizimi për mbajtje armë zjarri në shërbim është i vlefshëm gjatë kohës së punës vetëm në ambientet e punës dhe shërbimit.

Autorizimi është i vlefshëm 5 vjet nga afati i lëshimit të tij, me të drejtë përtëritje.

DREJTORI

Vula



Model 15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ Prot

_____ më, _____,

AUTORIZIM**Mbajtje arme në shërbim dhe lëvizje për Drejtuesin Teknik/punonjës të SHPSF-së (Truprojës)**

Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____. _____.

Autorizohet për mbajtje armë zjarri në shërbim dhe lëvizje Drejtuesi Teknik/ punonjësi i SHPSF-së (Truprojës):

Emër _____

Atësia _____

Mbiemër _____

Datëlindja _____

ID _____

Nr. Certifikatës _____

Autorizimi për mbajtje armë zjarri në shërbim dhe lëvizje është i vlefshëm gjatë kohës së punës në ambientet e punës/shërbimit, si dhe jashtë qendrës së banimit apo të punës/shërbimit.

Autorizimi është i vlefshëm 5 vjet nga afati i lëshimit të tij, me të drejtë përtëritje.

DREJTORI

Vula



Model 16

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____, _____

AUTORIZIM**(Për import të armëve të gjahut dhe sportive pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre)**

Në zbatim të nenit 19/1 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____. _____.

Autorizohet subjekti fizik/juridik _____, i pajisur me licencë _____ për “Import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre”, të vlefshme deri më datë _____, me seli në _____, Shqipëri, me administrator _____, drejtues teknik _____, të importojë nga shteti _____, me transit nga _____, të importojë armë gjahu/ sportive, pjesë kryesore dhe municione të tyre, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

- Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
- Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;

Sasia e importit të municionit sipas armës:

- Municioni për armën _____

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga importi i armëve në vend, të bëjë regjistrimin e tyre në Drejtorinë Vendore të Policisë, Komisariatin e Policisë ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin.

Afati i këtij autorizim është i vlefshëm _____

DREJTORI

Vula



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË D.P.P.SH  Nr i Regjistrimit	AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARMË ZJARRI (I POSAÇËM) Mbiemri Emri Atësia Nr. personal Data e Lindjes Adresa 
---	--

Model 4/a

TIPI	Data e Lëshimit
Marka	Data e Skadimit
Modeli	
Kalibri	
Nr. Serial	Autorizimi është i vlefshëm për mbajtje arme në vendbanim dhe në lëvizje.



Model 5

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË D.P.P.SH  Nr i Regjistrimit DI 100019150002	AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARME ZJARRI (NË VENDBANIM) Mbiemri Emri Atësia Nr. personal Data e Lindjes Adresa
--	--

AL

TIPI	Data e Lëshimit
Marka	Data e Skadimit
Modeli	
Kalibri	Autorizimi është i vlefshëm vetëm për në banesë. Jashtë banesës vetëm me lejen e policisë.
Nr. Serial	



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË D.P.P.SH  Nr i Regjistrimit DI 100019150002	AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARMË GJAHU/SPORTIVE Mbiemri Emri Atësia Nr. personal Data e Lindjes Adresa
--	---

AL

Model 6

TIPI Marka Modeli Kalibri Nr. Serial	Data e Lëshimit Data e Skadimit Autorizimi është i vlefshëm jashtë banesës i shoqëruar me lejen e gjuetisë ose lejen e policisë.
---	---



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË
NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

KËRKESA NR. 616/16
DORIAN MATLIJA
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 5 tetor 2021, si Komision, i përbërë nga:

María Elósegui, *kryetare*,

Darian Pavli,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit*,

pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 14 dhjetor 2015,

duke marrë në konsideratë deklaratat formale, në të cilat pranohet një zgjidhje miqësore për çështjen,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

1. Kërkesi, z. Dorian Matlija, është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1976, i cili jeton në Tiranë.

2. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjenti i saj i asaj periudhe, z. E. Muçaj, dhe më pas nga znj. B. Lilo, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Qeverisë iu komunikuan ankesat e kërkesit, në mbështetje të neneve 6§1, 10 dhe 13 të Konventës për mosrespektimin nga ana e autoriteteve të një vendimi të formës së prerë të brendshëm, sipas së cilit autoritetet urdhëroheshin të paraqisnin dokumente që vërtetonin se kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik përmbushnin kriteret statutorë për emërimin e tyre në një zyrë publike.

4. Gjykata mori deklaratat për një zgjidhje miqësore, të nënshkuara nga palët, sipas së cilave kërkesi binte dakord të hiqte dorë nga pretendime të mëtejshme ndaj Qeverisë së paditur, në lidhje me faktet që sollën këtë kërkesë, me kusht që Qeveria t’i ofronte atij brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës, informacionet që u urdhëruan të jepeshin në vendimin e gjykatës vendëse, të ruajtura në arkivat e institucioneve përkatëse shtetërore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, arkivat e kryeministrit dhe të Komisionit

të Prokurimit Publik, me përjashtim të certifikatave të gjendjes gjyqësore, të cilat ishin shkatërruar për shkak të periudhave të kufizuara për ruajtjen e tyre.

5. Gjithashtu, Qeveria pranoi t’i paguante kërkesit 5,000 EUR, për të paguar dëmin jomonetar, së bashku me kostot dhe shpenzimet, plus ndonjë taksë që mund t’i tarifohej, të cilat do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatuar në datën e pagesës, dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës tremujore përmendur më sipër, Qeveria pranon të paguajë interesin e thjeshtë ndaj saj, nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, në një normë të barabartë me normën marginale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë përqindje.

LIGJI

6. Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo pranon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe në Protokollin e saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye që justifikojnë një shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës. Për sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime:

Vendos, ta heqë kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 nëntor 2021.

Olga Chernishova
Zëvendësregjistrare

Marta Elósegui
Kryetare



VENDIM
Nr. 34, datë 1.11.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.10.2021,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë
dokumentesh, çështjen nr. 4 (A) 2021 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Zyra e Përmbartimit
Privat ARB” sh.p.k., përfaqësuar nga
administratori, Alban Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria
“Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., shoqëria
“Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” sh.a.

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së aksesit në
një gjykatë të caktuar me ligj.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe
përsheptimi i procedurave në gjykimin e çështjes
civile nr. 11118-02028-00-2016 akti, datë regjistrimi
15.6.2016 dhe të çështjes nr. 7 regjistri, datë
30.12.2020 në Gjykatën e Lartë të Republikës së
Shqipërisë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për
konstatimin, dëshmipërblimin dhe përsheptimin e
procedurave të sipërpërmendura.

BAZA LIGJORE: Neni 42, pika 2, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6,
pika 1 dhe 13, të Konventës Evropiane për të
Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë
10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska,
shqyrtoi parashtrimet e kërkuësës, shoqërisë “Zyra
e përmbartimit privat ARB” sh.p.k., prapësimet dhe
qëndrimin me shkrim të subjektit të interesuar,
shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a.
Faqe/16892

(BKT), e cila kërkoj rrëzimin e kërkesës, konstatoi
mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të
interesuar, shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike
Shqiptare” sh.a. (KESH), si dhe diskutoi çështjen
në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Zyra e përmbartimit privat ARB”
sh.p.k. (kërkuësja), ka lidhur kontratë shërbimi me
KESH-in me objekt kryerjen e shërbimit
përmbartimor për ekzekutimin e titujve ekzekutivë,
pas së cilës ka filluar procedurën për ekzekutimin e
tyre nëpërmjet njoftimeve drejtuar bankave të
nivelet të dytë. Gjatë këtyre procedurave, ajo ka
konstatuar se BKT-ja nuk ka përmbushur urdhrin e
saj për sa parashikohej në titullin ekzekutiv.

2. Në datën 28.5.2014, kërkuësja ka paraqitur
kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë,
duke paditur BKT-në, ndaj së cilës ka kërkuar
shpërblim për dëmin pasuror e jopasuror të pësuar,
për fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore
përkatëse sipas normës Tribor njëditor të vendosur
nga Banka e Shqipërisë, deri në datën e ekzekutimit
të vendimit të gjykatës.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 3048, datë 15.4.2015, ka vendosur
rrëzimin e padisë. Në datën 29.4.2015, kërkuësja ka
paraqitur ankim ndaj këtij vendimi në Gjykatën e
Apelit Tiranë, e cila, me vendimin e saj nr. 944,
datë 21.4.2016, ka vendosur lënien në fuqi të tij.

4. Ndaj vendimit të mësipërm, në datën
20.5.2016 kërkuësja ka paraqitur rekurs në
Gjykatën e Lartë dhe çështja është regjistruar me
nr. 1111-02028-00-2016, datë 15.6.2016, por që
ende nuk është gjykuar.

5. Në datën 14.12.2020, kërkuësja ka paraqitur
në Gjykatën e Lartë një kërkesë për konstatimin e
shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e
procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë,
bazuar në nenet 399/1-399/12 të Kodit të
Procedurës Civile (KPC).

6. Me shkresën nr. 3102/1 prot., datë
21.12.2020 “Kthim përgjigje për konstatim shkelje afati të
arsyeshëm”, kancelari i Gjykatës së Lartë ka njoftuar
kërkuësen se kërkesa për konstatimin e shkeljes së
afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e
procedurave nuk është nënshkruar nga një avokat i
pajisur me akt përfaqësimi, kriter i parashikuar në



nenin 474 të KPC-së dhe, në këto kushte, e ka kthyer atë pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse.

7. Në datën 30.12.2020, kërkesja ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë një kërkesë me të njëjtin objekt dhe përmbajtje si ajo e datës 14.12.2020, por të nënshkruar si nga administratori i shoqërisë, ashtu edhe nga një avokat. Kjo kërkesë është regjistruar me nr. 7 regjistri, datë regjistrimi 30.12.2020 dhe nuk është gjykuar ende nga Gjykata e Lartë.

8. Me shkresën nr. 1008/1 prot., datë 1.4.2021, të kancelarit të Gjykatës së Lartë, në përgjigje të kërkesës për informacion të kërkuës, ajo është njoftuar se të dyja çështjet e saj janë në fazën e studimit për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 21.4.2021 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas objektit të kërkesës.

10. Kolegji i Gjykatës në datën 21.5.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve të Gjykatës, e cila në datën 28.6.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

11. Me shkresën, datë 5.7.2021, kërkesja ka paraqitur para Gjykatës parashtrime me shkrim, duke informuar se në datën 15 korrik 2019 ka depozituar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) një kërkesë, e cila është regjistruar me nr. aplikimi 39860/19, ku ajo ka ngritur të njëjtat pretendime sikurse ato që janë ngritur para Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës, duke parashtruar në mënyrë të përmblendhur se janë cenuar:

12.1 *E drejta për një mjet efektiv për përshpejtim procedurash*, e garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së, të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenin 42 të Kushtetutës, pasi rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 14.9.2017 dhe prej më shumë se 3 vjetësh nuk ka ende një vendimmarrje prej saj. Gjykata e Lartë nuk e ka objektivisht të mundur proceduralisht të zgjidhë ankesën për shkeljen e kohëzgjatjes dhe ndreqjen e

pasojave, pasi, në momentin që është paraqitur rekursi, nuk arrinte të formonte efektivisht asnjë kolegji dhe nuk kishte/ka një kolegji tjetër që të shqyrtojë vonesat në shqyrtimin e dosjeve të regjistruara dhe as ankimi te një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë nuk është një mjet efektiv.

12.2 *E drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj*, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nga kancelari i Gjykatës së Lartë. Në çështjen konkrete nuk ka pasur shqyrtim dhe vendim nga një gjyqtar, në kuptim të nenit 154/a, pika 3, të KPC-së, sipas të cilit kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, procedurë që gjen zbatim edhe në Gjykatën e Lartë. Për analogji, bazuar në nenin 57 të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", rekursi kthehet me të meta me vendim të gjyqtarit. Formulimi në nenin 399/5 të KPC-së, duke përdorur termin "nëse", tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga vetë kërkuësi, por nëse bëhet nga avokati kërkohet prokurë. Interpretimi në themel i kancelarit të Gjykatës së Lartë i nenit 474 të KPC-së është *contra legem* i nenit 399/5 të KPC-së, që, për më tepër, është edhe *lex specialis* për procedurat në fjalë.

12.3 *E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti në Gjykatën e Lartë*, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për sa i përket procesit të themelit të çështjes, të regjistruar në datën 14.9.2017, si dhe procesit që i përket kërkesës me datë regjistrimi 30.12.2020, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Në nenin 399/2 të KPC-së është përcaktuar si i arsyeshëm afati 2-vjeçar për shqyrtimin e çështjeve civile në Gjykatën e Lartë, ndërsa në nenin 399/7 të KPC-së kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit merret në shqyrtim brenda 45 ditëve. Nga koha e regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Lartë deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar më shumë se 4 vjet dhe asnjë hap procedural nuk është ndërmarrë nga Gjykata e Lartë, përveç caktimit të gjyqtarit relator.

12.4 Në kohëzgjatjen përtej afatit të arsyeshëm nuk kanë ndikuar asnjë prej rrethanave të



parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së dhe nuk përbën shkak justifikues as reforma në drejtësi, as procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve. Si pasojë e kësaj shkeljeje, kërkuarja ka kërkuar detyrimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që t'i paguajë dëmshpërblim, si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së në raste të ngjashme.

13. Kërkuarja, në parashtrimet shtesë të datës 19.8.2021 ka kërkuar nga Gjykata që mos të marrë në konsideratë prapësimet e subjektit të interesuar, BKT-së, pasi ato janë paraqitur nga një person që ka ushtruar përfaqësimin në shkelje të statutit lidhur me kohëzgjatjen e mandatit të administratorit të bankës. Nga ana tjetër, në vijim është shprehur se mban të njëjtin qëndrim që ka shprehur GJEDNJ-ja, sipas të cilit, shteteve iu takon të angazhohen jo vetëm në zgjidhjen e situatave të ngarkuara, por edhe të parashikojnë sa të jetë e mundur ardhjen e një ngarkese të përkohshme shtesë për shkaqe të caktuara dhe të marrin masat e nevojshme për të organizuar sistemet gjyqësore në mënyrë të atillë që ato të mund të plotësojnë kërkesat e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së edhe në këto rrethana.

14. **Subjekti i interesuar, BKT-ja**, ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur qëndrimin e saj si vijon:

14.1 Kërkuarja nuk legjitimohet për të paraqitur ankim kushtetues individual, pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, më konkretisht kriterin e shterimit të mjeteve juridike. Proceset e nisura nga kërkuarja janë ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe për to ende nuk ka një vendim gjyqësor përfundimtar, si për rekursin e paraqitur, ashtu edhe për kërkesën me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Ligji procedural civil ka parashikuar mjete ligjore efektive me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me cenimin e së drejtës për gjykim ose për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, çështja konkrete nuk hyn në juridiksionin kushtetues, për sa kohë që çështjet për të cilat është paraqitur ankimi kushtetues individual janë ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

14.2 Lidhur me pretendimin për shkelje të afatit të arsyeshëm, kërkesa duhet të rrëzohet për shkak se vonesat e gjata në shqyrtimin e çështjeve

konkrete janë rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që e tejkalon rastin konkret, pasi është fakt më se i njohur se si rezultat i zhvillimit të proceseve ligjore që i përkasin reformës në sistemin e drejtësisë, janë pezulluar/shkarkuar një numër i madh gjyqtarësh, me pasojë tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore. Por, këto vështirësi janë në raport të drejtë me të mirën e përgjithshme që krijon procesi i reformës në drejtësi. Duke mbajtur në konsideratë elementët e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së shqyrtimit të një procesi gjyqësor, mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, referuar standardeve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja.

15. **Subjekti i interesuar, KESH-i**, ndonëse u njoftua rregullisht, nuk paraqiti shpjegime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarjes

16. Kërkuarja pretendon se ka pasur cenim të së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë. Ajo pretendon se mjetet e parashikuara nga legjislati në fuqi për mbrojtjen e kësaj të drejte nuk janë efektive dhe se nuk ka mjete të tjera në dispozicion, duke kërkuar edhe konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave, të garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së, të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenin 42 të Kushtetutës. Gjithashtu, kërkuarja pretendon se ka pasur një cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, lidhur me procedurat në Gjykatën e Lartë.

17. Subjekti i interesuar, BKT-ja, ka parashtruar se çështja konkrete nuk hyn në juridiksionin kushtetues, për sa kohë që çështja e themelit është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka një vendim përfundimtar.

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një



procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

19. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative.

20. Gjykata vëren se kërkesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës. Ajo ka qenë palë në procesin gjyqësor, për të cilin ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë duke pasur interes të drejtpërdrejtë.

21. Një kriter tjetër paraprak, që duhet të përmbushet nga individ i përpara se t’i drejtohet Gjykatës, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Sipas këtij kriteri kërkesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete.

22. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkesi, i cili, para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se kërkesi duhet t’i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik

mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton që kërkesi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike “efektive”, përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike, të afta për të rivendosur të drejtën, që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një “mjet efektiv” (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka vlerësuar se mjeti juridik përshpejtues është “efektiv” nëse përshpejton vendimmarrjen e gjykatës në fjalë. Ajo, gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, sipas të cilit, përpara se t’i drejtohen kësaj Gjykate, individët duhet të shfrytëzojnë mjetet që ofron sistemi juridik. Prandaj, aty ku legjislacioni ka parashikuar një mjet juridik, Gjykata do të vlerësojë nëse ky mjet është ose jo efektiv (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkesja i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe nëse këto kanë qenë efektive, për të garantuar të drejtën e individit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e kërkeses për mungesën e mjetit efektiv të përshpejtimit të procedurave, që ajo e ka ngritur në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, si dhe për cenimin e aksesit dhe të gjykatës së caktuar me ligj në këtë lloj procedure.

27. Sipas të dhënave të Gjykatës së Lartë, rezulton se rekursi i kërkeses është paraqitur në datën 20.5.2016 dhe regjistruar në këtë gjykatë me nr. 1111-02028-00-2016, datë 15.6.2016, dhe nuk ka ende një vendimmarrje për të. Gjithashtu, kërkesja ka paraqitur një kërkesë në Gjykatën e Lartë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimit të procedurave gjyqësore në gjykimin e çështjes, fillimisht në datën 14.12.2020 dhe më pas në datën 30.12.2020, e regjistruar në po atë datë, e cila, sipas të dhënave të bëra publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, do të shqyrtohet më 3 nëntor 2021.

28. Gjykata në jurisprudencën e saj e ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave me objekt për mosgjykimin e çështjeve brenda një afati



të arsyeshëm, edhe kur për to nuk ishte dhënë një vendim përfundimtar, ose për mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak se legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në datën 30.3.2017 ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 38/2017, “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, i cili ka përfshirë dispozita të reja në KPC për afatet e arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, nenet 399/1–399/12. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore, të parashikuara në kreun X, titulli III, pjesa e dytë, të KPC-së, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni vendës parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtëm të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se mjeti juridik, i parashikuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, në parim është efektiv, por që të jetë i tillë edhe në praktikë, kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, në bazë të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së, duhet të shqyrtohet me shpejtësi nga gjykata (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa më lart, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata rithekson se mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së në parim janë efektive. Për sa i takon efektivitetin të tyre në praktikë, Gjykata, në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuara nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, vlerëson se duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në këtë aspekt, Gjykata mban në konsideratë edhe faktin se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë mjete relativisht të reja (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Përveç sa më sipër, Gjykata ka theksuar se gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t’i shqyrtojnë këto kërkesa me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. Në këtë aspekt, gjykatat, në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kriteret të tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t’i vijë kërkuesit, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjykimit, organizimi i brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter tjetër i rëndësishëm, me qëllim që mos të cenohet thelbi i së drejtës për mjet efektiv (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se deri në zhvillimin e seancës plenare mbi bazën e dokumenteve në datën 28.10.2021, Gjykata e Lartë nuk e kishte marrë ende në shqyrtim kërkesën për përshpejtim të rekursit, të paraqitur nga kërkuesja, bazuar në nenet 399/6 e vijuese të KPC-së në datën 30 dhjetor 2020. Kjo kërkesë për përshpejtim, sipas nenit 399/7 të të njëjtit kod, duhej të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi brenda 45 ditëve. Po ashtu, Gjykata konstaton se veprimi administrativ për kthimin e kërkesës për përshpejtim nga kancelari i Gjykatës së Lartë, për t’u nënshkruar nga një avokat, nuk ka mbajtur në konsideratë ndryshimin e këtyre kërkesave nga rekursi, në pikëpamje të përmbajtjes, të aksesit dhe sidomos të shpejtësisë që duhet të karakterizojë marrjen në shqyrtim të tyre. Thënë ndryshe, kërkesat për përshpejtim janë trajtuar njësoj si procedurat e zakonshme të gjykimit.

34. Gjykata vlerëson se veprimet administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë me shkresën e tij nr. 3102/1 prot., datë 21.12.2020, “*Kthim kërkesë për konstatim shkeljeje afati të arsyeshëm*”, kanë qenë një faktor shtesë që ka ndikuar në vonesat e shkaktuara në shqyrtimin e kërkesës së kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

35. Në vijim, Gjykata evidenton se Gjykata e Lartë ka rifilluar të funksionojë në datën 11 mars 2020 me krijimin e një trupi gjyqësor me tre gjyqtarë, gjë që vështirësonte shqyrtimin me



shpejtësi të kërkesës për përshpejtim, pasi në bazë të nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, këto kërkesa shqyrtohen nga një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë nga ai që shqyrton çështjen e themelit. Megjithatë, Gjykata konstaton se ndonëse numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë është rritur në vijim, në mars 2021 funksiononte me 7 gjyqtarë dhe prej korrikut 2021 funksionon me trup prej 9 gjyqtarësh, sërish kërkesa për përshpejtim, e paraqitur nga kërkuësja, nuk është marrë në shqyrtim.

36. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se nga paraqitja e kërkesës për përshpejtim deri në ditën e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve, datë 28.11.2021, ka kaluar një kohë relativisht e gjatë. Vetëm në datën 25.10.2021 Gjykata e Lartë ka shpallur gjykimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në datën 3.11.2021, kërkesë e paraqitur prej kërkuëses fillimisht që në datën 14.12.2020. Gjykata thekson se nëse një kërkesë përshpejtimi nuk shqyrtohet me shpejtësi, ajo humbet qëllimin e saj për shkak të natyrës së këtyre procedurave, të cilat janë të ndryshme nga një procedurë e zakonshme gjyqimi. Për këtë arsye, Gjykata do të ndalet veçanërisht të sjellja e autoriteteve që ndikon në shpejtësinë e gjykimit në rastin konkret.

37. Nga të dhënat që Gjykata e Lartë ka paraqitur në Gjykatë, rezulton se janë 18 çështje të regjistruara për konstatim shkelje afati dhe përshpejtim të procedurave, sa u përket mosmarrëveshjeve që janë në gjykim në Gjykatën e Lartë, të cilat ndodhen në fazën e studimit. Gjykata, referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, konstaton se janë arsyetuar disa vendime me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për mosmarrëveshje në këtë gjykatë (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata, referuar Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020, vëren se KLGJ-ja ka marrë masa për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, duke angazhuar personel ndihmës, si dhe duke marrë masa të tjera për këtë qëllim. Edhe në shkresën e Gjykatës së Lartë, dërguar për informacion Gjykatës, rezulton se ajo ka marrë hapa konkretë, duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e

numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, si: rritja e kapaciteteve njerëzore, inventarizimi i çështjeve, përpunimi deri në shqyrtimin e tyre, si dhe përgatitja e planeve të veprimit me qëllim shqyrtimin e çështjeve sipas kronologjisë kohore dhe specifikës së çështjes.

39. Ndërkohë që Gjykata i ka vlerësuar masat e mësipërme që janë marrë nga autoritetet përkatëse, të cilat së bashku me mjetin përkatës të përshpejtimin të proceseve të gjykimit i shërbejnë qëllimit të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë gjyqësore. Ajo thekson se ky mjet mund të jetë efektiv në rrethana të zakonshme të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor. Në rastin konkret, ngrihen dyshime për mundësitë që mjeti përshpejtues ka për t'iu përgjigjur në shkallën e duhur nevojës së të drejtës së individëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në raport me mundësitë reale të sistemit gjyqësor, për shkak të vëllimit të lartë të çështjeve, si dhe burimeve njerëzore dhe infrastrukture të tij në tërësi (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Duke marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata çmon se kërkesa për përshpejtim, e paraqitur nga kërkuësja, nuk është marrë në shqyrtim me shpejtësi nga Gjykata e Lartë, që do të thotë se ky mjet juridik nuk i ka shërbyer qëllimit të tij - përshpejtimin të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të rekursit të kërkuësës. Me fjalë të tjera, mjeti juridik “kërkesa për përshpejtim”, që kërkuësja ka pasur në dispozicion, sipas nenit 399/6 të KPC-së, nuk ka qenë *efektiv*, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkuësja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjetit juridik.¹

41. Për sa i përket pretendimit të kërkuësës për detyrimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që t'i paguajë dëmshpërblim, si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së në raste të ngjashme, Gjykata vlerëson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ky pretendim i kërkuësës nuk bën pjesë në juridiksionin e saj.

42. Në lidhje me kriterin tjetër, atë të respektimit të afatit të paraqitjes së kërkesës, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vëren se në kushtet e një shkeljeje që

¹ Votuan kundër anëtarët F. Papajorgji dhe A. Binaj.



vazhdon të ekzistojë, pavarësisht se nuk ka vendim përfundimtar për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, kërkuësja i lind e drejta t'i drejtohet Gjykatës në çdo kohë përgjatë periudhës që shkelja vazhdon. Në rastin konkret afati është tejkaluar dhe, në këtë kuptim, kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

43. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se në vështirësi të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përbën objekt vlerësimi për kontrollin kushtetues.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

44. Kërkuësja pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti në Gjykatën e Lartë, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për sa i përket procesit të themelit të çështjes, për shkak të kalimit të afatit të arsyeshëm 2-vjeçar, të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "B", të KPC-së.

45. Subjekti i interesuar, BKT-ja, ka prapësuar se vonesat e gjata në shqyrtimin e çështjeve konkrete janë rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që i përkasin zhvillimit të proceseve ligjore të reformës në sistemin e drejtësisë dhe se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, referuar standardeve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja.

46. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

47. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 18, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të

gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuësit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

49. Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procesit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Lidhur me periudhën që duhet marrë në konsideratë, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuësës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me periudhën nga data 20.5.2016, kur rekursi është paraqitur në Gjykatën e Lartë, deri ditën e gjykimit nga Gjykata, kur rekursi i kërkuësës ende nuk është marrë në shqyrtim.

51. Për sa i takon gjykimit të mosmarrëveshjeve civile, me ndryshimet e vitit 2017, Gjykata vëren se KPC-ja në nenin 399/2 ka parashikuar afatet e arsyeshme, duke përcaktuar qartësisht se çështjet civile në gjykatën e shkallës së parë, në apel dhe në Gjykatën e Lartë duhet të shqyrtohen në secilin proces brenda një afati 2-vjeçar. Neni 109 i ligjit nr. 38/2017 (dispozitë kalimtare), parashikon se për çështjet që kanë qenë në gjykim në datën e hyrjes në fuqi të neneve 399/1-399/12 të KPC-së, afati kohor i parashikuar për gjykimin e çështjes civile shtyhet me 1 vit e 6 muaj.

52. Gjykata konstaton se rekursi i kërkuësës është paraqitur që në datën 20.5.2016. Në këtë kuptim, kërkuësja ka pasur pritshmëri se shqyrtimi i çështjes së saj nuk do të vonohej përtej afateve ligjore të lartpërmendura.

53. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se *prima facie* në rastin konkret ka një tejzgjatje të procedurave gjyqësore. Në këtë kontekst, për të arritur në



konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të analizohen elementet e tjera.

ii. Sjellja/interesi për kërkuesen dhe rrezikun që passjell tejzgjatja e procedurave për të

54. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Sipas GJEDNJ-së, sjellja e kërkuesve përbën një faktor objektiv që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse është tejkaluar koha e arsyeshme, sipas kërkesave të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës (*shih Humen kundër Polonisë [GC], 15 tetor 1999, § 66*). Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshejtim të posaçëm gjykimi në procedurat vendëse. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor. Prandaj është thelbësore të trajtohen me shpejtësi të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë (*shih Tsikakis kundër Gjermanisë, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68; Nuutinen kundër Finlandës, 27 qershor 2000, § 110*), punësimin (*shih Thlimmenos kundër Greqisë [GC], 6 prill 2000, paragrafët 60 dhe 62*), “sëmundje të pashërueshme” dhe “jetëgjatësi më të shkurtër” (*A. dhe të tjerët kundër Danimarkës, 8 shkurt 1996, §§ 78-81; X kundër Francës, 31 mars 1992, § 47*).

56. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuesen dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkueses nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë që në padinë e saj ajo ka kërkuar detyrimin e shoqërisë së paditur, “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj dhe fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore sipas normës

Tribor njëditor të vendosur nga Banka e Shqipërisë, deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

57. Po ashtu, sikurse kanë arsyetuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, ndër të tjera, nuk ka rezultuar që kërkuesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur, për të cilat pretendon se kanë shkaktuar moslidhjen në vijimësi të kontratave të mëtejshme të shërbimit me shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” sh.a. dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit, duke qenë se nuk u vërtetua të jenë bërë bisedime, kërkesa ose marrëveshje paraprake për ndonjë kontratë shërbimi për urdhra ekzekutimi të tjerë. Ndërkohë, nga ana tjetër, vetë shoqëritë “CEZ” sh.a. dhe “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” sh.a. kanë nënshkruar një “Marrëveshje bashkëpunimi për fillimin e ekzekutimit vullnetar të detyrimeve të njohura dhe pezullimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm”. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesja është person juridik dhe procesi për të cilin ka iniciuar procedurat gjyqësore është civil, i cili nuk ka të bëjë me interes të ngushtë vetjak, të tillë që do të diktonte shqyrtimin me përparësi të tij. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kanë përparësi në radhën e shqyrtimit, siç janë ato që kanë të bëjnë me pensionin, kujdestarinë ose raste të tjera të ngjashme, për të cilat mund të tregohet një kujdes më i madh.

58. Nga ana tjetër, nga pikëpamja e shpejtësisë në gjykim, Gjykata evidenton se në *parim* çështjet civile paraqiten më pak prioritare në raport me çështjet penale, që kanë të bëjnë me kufizimin e lirisë së individit dhe ato administrative, të cilat vetë ligjvënësi i ka përcaktuar si çështje që kërkojnë shpejtësi në gjykimin e tyre, duke parashikuar afate më të shpejta gjykimi. Po kështu, pa paragjykuar rastet e çështjeve civile, të cilat paraqesin natyrë urgjente, Gjykata konstaton se çështja civile e kërkueses lidhet me shpërblimin e dëmit të shkaktuar gjatë procedurës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv midis dy shoqërive tregtare dhe, siç u parashtrua më lart, tejzgjatja nuk paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku.

59. Në përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret, tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkueses.

*iii. Komplexiteti i çështjes*

60. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Komplexiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 32, datë 30.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo ka theksuar, gjithashtu, se kompleksiteti i çështjes lidhet me një sërë faktorësh, siç janë natyra e fakteve dhe provave të çështjes, aspekte të ligjit ose ndërthurjes së ligjeve apo akteve, numri i palëve pjesëmarrëse në proces (*shih vendimin 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Në rastin konkret, Gjykata, veç faktit se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile, vëren, gjithashtu, se palë ndërgjyqëse në këtë proces janë kërkuesja, BKT-ja dhe KESH-i, të cilët janë persona juridikë që kanë mosmarrëveshje për procedurën e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv gjatë një veprimtarie tregtare. Objekti i gjykimit lidhet me pretendimin për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar kërkueses, fitimin e munguar dhe kamatat ligjore përkatëse, për llogaritjen e të cilave gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje është kryer edhe ekspertizë ekonomike. Gjykata në vijim konstaton se procedurat para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë zgjatur përafërsisht 11 muaj, periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar 14 seanca gjyqësore. Po ashtu, procedurat para Gjykatës së Apelit Tiranë kanë zgjatur rreth 12 muaj.

62. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë paraqet elemente kompleksiteti.

in. Sjellja e autoriteteve

63. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 16, datë*

16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese). Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Hyrja në fuqi e një ligji kushtëzon hyrjen në fuqi të normave të prodhuara prej tij ose, e thënë ndryshe, zbatueshmërinë e tyre nga ana e të gjitha organeve, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Në të kundërt, është detyrë e ligjvënësit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 81, datë 28.12.2015; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata ka vlerësuar të tregojë një qasje më të kujdesshme, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të këtij lloji. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Gjykata ka vërejtur se Gjykata e Lartë ka marrë hapa konkretë, duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë. Gjithsesi, edhe në këtë rast, Gjykata rithekson se



masat e marra nga autoritetet shqiptare nuk janë të mjaftueshme, përderisa procedurat në Gjykatën e Lartë po zgjasin tej afateve të arsyeshme (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

66. Për sa më lart, sa i takon sjelljes së autoriteteve, Gjykata vlerëson se situata nuk është në nivelet e duhura të eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet që mund të çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore.

67. Në përfundim, në rastin konkret, edhe pse duket se deri diku ka një tejzgjatje të procesit, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuësës, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë, në pritje për t'u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, vlerëson se nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.11. 2021.

Shpallur më 1.12.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo, Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja

VENDIM Nr. 35, datë 1.11.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Elsa Toska	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Përparim Kalo	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.10.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 7 (S) të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Selman Gazidedja

SUBJEKT I INTERESUAR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave në gjykimin e çështjes administrative nr. 31003-00307-00-2018 akti, datë regjistrimi 7.2.2018 dhe çështjes nr. 8/3 regjistri, datë 18.9.2020 në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1, dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Përparim Kalo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësit, i cili kërkoj pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit i është miratuar pension i veçantë si minator nëntoke, me vjetërsi pune të përgjithshme 28 vjet, në masën 8,536 lekë, duke filluar prej datës 1.4.2001, me vendimin nr. 1243, datë 3.9.2001, të Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër (DRSSH). Me ndryshimin e vendbanimit nga Bulqiza në Tiranë në vitin 2002, kërkuesi ka kërkuar kalimin e pensionit në Tiranë.

2. Në datën 19.3.2015 kërkuesi i është drejtuar Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë për lidhjen e pensionit të pleqërisë, por nuk ka marrë përgjigje dhe, në vijim, e ka përsëritur kërkesën në datën 15.4.2016, duke iu drejtuar DRSSH-së, Tiranë.

3. Në datën 6.5.2016, DRSSH-ja, Tiranë i ka përcjellë kërkuesit vendimin nr. 398/2, datë 15.1.2016, “Për mbylljen e trajtimit të veçantë, caktimin e masës si debitor dhe refuzimin e së drejtës për përfitim pensioni pleqërie”, marrë sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, pasi, nga verifikimet e kryera, ka konstatuar se ai nuk ka punuar 11 vjet e 6 muaj, afat i përcaktuar për përfitimin e pensionit, sipas nenit 2 të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, por vetëm 10 vjet e 5 muaj e 16 ditë. Për këtë arsye atij i është refuzuar kërkesa për përfitim pensioni pleqërie, si dhe është shpallur debitor për shumat e tepërta, të përfituara nga data 1.4.2001 deri në datën 10.7.2012.

4. Kërkuesi ka paraqitur padi kundër vendimit të mësipërm të DRSSH-së Tiranë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 4969 (80-2016-5012), datë 25.10.2016, ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Shfuqizimin e aktit administrativ ‘Vendim nr. D për mbylljen e pensionit’, datë 10.7.2015 të DRSSH Tiranë dhe për shpalljen debitor të paditësit Selman Gazidedja, në shumën 2.102.069 (dy milionë e njëqind e dy mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, si akt administrativ i pabazuar në ligj. Detyrimin e palës së paditur, DRSSH, t’i caktojë paditësit Selman Gazidedja, pensionin e pleqërisë sipas ligjit, si punonjës nëntoke miniere, nga data e paraqitjes së kërkesës, 1.1.2015 e në vazhdim...”*

5. Për ankimin e DRSSH-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4685, datë 9.11.2017, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 4969 (80-2016-5012), datë 25.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjesbëm të padisë së paditësit Selman Gazidedja. Shfuqizimin pjesërisht të vendimit për mbylljen e pensionit të datë 10.7.2015, lidhur me shpalljen debitor të paditësit Selman Gazidedja, për përfitimet e tërhequra për periudhën nga data 1.4.2001 deri në datën 10.7.2012. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërkeve...”*

6. Kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili është regjistruar me nr. 31003-00307-00-2018 akti, datë regjistrimi 7.2.2018 dhe meqenëse çështja nuk po gjykohej, ai i është drejtuar sërish asaj në datën 18.9.2020 për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes, bazuar në nenet 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Me shkresën nr. 1919/1 prot., datë 9.9.2020 *“Kthim kërkesë për konstatim shkelje afati të arsyeshëm”*, kancelari i Gjykatës së Lartë ka njoftuar kërkuesin se kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nuk është nënshkruar nga një avokat i autorizuar me akt përfaqësimi, kriter i parashikuar në nenin 474 të KPC-së dhe, në këto kushte, ia ka kthyer atë për plotësim.

8. Në datën 18.9.2020 kërkuesi e ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, tashmë të nënshkruar prej tij dhe avokatit, por ajo nuk është gjykuar ende.

9. Me shkresën nr. 1010/1 prot., datë 1.4.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, në vijim të një kërkesë tjetër të kërkuesit për marrje informacioni lidhur me statusin e rekursit dhe të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, ai është njoftuar se të dyja çështjet ndodhen në fazën e studimit, në pritje për t’u shqyrtuar në dhomë këshillimi nga kolegjet përkatëse të Gjykatës së Lartë.

10. Në datën 26.4.2021, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, sipas objektit të kërkesës. Kolegji i Gjykatës në datën 21.5.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve të Gjykatës, e cila në datën 28.6.2021 ka



vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës, duke parashtruar përmbledhtazi se janë cenuar:

11.1 *E drejta e aksesit dhe gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi kërkesa për përshpejtimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë i është kthyer pa veprime. Çështja konkrete nuk është shqyrtuar nga një gjyqtar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 57 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012). Edhe sipas nenit 154/a, pika 3, të KPC-së kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, detyrim që përfshin edhe Gjykatën e Lartë. Përdorimi i termit “nëse” në nenin 399/5 të KPC-së do të thotë se kërkesa mund të bëhet (pra, edhe të nënshkruhet) nga vetë kërkuesi dhe, nëse bëhet nga avokati, kërkohet akt përfaqësimi. Sipas kërkuesit, kancelari i Gjykatës së Lartë ka bërë interpretimin në themel, duke shkelur kështu nenin 399/5 të KPC-së, që është edhe ligji i posaçëm për procedurat në fjalë, pasi ka vendosur gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke marrë atributet e gjykatës së caktuar me ligj. Sipas kërkuesit, edhe KPC-ja në nenet 482 dhe 482/a përcakton gjykatën si organin që vendos nëse çështja do të shqyrtohet në dhomë këshillimi ose në seancë.

11.2 *E drejta për mjet ligjor efektiv për përshpejtimin e procedurave*, pasi rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 7.2.2018 dhe prej më shumë se 3 vjetësh e 8 muajsh nuk ka ende një vendimarrje. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë e ka objektivisht të pamundur nga ana procedurale që ta shqyrtojë ankimin për shkeljen e afatit dhe ndreqjen e pasojave. Sipas tij, edhe pse emërimi i gjyqtarëve të rinj mund të sjellë krijimin e një kolegji të ri në Gjykatën e Lartë, i cili do të shqyrtojë kërkesat për konstatimin e shkeljeve të afatit të arsyeshëm, kjo nuk e ndryshon thelbin e kërkesës, pasi efektiviteti i mjetit juridik vlerësohet nga momenti i paraqitjes së saj, çka do të thotë se Gjykata e Lartë nuk është mjet efektiv për zgjidhjen e pretendimeve që lidhen me shkeljen e afateve procedurale.

11.3 *E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë*, pasi as rekursi për themelin e çështjes dhe as kërkesa për përshpejtimin e gjykimit nuk janë gjykuar brenda afateve. Në nenin 399/2 të KPC-së është përcaktuar afati 1 vit si i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve në shkallë të parë dhe në apel. Ndonëse dispozita nuk ka parashikuar afat specifik për çështjet administrative që gjykohen nga Gjykata e Lartë, kjo mungesë parashikimi nuk e bën të pazbatueshme procedurën e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, pasi në këtë rast gjen zbatim afati i përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 7.2.2018 dhe deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar mbi 3 vjet dhe ajo nuk ka kryer asnjë veprim tjetër, përveçse ka caktuar gjyqtarin relator. Në tejkalimin e afatit të arsyeshëm nuk ka ndikuar asnjë prej rrethanave, të parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së dhe nuk mund të shërbejë si justifikim as reforma në drejtësi me pasojat e saj, përfshirë procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve.

1.12. **Subjekti i interesuar**, DRSSH-ja, Tiranë, nuk ka paraqitur prapësime, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta e aksesit dhe gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë, si dhe për faktin se ai ka vendosur gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke marrë atributet e gjykatës së caktuar me ligj. Ai pretendon se mjetet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e kësaj të drejte nuk janë efektive dhe se nuk ka mjete të tjera në dispozicion, duke kërkuar edhe konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave, të garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së, të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të saj, si dhe nenin 42 të Kushtetutës. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se ka pasur një cenim të së drejtës për proces të rregullt



ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, lidhur me procedurat në Gjykatën e Lartë.

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Ankimi kushtetues individual, në vijim të dispozitave kushtetuese, rregullohet edhe nga dispozitat e ligjit nr. 8577/2000, i cili në nenin 71/a përcakton si kriter legjitimiteti shterimin e mjeteve juridike, paraqitjen e kërkesës brenda afatit përkatës, ardhjen drejtpërdrejt e realisht të pasojave, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur. Këto kriter janë kumulative.

16. Në analizë të përmbushjes së kriterit *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuksi legjitimohet për paraqitjen e kërkesës pranë saj, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, për të cilin ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë.

17. Një kriter tjetër paraprak, që duhet të përmbushet nga individit përpara se t’i drejtohet Gjykatës, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuksi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se kërkuksi duhet t’i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese

të pretenduar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton se kërkuksi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike “efektive”, para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike, të afta për të rivendosur të drejtën, që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një “mjet efektiv” (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Sipas GJEDNJ-së, mjeti juridik përshpejtues është “efektiv” nëse përshpejton vendimmarrjen e gjykatës në fjalë. Ajo, gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, i cili bën të mundur shmangien që individët t’i drejtohen sistematikisht kësaj gjykate për pretendime që mund të shqyrtohen më mirë brenda sistemit juridik kombëtar. Prandaj, aty ku ligjvënësi ose gjykatat vendase kanë marrë përsipër të luajnë rolin e duhur të tyre, duke parashikuar një mjet juridik të brendshëm, kësaj gjykate do t’i duhet të vlerësojë nëse mjeti është ose jo efektiv (*shih Scordino kundër Italisë (nr. 1) [GC], 29 mars 2006, §§ 184, 188–189*).

21. Në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuksi i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe nëse këto kanë qenë efektive, për të garantuar të drejtën e individit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e kërkuksit për mungesën e mjetit efektiv të përshpejtimit të procedurave që ajo ka ngritur, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, si dhe për cenimin e aksesit dhe të gjykatës së caktuar me ligj në këtë lloj procedure.

22. Sipas të dhënave të Gjykatës së Lartë, rezulton se rekursi i kërkuksit është regjistruar në datën 7.2.2018, por nuk ka ende një vendimmarrje për të. Gjithashtu, kërkuksi ka paraqitur një kërkesë në Gjykatën e Lartë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimit të procedurave gjyqësore në gjykimin e çështjes, fillimisht në datën 2.9.2020 dhe më pas në datën 18.9.2020, e regjistruar në po atë datë, për të cilën



deri në ditën e shqyrtimit të kësaj çështjeje pranë Gjykatës, nuk ishte caktuar ende një datë shqyrtimi.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj e ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave me objekt për mosgjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, edhe kur për to nuk ishte dhënë një vendim përfundimtar, ose për mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak se legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në datën 30.3.2017, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 38/2017, “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, i cili ka përfshirë dispozita të reja në KPC për afatet e arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, nenet 399/1–399/12. Me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve në datën 5.11.2017, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni vendas parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes së të drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se mjeti juridik, i parashikuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së në parim është efektiv, por, që të jetë i tillë edhe në praktikë, kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në bazë të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së, duhet të shqyrtohet me shpejtësi nga gjykata (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, 12 tetor 2021, § 107 dhe 119*).

26. Po në këtë vendim, për sa i përket shqyrtimit nëse mjeti juridik ishte efektiv në praktikë, GJEDNJ-ja ka konstatuar se pas hyrjes në fuqi të mjetit përshpejtues/parandalues më 5 nëntor 2017, në bazë të neneve 399/6, pika 1, e vijuese të KPC-së (dispozitat e reja), në rastin e kërkuarit nuk është efektiv, pasi nuk i ka shërbyer qëllimit të përshpejtimit të procedurave në Gjykatën e Lartë ose parandalimit të tejzgjatjes së tyre në mënyrë të paarsyeshme. Për më tepër, kërkuari nuk ka pasur mundësi të kërkojë as kompensim për kohëzgjatjen e atyre procedurave,

në bazë të pikës 3 të nenit 399/6 të KPC-së, për shkak të mungesës së konstatimit të cenimit të gjykimit brenda një “afati të arsyeshëm” (*po aty, §§ 121-123*). Pavarësisht kësaj, GJEDNJ-ja është shprehur se qëndrimi i saj në këtë vendim mund të bëhet objekt rishikimi në të ardhmen, në varësi të kapaciteteve të gjykatave vendase për të zhvilluar dhe mbajtur një jurisprudencë të qëndrueshme për zbatimin e mjetit juridik, në përputhje me kriteret e KEDNJ-së (*po aty, § 120*).

27. Gjykata rithekson se mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, në parim, janë efektive, pasi plotësojnë standardet lidhur me mjetin efektiv përshpejtues dhe dëmshpërblyes. Për sa i takon efektivitetin të tyre në praktikë, Gjykata, në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, vlerëson se duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Edhe sipas GJEDNJ-së, kur vlerësohet efektiviteti i një mjeti juridik që lidhet me tejzgjatjen e procedurave ka rëndësi të përcaktohet nëse kërkuarisi i garantohet zhdëmtim i drejtpërdrejtë dhe i shpejtë sesa mbrojtje e tërthortë e të drejtave për proces të rregullt ligjor (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, 12 tetor 2021, § 76*). Në këtë aspekt, Gjykata mban në konsideratë edhe faktin se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimit të procedurave, nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë rregulla relativisht të reja (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Përveç sa më sipër, Gjykata ka theksuar se gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t’i shqyrtojnë këto lloj kërkesash me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. Në këtë aspekt, gjykatat, në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kriteret të tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkitimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t’i vijë kërkuarisi, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjykimit, organizimi i brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter i rëndësishëm, me qëllim që të mos cenohet thelbi i së drejtës



(shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).

29. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se deri në zhvillimin e seancës plenare mbi bazën e dokumenteve në datën 28.10.2021, Gjykata e Lartë nuk e kishte marrë ende në shqyrtim kërkesën për përshpejtim të rekursit, të paraqitur nga kërkuesi, bazuar në nenet 399/6 e vijuese të KPC-së në datën 18 shtator 2020. Kjo kërkesë për përshpejtim, sipas nenit 399/7 të të njëjtit kod, duhej të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi brenda 45 ditëve. Po ashtu, Gjykata konstaton se veprimi administrativ për kthimin e kërkesës për përshpejtim nga kancelari i Gjykatës së Lartë, për t'u nënshkruar nga një avokat, nuk ka mbajtur në konsideratë ndryshimin e këtyre kërkesave nga rekursi, në pikëpamje të përmbajtjes, të aksesit dhe sidomos të shpejtësisë që duhet të karakterizojë marrjen në shqyrtim të tyre. Thënë ndryshe, kërkesat për përshpejtim janë trajtuar njësoj si procedurat e zakonshme të gjyqimit.

30. Gjykata vlerëson se veprimi administrativ i kancelarit të Gjykatës së Lartë me shkresën e tij nr. 1919/1 prot., datë 9.9.2020 "*Kthim kërkesë për konstatim shkelje afati të arsyeshëm*", ka qenë një faktor shtesë që ka ndikuar në vonesat e shkaktuara në shqyrtimin e kërkesës së kërkuarit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

31. Në vijim, Gjykata evidenton se Gjykata e Lartë ka rifilluar të funksionojë në datën 11 mars 2020 me krijimin e një trupi gjyqësor me 3 gjyqtarë, gjë që vështirësonte shqyrtimin me shpejtësi të kërkesës për përshpejtim, pasi, në bazë të nenit 399/6, pika 1, shkronja "c", të KPC-së, këto kërkesa shqyrtohen nga një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë nga ai që shqyrton çështjen e themelit. Megjithatë, Gjykata konstaton se ndonëse numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë është rritur në vijim, në mars 2021 funksiononte me 7 gjyqtarë dhe prej korrikut 2021 funksionon me trup prej 9 gjyqtarësh, sërish kërkesa për përshpejtim, e paraqitur nga kërkuesi, nuk është marrë në shqyrtim.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se nga paraqitja e kërkesës për përshpejtim deri në ditën e seancës plenare ka kaluar një kohë relativisht e gjatë. Gjykata thekson se nëse një kërkesë përshpejtimi nuk shqyrtohet me shpejtësi, ajo

humbet qëllimin e saj për shkak të natyrës së këtyre procedurave, të cilat janë të ndryshme nga një procedurë e zakonshme gjyqimi. Për këtë arsye, Gjykata do të ndalet veçanërisht të sjellja e autoriteteve që ndikon në shpejtësinë e gjyqimit në rastin konkret.

33. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 2081/1 prot., datë 22.6.2021, ka informuar Gjykatën se janë 18 çështje të regjistruara për konstatim shkeljeje afati dhe përshpejtim të procedurave, për sa u përket mosmarrëveshjeve që janë në gjykim, të cilat ndodhen në fazën e studimit. Gjykata, referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, konstaton se janë arsyetuar disa vendime me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për mosmarrëveshje në këtë gjykatë (shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).

34. Gjykata, referuar *Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020*, vëren se KLGJ-ja ka marrë masa për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, duke angazhuar personel ndihmës dhe duke marrë masa të tjera për këtë qëllim. Edhe në shkresën e Gjykatës së Lartë, dërguar për informacion Gjykatës, rezulton se Gjykata e Lartë ka marrë hapa konkretë duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, si: rritja e kapaciteteve njerëzore, inventarizimi i çështjeve, përpunimi deri në shqyrtimin e tyre, si dhe përgatitja e planeve të veprimit me qëllim shqyrtimin e çështjeve sipas kronologjisë kohore dhe specifikës së çështjes.

35. Ndërkohë që Gjykata i ka vlerësuar masat e mësipërme që janë marrë nga autoritetet përkatëse, të cilat së bashku me mjetin përkatës të përshpejtimin të proceseve të gjyqimit i shërbejnë qëllimit të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë gjyqësore, ajo thekson se ky mjet mund të jetë efektiv në rrethana të zakonshme të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor. Në rastin konkret ngrihen dyshime për mundësitë që mjeti përshpejtues ka për t'iu përgjigjur në shkallën e duhur nevojës së të drejtës së individëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në raport me mundësitë reale të sistemit gjyqësor, për shkak të vëllimit të lartë të çështjeve, si dhe burimeve njerëzore dhe



infrastrukturore të tij në tërësi (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke pasur parasysh situatën e mësipërme, Gjykata ka marrë në konsideratë tashmë përpjekjet e autoriteteve shqiptare për përmirësimin e legjislacionit për të parashikuar mjete juridike efektive për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, si dhe veprimet e ndërmarra nga KLGJ-ja dhe Gjykata e Lartë për uljen e numrit të çështjeve për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Megjithatë, ajo ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, duke konsideruar natyrën e çështjes së themelit, ngarkesën e kolegjit përkatës dhe ngarkesën e gjyqtarit relator, mund të gjendet në vështirësi për të respektuar afatet ligjore. Pavarësisht këtyre elementeve, Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillt në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos e humbasë qëllimin e saj dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në rastin konkret, Gjykata çmon se kërkesa për përshpejtim, e paraqitur nga kërkuesi, nuk është marrë në shqyrtim me shpejtësi nga Gjykata e Lartë, që do të thotë se ky mjet juridik nuk i ka shërbyer qëllimit të tij - përshpejtimin të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të rekursit të kërkuesit para saj. Me fjalë të tjera, mjeti juridik “kërkesa për përshpejtim”, që kërkuesi ka pasur në dispozicion, sipas nenit 399/6 të KPC-së, nuk ka qenë *efektiv*, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjetit juridik².

38. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në parashtrimet e tij ka kërkuar caktimin e një shpërblimi të drejtë, si dhe detyrimin e Këshillit të Ministrave për të siguruar ekzekutimin e vendimit ose caktimin e një organi tjetër të ngarkuar me zbatimin e tij. Gjykata vlerëson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ky pretendim i kërkuesit nuk bën pjesë në juridiksionin e saj.

39. Në lidhje me kriterin tjetër, atë të respektimit të afatit të paraqitjes së kërkesës, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vëren se në kushtet e një shkeljeje që vazhdon të ekzistojë, pavarësisht se nuk ka vendim përfundimtar për kërkesën për

konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, kërkuesit i lind e drejta t’i drejtohet Gjykatës në çdo kohë përgjatë periudhës që shkelja vazhdon. Në rastin konkret afati është tejkaluar dhe, në këtë kuptim, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

40. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përbën objekt vlerësimi për kontrollin kushtetues.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

41. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti në Gjykatën e Lartë, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për sa i përket procesit të themelit të çështjes.

42. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

43. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 18, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuesit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e

² Anëtar A. Binaj votoi kundër.



afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

45. Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procesit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Lidhur me periudhën që duhet marrë në konsideratë, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me periudhën nga data 7.2.2018, kur rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë, deri ditën e gjykimit nga Gjykata, ku rekursi i kërkuarit ende nuk është marrë në shqyrtim nga ajo gjykatë.

47. Për sa i takon gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, në pikën 2 të nenit 60, të ligjit nr. 49/2012 parashikohet se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës në të cilën është dorëzuar rekursi. Nga dosja përkatëse, Gjykata konstaton se rekursi i kërkuarit është regjistruar në datën 7.2.2018 dhe është e natyrshme që kërkuari të kishte pritshmëri për shqyrtimin e çështjes së tij brenda afatit ligjor të lartpërmendur.

48. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se *prima facie* në rastin konkret ka tejzgjatje të procedurave gjyqësore dhe për të arritur në përfundimin nëse kemi të bëjmë me cenim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të analizohen elementet e tjera.

ii. Sjellja/interesi për kërkuarin dhe rreziku që sjell tejzgjatja e procedurave për të

49. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke analizuar rrethanat nëse kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtëm (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Sipas GJEDNJ-së, sjellja e kërkuarve është faktor objektiv që duhet të merret parasysh për të vlerësuar nëse është tejkaluar koha e arsyeshme në

kuadër të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës (*shih Humen kundër Polonisë [GC], 15 tetor 1999, § 66*). Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm gjykimi në procedurat vendase. Në këto raste duhet të merret parasysh çfarë vihet në pikëpyetje për kërkuarin. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjake e jetësore”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës (*shih Tsikakis k. Gjermanisë, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68; Thlimmenos k. Greqisë [GC], 6 prill 2000, §§ 60 dhe 62*) lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë.

51. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtëm, përkundrazi, nuk e ka humbur interesin, madje e ka shfaqur atë në mënyrë të pandërprerë, duke kërkuar madje edhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuarin dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuarit nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë objekt i kërkesëpadisë së tij ka të bëjë me të drejta vetjake siç është përfitimi i pensionit.

52. Nga ana tjetër, nga pikëpamja e shpejtësisë në gjykim, Gjykata evidenton se *në parim* çështjet administrative, ligjvënësi i ka përcaktuar si çështje që kërkojnë shpejtësi në gjykimin e tyre, duke parashikuar afate më të shpejta gjykimi (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Në përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret tejzgjatja e procedurave gjyqësore paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuarit.

iii. Kompleksiteti i çështjes

54. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 14, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo ka theksuar, gjithashtu, se kompleksiteti i çështjes lidhet me një sërë faktorësh, siç janë natyra e



fakteve dhe provave të çështjes, aspekte të ligjit ose ndërthurjes së ligjeve apo akteve, numri i palëve pjesëmarrëse në proces (*shih vendimin 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative dhe i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 49/2012. Nga shqyrtimi i akteve përkatëse të paraqitura nga kërkuesi, duke iu referuar objektit të kërkesëpadisë së tij, vlerësimit të provave për këtë çështje, si dhe palëve pjesëmarrëse në proces, Gjykata vëren se çështja konkrete nuk paraqet rrethana veçanërisht të vështira ose komplekse që mund të justifikonin vonesën në shqyrtimin e saj, prandaj çmon se merr rëndësi vlerësimi i sjelljes së autoriteteve.

in. Sjellja e autoriteteve

56. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

57. Në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata ka treguar një qasje më të kujdesshme për të, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Megjithatë, ajo ka vënë re se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të këtij lloji. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve,

nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Gjykata ka vërejtur se Gjykata e Lartë ka ndërmarrë hapa konkretë, duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, por ajo rithekson se masat e marra nga autoritetet shqiptare nuk janë të mjaftueshme, përderisa procedurat në Gjykatën e Lartë po zgjasin tej afateve të arsyeshme (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, siç është edhe rasti konkret, Gjykata ka vërejtur se garantimi i kryerjes së procesit të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, të parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 49/2012, është parim me rëndësi të veçantë. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative. Ky ligj synon thjeshtimin e procedurave që kanë objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative. Afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 – për veprimet përgatitore, neni 27 – për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48, pika 2 – për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60, pika 2 – rasti në shqyrtim) (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Gjykata është shprehur se respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Nga i njëjti këndvështrim, për çështje të ngjashme, Gjykata ka vlerësuar se numri i lartë i çështjeve që kanë në ngarkim këto gjykata, nuk mund të përdoren si argumente për të përligjur vonesat në shqyrtimin e çështjeve. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument



kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt, është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesa në shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 3, datë 6.12.2018; nr. 46, datë 3.7.2017; nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Duke vlerësuar sa më sipër, si dhe duke parë edhe sjelljen e autoriteteve, e cila nuk ka qenë në nivelin e duhur, për sa i përket eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra prej tyre, pasi nuk i kanë garantuar individit të drejtën për mjete juridike *efektive* ankimi, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, por edhe për shkak të natyrës së pretendimit të tij që lidhet me mjete të domosdoshme të jetesës, siç është e drejta e pensionit, Gjykata e sheh me vend të konstatojë cenimin e procesit të rregullt për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata thekson, gjithashtu, domosdoshmërinë e përshpejtimit të procedurës së gjyimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi dhe, për këtë qëllim, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ajo do të caktojë në pjesën urdhëruese të këtij vendimi edhe afatin brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata e Lartë. Në vlerësimin e Gjykatës, ky afat konsiderohet i arsyeshëm dhe i përgjigjet kushteve dhe mundësive të Gjykatës së Lartë për të vepruar në çështjen e kërkuesit.

62. Në këto kushte, Gjykata vëren se ka tejzgjatje të procedurave gjyqësore, që, së pari, nuk i atribuohet kërkuesit, i cili ka vepruar në përputhje me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë pengesë për vonesa dhe, së dyti, nuk vjen nga kompleksiteti i çështjes, e cila për nga natyra e saj nuk mund të bëjë shkak për tejzgjatjen e afatit. Së fundi, duke u nisur nga sjellja e autoriteteve, veprimet dhe mosveprimet e të cilave kanë shkaktuar tejzgjatjen e afatit të arsyeshëm, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar.

63. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se në rastin konkret është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
 3. Detyrimin e Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 4. Rrëzimin e kërtimeve të tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.11.2021.

Shpallur më 1.12.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Sonila Bejtja

Anëtarë kundër: Altin Binaj

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes me kërkues shtetasin Selman Gazidedja, jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, pasi vlerësoj se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës dhe, për rrjedhojë, në kushtet e mospërmbyshjes së këtij kriteri të legjitimitetit, kërkesa e tij duhej të rrëzohej. Për këtë arsye, bazuar në nenin 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenin 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar, në vijim po parashatroj argumentet që mbështesin qëndrimin e mësipërm.

2. Sikurse u përmend edhe më sipër, pakica vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, për shkak se ai nuk i ka shteruar më parë



të gjitha mjetet juridike efektive që ka në dispozicion nga legjislacioni shqiptar.

3. Ashtu si me të drejtë ka theksuar edhe shumica, çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

4. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur të individit.

5. Në kuptim të sa më sipër, një nga kriteret paraprake që duhet të përmbushet nga individit përpara se t'i drejtohet Gjykatës lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky rregull nënkupton që kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shpëtojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Lidhur me objektin e çështjes në këtë gjykim rezulton se prej datës 5.11.2017, kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore në nenet 399/1–399/12 të KPC-së, legjislacioni shqiptar parashikon një mjet juridik ankimi *efektiv*, i cili garanton përshpejtimin e procesit gjyqësor, si dhe dëmshpërblimin, pra sjell rezultat konkret në rivendosjen e së drejtës së shkelur për kryerjen e procesit gjyqësor brenda

afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Edhe GJEDNJ-ja, në vendimin *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, datë 12 tetor 2021*, ka arritur në përfundimin se mjeti juridik, i parashikuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së është efektiv, por që të mbetet i tillë edhe në praktikë, kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, në bazë të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së, duhet të shqyrtohet me shpejtësi nga gjykata (*shih paragrafët 107 dhe 119*).

8. Sa më lart, duke ndjekur edhe linjën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, pakica bashkohet me vlerësimin e shumicës se nenet 399/1 e vijuese të KPC-së janë efektive në parim, pasi plotësojnë standardet lidhur me mjetin efektiv përshpejtues dhe dëmshpërblyes dhe se në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike *efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, Gjykata duhet të shqyrtojë efektivitetin e këtij mjeti në dritën e rrethanave të çdo rasti konkret.

9. Po ashtu, lidhur me sa më sipër, sikurse me të drejtë ka theksuar edhe shumica, duhet mbajtur në konsideratë edhe fakti se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë rregulla relativisht të reja, ndërkohë që gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe të shqyrtojnë këto lloj kërkesash me përparësi, përndryshe ky mjet ankimi do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. Në këtë aspekt, gjykatat, në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kriteret e tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkitimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t'i vijë kërkuetit, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjyimit, organizimi i brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter i rëndësishëm, me qëllim që të mos cenohet thelbi i së drejtës (*shih paragrafët 27 dhe 28 të vendimit*).

10. Por duke qenë i të njëjtit mendim për kriteret e përgjithshme që duhen mbajtur në konsideratë për të përcaktuar efektivitetin edhe në praktikë të neneve 399/1 e vijuese të KPC-së,



pakica ka qëndrim të ndryshëm me shumicën në përfundimin që ajo ka nxjerrë, pas aplikimit të këtyre kriterëve në çështjen në gjykim.

11. Duke iu kthyer rastit konkret, rezulton se rekursi i kërkuarit është regjistruar në Gjykatën e Lartë me datë 7.2.2018 dhe nuk është gjykuar ende. Gjithashtu kërkuari ka paraqitur në datën 18.9.2020 në Gjykatën e Lartë edhe një kërkesë për konstatimin prej saj të shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimit të procedurave gjyqësore në gjykimin e kësaj çështjeje, kërkesë e cila është në fazën e studimit.

12. Lidhur me afatin e shqyrtimit të rekursit elementar të rëndësishëm për t'u konsideruar janë numri mjaft i lartë i çështjeve të mbetura në gjykim, si dhe mungesa për arsye të njohura objektive e numrit të kolegjeve të parashikuar nga ligji për funksionimin normal të asaj gjykate, i domosdoshëm sidomos për shqyrtimin e kërkesave për përsheptimin e procedurave gjyqësore.

13. Gjykata e Lartë nuk ka qenë tërësisht funksionale që nga muaji maj 2019. Ajo ka rifilluar të funksionojë në 11 mars 2020 me krijimin e një trupe gjyqësore prej tri gjyqtarësh dhe në datë 19 mars 2021 në këtë gjykatë u shtuan edhe katër gjyqtarë të tjerë, të cilët në mbledhjen e datës 1 prill 2021 të Këshillit të Gjykatës së Lartë, u caktuan në disa kolegje të Gjykatës së Lartë. Prej korrikut 2021 Gjykata e Lartë ka gjithsej në trupën e vet gjyqësore nëntë gjyqtarë.

14. Sikurse konstatohet edhe nga kronologjia e mësipërme kohore, qysh nga momenti i paraqitjes së kërkesës, në muajin shtator 2020 dhe deri në muajin prill 2021, Gjykata e Lartë e ka pasur të pamundur objektivisht të marrë në shqyrtim kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave në gjykimin e çështjes së kërkuarit Selman Gazidedja, për shkak se deri në atë periudhë ajo ka pasur vetëm një koleg, ndërkohë që në bazë të nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, këto kërkesa shqyrtohen nga një koleg tjetër i Gjykatës së Lartë nga ai që shqyrton çështjen e themelit. Ky është një fakt i rëndësishëm që dallon çështjen në gjykim nga rasti Bara & Kola, në të cilën kërkesa për përsheptimin e procedurave ishte paraqitur në Gjykatën e Lartë në një moment kohor kur ajo kishte edhe kolegje të tjera për shqyrtimin e kërkesave.

15. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 2081/1 prot., datë 22.6.2021, ka informuar Gjykatën se janë 18 çështje të regjistruara për konstatim shkelje afati dhe përsheptim të procedurave, për sa u përket mosmarrëveshjeve që janë në gjykim, të cilat ndodhen në fazën e studimit. Ndërkohë, referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se deri në muajin nëntor 2021, pas krijimit të kolegjeve të tjera të përmendura më sipër, janë zhvilluar gjykime dhe janë marrë disa vendime për çështje me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave për mosmarrëveshje në atë gjykatë.

16. Po ashtu, referuar *Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020*, vërehet se edhe KLGJ-ja ka marrë masa për reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë duke shtuar staf mbështetës dhe marrë masa të tjera për këtë qëllim. Edhe me shkresën e Gjykatës së Lartë dërguar për informacion Gjykatës, rezulton se Gjykata e Lartë ka marrë hapa konkretë, duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, si: rritja e kapaciteteve njerëzore, inventarizimi i çështjeve, përpunimi i tyre deri në shqyrtimin e tyre, përgatitja e planeve të veprimit me qëllim shqyrtimin e çështjeve sipas kronologjisë kohore dhe specifikës së çështjes (*shih paragrafin 34 të vendimit*).

17. Nga analiza në tërësinë e tyre të rrethanave të përmendura më sipër, të vlerësuara në kuadrin e çështjes konkrete, sidomos të atyre që kanë të bëjnë me faktin se në kohën e paraqitjes së kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit ishte në pamundësi objektive për të shqyrtuar kërkesën, me faktin se aktualisht kërkesa është në fazë studimi në Gjykatën e Lartë, me faktin se në Gjykatën e Lartë janë duke u gjykuar aktualisht kërkesa me objekt të njëjtë me atë të kërkuarit Selman Gazidedja, krijohet bindja e plotë e pakicës se mjeti ligjor në rastin konkret është efektiv edhe në praktikë dhe kërkuari nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese përpara se të përfundojë gjykimi i kërkesës në Gjykatën e Lartë.



18. Si rrjedhim i përfundimit të mësipërm, në vlerësimin e pakicës kërkesa e shtetasit Selman Gazidedja duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Altin Binaj

VENDIM
Nr. 37, datë 5.11.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.10.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 1 (L) 2021 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ledi Bianku, Odeta Kumbaro

SUBJEKT I INTERESUAR: Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish-ALUIZNI)

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj, konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave në gjykimin e çështjes administrative me nr. 31003-03330-00-2017, regjistruar në datën 10.11.2017, në Gjykatën e Lartë dhe konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

BAZA LIGJORE: Neni 42, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1, dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesit janë palë paditëse në procesin gjyqësor me objekt detyrimin e palës së paditur, ALUIZNI-t Tiranë, të ndryshojë pjesërisht aktin administrativ për dosjen nr. 1198 prot., të përfundojë procedurat e legalizimit për pasurinë objekt gjykimi deri në dërgimin e dosjes për regjistrim përfundimtar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Kavajë, si dhe shpërblimin e dëmit për fitimin e munguar.

2. Me vendimin nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: “*Pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë. Shfuqizimin e shkresës nr. 925/6 prot., datë 25.8.2015 të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimore Informale, Drejtoria Tirana 4. Detyrimin e palës së paditur ALUIZNI-t që të përmbyllë procedurat për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin mbi parcelën ndërtimore në lidhje me shtetasit Ledi Bianku dhe Odeta Kumbaro, sipas kontratës nr. 2017 rep., nr. 690 kol., datë 6.3.2012. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të padisë.*”. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 998 (86-2016-965), datë 13.3.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë pala e paditur në procesin gjyqësor, kurse kërkesi Ledi Bianku ka paraqitur kundërrkurs. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të asaj gjykate, rekursi rezulton të jetë regjistruar në datën 10.11.2017, me nr. 31003-03330-00-2017 dhe përveç caktimit të gjyqtarit relator, nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim tjetër në lidhje me këtë çështje.

4. Me kërkesën nr. 286 prot., datë 28.1.2021, të dy kërkesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes administrative ku janë palë, duke pretenduar se vonesa prej më shumë se 3 vjetësh u ka shkaktuar një dëm të paarsyeshëm, pasi i ka dhënë palës së paditur mundësinë të justifikojë mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore me arsyetimin se çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, si dhe u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm.



5. Me shkresën nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021, kancelari i Gjykatës së Lartë u ka kthyer përgjigje kërkesëve se në bazë të nenit 474 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), kërkesa duhet të nënshkruhet nga avokati që përfaqëson palën, ndaj u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim.

6. Me kërkesën e datës 21.4.2021, kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

7. Me vendimin e datës 21.5.2021, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 28.6.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

8. Në cilësinë e ndërhyrësit dytësor, referuar nenit 191 të KPC-së, shtetasi Bardhyl Ibra i është drejtuar Gjykatës me kërkesën e datës 22.9.2021, të regjistruar me nr. 1 (L)/II 2021, datë 29.9.2021, duke pretenduar se ky proces është me rëndësi për të. Me shkresën nr. 1 (L) 2021, datë 5.10.2021, këtij shtetasi i është kërkuar të paraqesë argumente në mbështetje të kërkesës për ndërhyrjen e tij në proces.

9. Gjykata, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë paraprake, me vendimin e ndërmjetëm të datës 28.10.2021, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar. Sipas nenit 39 të ligjit nr. 8577/2000, pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë: a) subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij; b) subjektet kundër të cilave është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet; c) organi që ka nxjerrë aktin; ç) organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë. Vlerësimi i legjitimitetit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por edhe të gjykimit kushtetues dhe, në këtë kuptim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkesit ose dhe kryesisht nga Gjykata (*shih vendimet nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerësoi se shtetasi Bardhyl Ibra nuk arriti të argumentojë interesin e tij në këtë çështje.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. *Kërkesit* pretendojnë se iu është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto elemente:

10.1 *E drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj* për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për përshpejtimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë. Në çështjen konkrete nuk ka pasur shqyrtim dhe vendim nga një gjyqtar, në kuptim të nenit 57 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (*ligji nr. 49/2012*). Edhe bazuar në nenin 154/a, pika 3, të KPC-së, kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, procedurë që gjen zbatim edhe në Gjykatën e Lartë. Formulimi në nenin 399/5 të KPC-së, duke përdorur termin “nëse”, tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga vetë kërkesi, por nëse bëhet nga avokati kërkohet prokurë. Një parashikim i tillë për detyrimin e firmës nga një avokat, në rastin kur vetë ankuesi është jurist/avokat, është joproporcional për qëllimet e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së.

10.2 *Mungesa e mjetit efektiv për përshpejtim procedurash*, në kushtet kur kërkesa fillestare për kohëzgjatje procedurash është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 10.11.2017 dhe prej më shumë se 3 vjetësh nuk ka ende një vendimmarrje prej saj. Kjo vonesë u ka shkaktuar kërkesëve një dëm të paarsyeshëm, pasi i ka dhënë mundësinë palës së paditur të justifikojë mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit.

10.3 *Mosshqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti në Gjykatën e Lartë*. Në nenin 399/2 të KPC-së është përcaktuar afati 1-vjeçar si i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve në shkallë të parë dhe në apel. Ndonëse dispozita nuk ka parashikuar afat specifik për çështjet administrative që gjykohen në Gjykatën e Lartë, kjo mungesë parashikimi nuk e bën të pazbatueshme procedurën e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, pasi në këtë rast gjen zbatim afati i përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 10.11.2017 dhe deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar 3 vjet e 4 muaj dhe nuk



është ndërmarrë asnjë hap procedural nga ajo gjykatë, përveç caktimit të gjyqtarit relator. Në kohëzgjatjen përtej afatit të arsyeshëm nuk ka ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së dhe nuk përbën shkak justifikues as reforma në drejtësi, as procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve, qëndrim i mbajtur edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

10.4 Kërkesa për shterimin e mjeteve juridike nuk mund të zbatohet në rastet kur mjeti që duhet shteruar nuk është efektiv. Efektiviteti në lidhje me këto çështje kërkon një vendim që konstaton shkëljen, urdhëron pagesën e dëmit për vonesën e shkaktuar, si dhe përshejtimin e vendimmarrjes mbi themelin. Pavarësisht përmbajtjes së nenit 399/6, pika 3, të KPC-së, mosakordimi i një dëmshpërblimi në procedurat para Gjykatës rrezikon të çojë në përfundimin se ajo nuk është mjet efektiv për qëllimet e nenit 13 të KEDNJ-së të interpretuar me nenin 6, pika 1, të saj.

10.5 Gjykata e Lartë nuk e ka objektivisht të mundur që proceduralisht të zgjidhë ankesën për shkëljen e kohëzgjatjes dhe ndreqjen e pasojave në kohë. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për përshejtim në Gjykatën e Lartë ajo kishte në përbërje vetëm një kolegji, i cili ishte vetë në vonesë në shqyrtimin e çështjes së themelit. Fakti që me zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj mund të krijohet një kolegji i ri në Gjykatën e Lartë për të shqyrtuar vonesat në shqyrtimin e çështjeve, nuk e ndryshon thelbin e ankesës, pasi efektiviteti i një mjeti vlerësohet në momentin e vënies në lëvizje të tij.

10.6 Veprimet e kryera nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), nuk cenojnë thelbin e kërkesës, pasi kërkesit janë ankuar edhe për kohëzgjatjen në mosekzekutimin e vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, i cili është një pretendim i pavarur nga ai i kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit. Kjo çështje nuk shfaq kompleksitet dhe nuk ka pasur asnjë lloj vështirësie që të krijonte vonesa në ekzekutimin e vendimit.

11. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim para Gjykatës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesësve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vëren se kërkesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, ndaj provojnë interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje.

15. Një kriter tjetër paraprak, që duhet të përmbushet nga individë përpara se t’i drejtohet Gjykatës, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000.

16. Sipas këtij kriteri kërkesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkesi, i cili, para se t’i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).



17. Gjykata ka vlerësuar se mjeti juridik përshpejtues është “efektiv” nëse përshpejton vendimarrjen e gjykatës në fjalë. Ajo, gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, sipas të cilit, përpara se t’i drejtohen kësaj Gjykate, individët duhet të shfrytëzojnë mjetet që ofron sistemi juridik. Prandaj, aty ku legjislacioni ka parashikuar një mjet juridik, Gjykata do të vlerësojë nëse ky mjet është ose jo efektiv (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesit i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe nëse ato kanë qenë efektive për të garantuar të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e tyre për mungesën e mjetit efektiv të përshpejtimit të procedurave, që ata e kanë ngritur në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, si dhe për cenimin e aksesit dhe të gjykatës së caktuar me ligj nga veprimet administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë.

19. Gjykata vëren, gjithashtu, se në jurisprudencën e saj e ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave me objekt mosgjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, edhe kur për to nuk ishte dhënë një vendim përfundimtar, ose mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, edhe kur legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12 datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Me ligjin nr. 38/2017, “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, në KPC u shtuan dispozita të reja për afatet e arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, nenet 399/1–399/12. Me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve në datën 5.11.2017, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni vendas parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata rithekson se mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së në parim janë

efektive. Për sa i takon efektivitetit të tyre në praktikë, Gjykata, në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, vlerëson se duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në këtë aspekt, ajo mban në konsideratë edhe faktin se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë mjete relativisht të reja (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Përveç sa më sipër, Gjykata thekson se gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t’i shqyrtojnë këto lloj kërkesash me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. Në këtë aspekt, gjykatat, në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kriteret e tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t’i vijë kërkuesit, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjykimit, organizimi i brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter i rëndësishëm, me qëllim që të mos cenohet thelbi i së drejtës (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi i gjykatës së apelit është kundërshtuar në Gjykatën e Lartë nga pala e paditur në procesin gjyqësor (subjekti i interesuar) dhe ndaj tij ka paraqitur kundërrekurs edhe kërkuesi Ledi Bianku. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të asaj gjykate, kjo çështje është regjistruar në datën 10.11.2017, me nr. 31003-03330-00-2017 dhe deri në datën e gjykimit të kësaj çështjeje, përveç caktimit të gjyqtarit relator, nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim tjetër.

24. Me kërkesën nr. 286 prot., datë 28.1.2021, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes administrative ku janë palë. Sipas tyre, vonesa prej më shumë se 3-vjeçare u ka shkaktuar një dëm të paarsyeshëm, pasi i ka dhënë



palës së paditur mundësinë të justifikojë mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore me arsyetimin se çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, si dhe u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt, si pasojë e mosshqyrtimit të saj brenda një afati të arsyeshëm. Me shkresën nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, kërkuesve u është kthyer përgjigje se në bazë të nenit 474 të KPC-së kërkesa duhet të jetë nënshkruar nga avokati që përfaqëson palën, ndaj ajo u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim. Në vijim, kërkuesit i janë drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese me kërkesën e datës 21.4.2021, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar pretendimet e pasqyruara më sipër në vendim.

25. Gjykata vëren se në kuptim të nenit 399/3, pika 2, të KPC-së, të drejtën për të kërkuar shpërblimin e drejtë për shkak të shkeljes së afatit të arsyeshëm e ka cilido që është i përfshirë në një proces ligjor në cilësinë e palës. Sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave në Gjykatën e Lartë, i drejtohet po asaj gjykate dhe shqyrtohet nga një kolegji tjetër, në dhomë këshillimi, brenda 45 ditëve nga paraqitja e saj (neni 399/7, pika 2).

26. Kancelari i Gjykatës së Lartë në shkresën e tij nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021 i është referuar nenit 474 të KPC-së, që përcakton kriteret formale që duhet të plotësojë rekursi, çka nuk është rasti në shqyrtim, dhe jo nenit 399/5, pika 2, shkronja “ç”, të KPC-së që parashikon: “*Bashkë me kërkesën duhet të depozitohen edhe: ç) prokurra, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.*”.

27. Gjykata rithekson se veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës) (shih vendimet nr. 68, datë 17.11.2015; nr. 48, datë 29.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përsheptim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv (shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se qasja, sipas së cilës një kërkuesi me profesion

avokat i kërkohet nënshkrimi i rekursit nga një mbrojtës, me pasojë mospranimin e tij, është formaliste dhe përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, në këndvështrim të së drejtës për t'u drejtuar gjykatës (shih *Dylus kundër Polonisë*, 23 shtator 2021 § 45).

29. Gjykata evidenton se njëri prej kërkuesve, Ledi Bianku, ka qenë pedagog efektiv i lëndëve juridike në Fakultetin e Drejtësisë, si dhe ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në GJEDNJ për periudhën 2008-2019, funksione të cilat, sipas legjislacionit të kohës, përjashtoheshin, për shkak të cilësive profesionale, nga plotësimi i kriterëve dhe kushteve të nevojshme për fitimin e titullit të avokatit dhe vetëm për këtë shkak konsideroheshin nga ligjvënësi si raste të veçanta për t'u pajisur me këtë titull.

30. Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim jo vetëm që nuk jemi para rastit të paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por të një kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përsheptimin e procedurave, por edhe se kërkesa është paraqitur nga vetë kërkuesi në cilësinë e tij si avokat dhe ish-gjyqtar në GJEDNJ. Në kuptim të sa më sipër, kërkesa e paraqitur në Gjykatën e Lartë është kthyer pa veprime nga ana e kancelarit, çka ka sjellë mosregjistrimin e saj. Kjo ka bërë që kërkuesit të mos merrnin përgjigje edhe për përsheptimin e gjykimit të çështjes së tyre në atë gjykatë, duke mos pasur as një vendim përfundimtar në lidhje me këtë kërkesë. Për rrjedhojë, interpretimi i bërë nga kancelari i Gjykatës së Lartë shkon përtej përmbajtjes dhe frymës së nenit 399/5, pika 2, shkronja “ç”, të KPC-së dhe përbën një formalizëm të tepruar. Në këtë mënyrë, nga një rregull garantues procedural, ai është kthyer në një mjet pengues të aksesit në Gjykatën e Lartë. Për shkak të këtyre rrethanave, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kërkuesit janë shkarkuar nga detyrimi për të shteruar këtë mjet juridik përpara paraqitjes së ankimit kushtetues.

31. Kërkuesit kanë kërkuar edhe konstatimin e cenimit lidhur me kohëzgjatjen në ekzekutimin e vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Kërkuesit kanë parashtruar se kanë vënë në lëvizje procedurat për përfundimin e regjistrimit të pronës së paluajtshme në pronësinë e tyre. Megjithatë, sipas kërkuesve, lëshimi i urdhrit të ASHK-së për ekzekutimin e vendimit nuk cenon thelbin e



pretendimit për kohëzgjatjen e procedurave në ekzekutim, i cili është një pretendim i pavarur nga ai i kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se kërkuessit nuk i kanë shteruar mjetet e ankimit, pasi jo vetëm që nuk kanë përdorur mjetet procedurale që ofron legjislacioni për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por ata nuk arritën as të provojnë se iu është cenuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesë për përsheptimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

32. Kërkuessit, gjithashtu, kanë kërkuar urdhërimin e gjykatës së shkallës së parë, në përputhje me nenin 399/6, pika 1, shkronja “ç” dhe 399/10 të KPC-së, për shpërblimin e dëmit për vonesën në gjykimin në Gjykatën e Lartë, në veçanti, dhe ekzekutimin e vendimit në 6 vjet e 3 muaj vonesë, në përgjithësi. Po sipas tyre, mosakordimi i një dëmshpërblimi në procedurat para Gjykatës Kushtetuese, rrezikon të çojë në përfundimin se ajo nuk është një mjet efektiv. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, vlerëson se ato nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

33. Në lidhje me kriterin tjetër, atë të respektimit të afatit të paraqitjes së kërkesës, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vëren se në kushtet e një shkeljeje që vazhdon të ekzistojë, pavarësisht se nuk ka vendim përfundimtar për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, kërkuessit i lind e drejta t'i drejtohet Gjykatës në çdo kohë përgjatë periudhës që shkelja vazhdon. Në rastin konkret afati është tejkaluar dhe, në këtë kuptim, kërkuessit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

34. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, në kërkesën e tyre kërkuessit janë shprehur se: “Po ju le në vlerësimin tuaj që të vlerësoni apo jo procesin e ngritjes së Gjykatës Kushtetuese në përputhje me ligjin.”. Gjykata vlerëson se në vështirësi të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, në kushtet kur kërkuessit nuk kanë sjellë argumente ose dokumente për të mbështetur këtë parashtrim, ai nuk plotëson kushtet që të merret në shqyrtim prej saj. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për kohëzgjatjen e paarsyeshme të shqyrtimit të rekursit, Gjykata

vlerëson se ai përben objekt vlerësimi për kontrollin kushtetues.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

35. Kërkuessit pretendojnë cenimin e së drejtës për t'iu gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë, në kundërshtim me nenin 60, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 10.11.2017 dhe deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar 3 vjet e 4 muaj dhe asnjë hap procedural nuk është ndërmarrë nga Gjykata e Lartë, përveç caktimit të gjyqtarit relator. Sipas tyre, në kohëzgjatjen përtej afatit të arsyeshëm nuk ka ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së dhe nuk përbën shkak justifikues as reforma në drejtësi ose procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve, qëndrim i mbajtur edhe nga GJEDNJ-ja.

36. Sipas nenit 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

37. Sipas jurisprudencës kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e së cilës është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 18, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 22 datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuessit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe



sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

39. Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procesit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Lidhur me periudhën që duhet marrë në konsideratë, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuësve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë, e cila nuk ka marrë ende në shqyrtim rekursin dhe kundërrekursin e paraqitur nga palët ndërgjyqëse, çka, sipas tyre, ka sjellë pasoja edhe në kohëzgjatjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës së apelit.

41. Me ndryshimet e vitit 2017, KPC-ja, në nenin 399/2 ka përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme dhe lidhur me gjykimet administrative, kjo dispozitë nuk ka parashikuar afate për gjykimin në Gjykatën e Lartë, por vetëm për gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel. Nga ana tjetër, ligji nr. 49/2012, në nenin 60, pika 2, të tij, parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.

42. Gjykata vëren se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i datës 14.4.2016, kurse ai i gjykatës së apelit i datës 13.3.2017. Në bazë të rekursit dhe kundërrekursit të paraqitur nga palët ndërgjyqëse, kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 10.11.2017 dhe deri në momentin e vendimarrjes së Gjykatës për këtë çështje ajo nuk është shqyrtuar ende, edhe pse kanë kaluar mbi 3 vjet nga regjistrimi i saj.

43. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se *prima facie* në rastin konkret ka një tejzgjatje të procedurave gjyqësore. Në këtë kontekst, për të arritur në konkluzionin nëse jemi përpara cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të analizojë elementet e tjera, për vijon më poshtë.

ii. Sjellja/interesi për kërkuësit dhe rreziku nga tejzgjatja e procedurave

44. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes është një element

përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse kërkuësi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Sipas GJEDNJ-së, sjellja e kërkuësve përbën një faktor objektiv që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse është tejkaluar koha e arsyeshme, sipas kërkesave të nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së (*shih Humen kundër Polonisë [GC], 15 tetor 1999, § 66*). Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përsheptim të posaçëm gjykimi në procedurat vendase. Në këto raste, duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuësit në procesin gjyqësor. Prandaj është thelbësore të trajtohen me shpejtësi të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë (*shih Tsikakis kundër Gjermanisë, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68; Nuutinen kundër Finlandës, 27 qershor 2000, § 110*), punësimin (*shih Thlimmenos kundër Greqisë [GC], 6 prill 2000, §§ 60 dhe 62*), “sëmundjet e pashërueshme dhe jetëgjatësinë e shkurtër” (*A. dhe të tjerët kundër Danimarkës, 8 shkurt 1996, §§ 78–81; X kundër Francës, 31 mars 1992, § 47*).

46. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuësit kanë vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuësit dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për ta, Gjykata vëren se në kuptim të dispozitave procedurale të KPC-së, e drejta për shpërblim për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes lind për secilën palë në proces që provon ardhjen e dëmit pasuror ose jopasuror, pra provon se është viktimë e shkeljes së të drejtave kushtetuese. Siç rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës, me vendimin nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur: “*Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Shfuqizimin e shkresës nr. 925/6 prot., datë 25.8.2015, të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimore Informale, Drejtoria Tirana 4. Detyrimin e palës së paditur ALUIZNI-t që të përmbyllë procedurat për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin mbi parcelën ndërtimore në lidhje me shtetasit Ledi Bianku*



dhe Odeta Kumbaro, sipas kontratës nr. 2017 rep., nr. 690 kol., datë 6.3.2012. *Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të padisë*”. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 998 (86-2016-965), datë 13.3.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruara nga Gjykata për qëllime të këtij procesi, kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë pala e paditur në procesin gjyqësor, ALUIZNI dhe kundërrekurs vetëm kërkuesi Ledi Bianku.

47. Fillimisht, Gjykata thekson se pretendimi për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë është paraqitur si pretendim më vete nga kërkuesi dhe ai është trajtuar më sipër (*shih paragrafin 31 të vendimit*). Gjykata vëren se, në përputhje me parashikimet e neneve 449 dhe 451 të KPC-së, vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe paraqitja e rekursit në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, në bazë të nenit 479 të KPC-së. Më tej KPC-ja ka parashikuar rregullat dhe procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Sipas nenit 510 të KPC-së janë tituj ekzekutivë vendimet civile të formës së prerë të gjykatës që përmbajnë një detyrim, të cilët vihen në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit (neni 511 i KPC-së). Kodi ka parashikuar edhe procedurat e ekzekutimit dhe mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve.

48. Gjykata vëren se në parashtrimet e tyre kërkuesi janë shprehur se në gusht të vitit 2021 i janë drejtuar një përmbaruesi gjyqësor privat, me qëllim që paralelisht të ndjekin ekzekutimin e vendimit gjyqësor që ishte bërë i ekzekutueshëm. Përmbaruesi, me shkresën e datës 25.8.2021, i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të vendimit të formës së prerë dhe, sipas kërkuessve, ASHK-ja është përgjigjur me letrën e datës 7.9.2021 se vendimi është ekzekutuar me urdhrin nr. 11, datë 6.7.2019 dhe se në datën 8.7.2019 praktika i është përcjellë Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kavajë. Ky institucion ka njoftuar përmbaruesin se në datën 3.9.2021 ka kryer edhe një mandatpagesë për shpenzimet gjyqësore në favor të palës kreditore pranë bankës “Credins Bank”.

49. Gjykata, bazuar në aktet e paraqitura nga kërkuesi bashkëlidhur parashtrimeve të tyre, konstaton se ASHK-ja ka miratuar lejen e

legalizimit nr. 704776, datë 7.6.2019 për objektin “banim” në favor të kërkuessve Ledi Bianku dhe Odeta Kumbaro, sipas të dhënave të kësaj pasurie, bazuar në genplanin dhe planimetrinë bashkëlidhur këtij akti. Me shkresën nr. 2004 prot., datë 22.5.2020, ASHK-ja u ka dërguar kërkuessve këto akte, të cilat u janë ridërguar nga ky institucion me shkresën nr. 2004/1 prot., datë 7.9.2021, sipas së cilës rezulton se dokumentacioni është përcjellë për regjistrim edhe në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kavajë.

50. Për sa më sipër, gjatë gjykimit rezultoi se ASHK-ja ka nxjerrë lejen e legalizimit në vitin 2019, e cila, sipas akteve dhe parashtrimeve të paraqitura nga vetë kërkuesi (në mungesë të parashtrimeve nga ASHK-ja), u është njoftuar atyre me postë në vitin 2021. Kërkuesi janë pajisur me një vendim të formës së prerë në favorin e tyre, për të cilin jo vetëm që nuk ka pasur një vendim pezullimi për ekzekutimin e tij, por në momentin e paraqitjes së kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në Gjykatën e Lartë (28.1.2021), institucioni debitor kishte vepruar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ky vendim, pa pasur nevojën për vënien në lëvizje të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm nga kërkuesi si palë kreditore.

51. Po ashtu, Gjykata thekson se të njëjtat parashtrime dhe aktet e sipërcituara të paraqitura në këtë gjykim, kërkuesi nuk kishin pengesë që t'i paraqisnin edhe në Gjykatën e Lartë, në mënyrë që t'i jepnin mundësinë kësaj të fundit të vlerësonte këto rrethana, me qëllim përshpejtimin e gjykimit të kësaj çështjeje. Pavarësisht sa më sipër, në kushtet aktuale Gjykata e Lartë nuk ka arsye pse të mos e marrë në shqyrtim me përparësi çështjen e kërkuessve.

52. Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuessve nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për shkak se ajo nuk ka sjellë pasoja thelbësore në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

53. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi me sjelljen e tyre nuk janë bërë shkak për vonesa, megjithatë, nga pikëpamja e interesit, në kushtet kur ata janë pajisur me një vendim të formës së prerë, ekzekutimi i të cilit nuk është pezulluar nga gjykata, por është lëshuar leja e



legalizimit dhe ka vijuar procedura për regjistrimin e pronës, arrihet në përfundimin se ata nuk ndodhen përballë ndonjë shkalle të konsiderueshme rreziku.

iii. Kompleksiteti i çështjes

54. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkruesore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Sipas GJEDNJ-së, kompleksiteti i çështjes mund të lidhet si me faktet, ashtu edhe me ligjin (*shih Papachelas kundër Greqisë [GC], 25 mars 1999, § 39; Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë, 27 tetor 1994, § 55*), me përfshirjen e disa palëve në proces (*shih H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 korrik 1987, § 72*) ose me prova të ndryshme që duhet të merren (*shih Humen kundër Polonisë [GC], 15 tetor 1999, § 63*).

56. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012 dhe ka për objekt detyrimin e organit të administratës publike, ASHK-ja, ish-ALUIZNI, të ndryshojë pjesërisht aktin administrativ të nxjerrë prej tij, si dhe të përfundojë procedurat e legalizimit për pasurinë objekt gjykimi deri në dërgimin e dosjes për regjistrim përfundimtar në ZVRPP.

57. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në gjykim, Gjykata vlerëson se kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesë në shqyrtimin e saj, për më tepër në kushtet kur, siç pranohet edhe nga vetë kërkuessit, është lëshuar leja e legalizimit nr. 704776, datë 7.6.2019 në favor të tyre.

iv. Sjellja e autoriteteve

58. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë

çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 3, datë 6.12.2018; nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Gjykata vëren se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar, ndër parimet e gjykimit administrativ, edhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative, çka rezultoi edhe nga relacioni bashkëlidhur këtij ligji, sipas të cilit ai synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata vëren, gjithashtu, se ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate konkrete për gjykimin në të tria shkallët e gjykimit. Gjykata ka vlerësuar se, përderisa ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara do të thotë se ai i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykatat administrative të të gjitha shkallëve të gjykimit. Pengesat e mundshme objektive duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet rregullimit që duhet të bëjë ligjvënësi (*shih vendimet nr. 3, datë 6.2.2018; nr. 22, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata vlerëson të tregojë një qasje më të kujdesshme, duke pasur parasysh ndryshimet që sollë reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave të tilla në një mënyrë që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në



pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës, për të zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshtetimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e këtij lloji rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka marrë hapa konkretë, duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, si: rritja e kapaciteteve njerëzore, inventarizimi i çështjeve, përpunimi deri në shqyrtimin e tyre, përgatitja e planeve të veprimit, me qëllim shqyrtimin e çështjeve sipas kronologjisë kohore dhe specifikës së çështjes. Gjithsesi, edhe në këtë rast Gjykata rithekson se masat e marra nga autoritetet shqiptare nuk janë të mjaftueshme, përderisa procedurat në Gjykatën e Lartë po zgjasin tej afateve të arsyeshme (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Pavarësisht kësaj, kjo rrethanë nuk ndikon në çështjen konkrete në shqyrtim, për sa kohë që Gjykata vlerësoi mungesën e interesit të kërkuarve dhe të rrezikut që passjell për ta kohëzgjatja e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë.

62. Në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve, Gjykata vlerëson të rëndësishme të ndalet në sjelljen e institucionit tjetër të përfshirë në këtë proces, ASHK-ja, që është edhe pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me anë të rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit.

63. Siç u theksua më sipër, gjatë gjykimit u konstatua se ASHK-ja ka lëshuar lejen e legalizimit, çka ka qenë edhe objekti i mosmarrëveshjes në gjykim. Me shkresën nr. 2004 prot., datë 22.5.2020 ASHK-ja u ka dërguar kërkuarve lejen e legalizimit, shoqëruar me genplanin dhe planimetrinë, dhe këto akte u janë ridërguar atyre me shkresën nr. 2004/1 prot., datë 7.9.2021, për shkak të kthimit nga posta në datën 1.6.2020 të shkresës së datës 22.5.2020.

Megjithatë, Gjykata vlerëson të theksojë se njoftimi i lejes së legalizimit dhe i akteve shoqëruese pas më shumë se 1 viti nga kthimi i tyre nga posta konsiderohet e parregullt dhe organi shtetëror nuk ka vepruar në përputhje me detyrimet e tij, duke mos respektuar të drejtat e palës në procedurën administrative, në rastin konkret të drejtën për t'u njoftuar.

64. Në përfundim, në rastin konkret, edhe pse duket se deri diku ka një tejzgjatje të procesit dhe se sjellja e kërkuarve nuk ka penguar ecurinë e tij, si dhe për faktin se masat e marra nga autoritetet janë të pamjaftueshme, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, sidomos rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuarve, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë, në pritje për t'u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, vlerëson se nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 71/a, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 5.11.2021.

Shpallur më 1.12.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Altin Binaj

**MENDIM PARALEL**

1. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me shumicën për rrëzimin e kërkesës, kam mendim të ndryshëm për sa u takon shkaqeve për këtë qëndrim, pasi vlerësoj se kërkesa duhej rrëzuar për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike efektive për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

2. Neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës parashikon se “Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë”.

3. Në drejtim të renditjes së standardeve jurisprudenciale, të vendosura nga kjo Gjykatë, lidhur me kriterin e shterimit të mjetit juridik efektiv (*shih paragrafët 15–17, si dhe 19–20 të vendimit*), jam dakord me shumicën, por kam qëndrim të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ajo i ka zbatuar këto standarde, në rastin konkret për të gjitha kërkimet e kërkuësve sipas objektit të kërkesës.

4. Fillimisht theksoj se për konstatimin e shkeljes së procesit të rregullt për sa i përket kohëzgjatjes në ekzekutimin e vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shumica e ka analizuar duke arritur në përfundimin se kërkuësit nuk i kanë shteruar mjetet e ankimit (*shih paragrafin 31 të vendimit*), qëndrim të cilit i bashkohem edhe unë.

5. Ndërkohë, shumica i ka legjitimuar kërkuësit lidhur me shterimin e mjetit juridik për tejzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, sipas saj, “...Për shkak të këtyre rrethanave, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kërkuësit janë shkarkuar nga detyrimi për të shteruar këtë mjet juridik përpara paraqitjes së ankimit kushtetues (*shih paragrafin 30 të vendimit*). Po ashtu, shumica ka analizuar pretendimin e cenimit të aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj dhe konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për përshpejtimin e rekursit në kuadër të shterimit të mjetit juridik efektiv për konstatimin e tejzgjatjes së procesit në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafët 18 dhe*

30 të vendimit). Pra, ajo e ka parë pretendimin e cenimit të aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj së bashku, me pretendimin për mungesën e mjetit efektiv, për të cilin unë mendoj se duhej trajtuar më vete.

6. Në vlerësimin tim, në rastin konkret kërkuësit nuk kanë qenë në rrethana të tilla që të shkarkoheshin nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për të gjitha pretendimet me argumentet për sa vijon.

A. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj

7. Bazuar në nenin 399/5 të KPC-së, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes administrative ku janë palë. Me shkresën nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021, të kancelarit të Gjykatës së Lartë, kërkuësve u është kthyer përgjigje se në bazë të nenit 474 të KPC-së, kërkesa duhet të jetë e nënshkruar nga avokati që përfaqëson palën, ndaj ajo u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim. Edhe pse në rastin konkret kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, e nënshkruar nga vetë kërkuësit, është kthyer pa veprime nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë për t'u plotësuar me nënshkrimin e avokatit, nuk rezulton që kërkuësit të kenë paraqitur një kërkesë të re të plotësuar.

8. Sipas kërkuësve, është cenuar e drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për përshpejtimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë. Në çështjen konkrete nuk ka pasur shqyrtim dhe vendim nga një gjyqtar, në kuptim të nenit 57 të ligjit nr. 49/2012. Bazuar edhe në nenin 154/a, pika 3, të KPC-së kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, procedurë që gjen zbatim edhe në Gjykatën e Lartë. Formulimi në nenin 399/5 të KPC-së, duke përdorur termin “nëse”, tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga vetë kërkuësi, por nëse bëhet nga avokati kërkohej prokurë. Interpretimi në themel i kancelarit të Gjykatës së Lartë është *contra legem* i nenit 399/5 të KPC-së, që, për më tepër, është edhe *lex specialis* për procedurat në fjalë. Edhe nëse ky do të ishte rasti sipas legjislacionit të brendshëm, siç pretendon gabimisht kancelari i Gjykatës së Lartë, një parashikim i tillë për detyrimin e firmës nga një



avokat në rast kur vetë kërkuksi është jurist/avokat, është joproporcional për qëllimet e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për sa i përket aksesit në gjykatë. Edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen *Dylus kundër Polonisë*, vendim i datës 23.9.2021 (*footnote 3 e parashtrimeve të kërkuksve*), është konstatuar shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së, në këndvështrim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

9. Shumica, duke e pranuar si formalizëm të tepruar interpretimin e nenit 399/5, pika 2, shkronja “ç”, të KPC-së nga ana e kancelarit me shkresën e sipërcituar, mbështetur dhe në qëndrimin e GJEDNJ-së në vendimin *Dylus*, ka renditur tri arsye për argumentimin: (i) në rastin konkret nuk jemi para rastit të paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por të një kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përshpejtimin e procedurave; (ii) profili i njërit prej kërkuksve, Ledi Bianku (L.B.), si ish-gjyqtar në GJEDNJ; (iii) cilësitë e kërkuksit L.B. si avokat (*shih paragrafët 29 dhe 30 të vendimit*).

10. Në vlerësimin tim, pretendimi për shkeljen e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj është i pavarur dhe autonom, ashtu sikundër e kanë parashtruar edhe kërkuksit. Thelbi i shkeljes së këtij parimi, të procesit të rregullt ligjor, sipas kërkuksve, qëndron tek shkresa e kancelarit të Gjykatës së Lartë, ndaj edhe shumica duhej të kishte analizuar nëse ishte plotësuar kriteri i shterimit të mjetit efektiv ligjor në këtë kontekst. Ky pretendim qartësisht nuk është i lidhur me konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për përshpejtimin e procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, sikundër shumica e ka trajtuar (*shih paragrafin 18 të vendimit*).

11. Në lidhje me të drejtën e aksesit, në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshem nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

12. Gjykata ka theksuar se kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka

vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Ajo ka nënvizuar se termi “gjykatë” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar për një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 1, datë 19.1.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga ana tjetër, në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshem nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke iu kthyer rastit konkret, vërehet se në datën 1.2.2021 kërkuksve u është kthyer përgjigje nga kancelari i Gjykatës së Lartë se në bazë të nenit 474 të KPC-së, kërkesa duhet të jetë e nënshkruar nga avokati që përfaqëson palën, ndaj kërkesa u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim. Kërkuksit nuk e kanë riparaqitur kërkesën pranë Gjykatës së Lartë të



plotësuar, por i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 21.4.2021.

16. Neni 399/5 i KPC-së parashikon se kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshejtimin e procedurave depozitohet në sekretarinë e gjykatës që është në vonesë, si dhe elementet dhe dokumentet që duhet të përmbajë dhe shoqërojnë atë. Sipas pikës 2, shkronja “ç”, të këtij neni parashikohet se *“bashkë me kërkesën duhet të depozitohen edhe: ... ç) prokura, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit”*.

17. Për sa më lart, ndodhur përpara këtyre rrethanave, ku kancelari ka bërë interpretim të normës ligjore të sipërcituar, bazuar në parimin e subsidiaritetit, do të duhej që fillimisht kërkuesit të shteronin ankimin administrativ ndaj shkresës së kancelarit, sipas nenit 37, shkronja “P”, të ligjit nr. 98/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e organeve të sistemit të drejtësisë”*, ku parashikohet se *“kryetari i Gjykatës verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit”*. Po ashtu, ankimi gjyqësor në gjykatën administrative, për pretendimet e tyre për paligjshmërinë, por edhe antikushtetutshmërinë e shkresës administrative të kancelarit, do të ishte shkalla tjetër për shterimin e mjetit efektiv të ankimit, nëse kryetari i Gjykatës së Lartë nuk do t’u jepte zgjidhje pretendimeve të tyre, përmes kontrollit administrativ. Sikundër kjo Gjykatë ka theksuar, sipas parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, së pari, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 83, datë 26.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për më tepër, edhe vetë kërkuesit pretendojnë se formulimi në nenin 399/5, pika 2, shkronja “ç”, të KPC-së, duke përdorur termin *“nëse”*, tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga ata, por nëse bëhet nga avokati, kërkohet prokurë. Prandaj, edhe sipas tyre, jemi para pretendimeve lidhur me paligjshmërinë e veprimtarisë administrative të një organi administrativ.

19. Për rrjedhojë, pretendimet për veprimet administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë, të ngritura në këndvështrim të së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, janë të tilla, për nga natyra, që kërkuesit do të duhej të kishin shteruar mjetet efektive në dispozicion, para se të paraqisnin ankim kushtetues individual.

20. Në rastin konkret, nëse do të pranohet të kundërtën, pra mosshkrimin e mjeteve të sistemit gjyqësor të zakonshëm, do të zgjerohej akses i kushtetues i individëve, për çdo paligjshmëri veprimesh të autoriteteve administrative, çka nuk është qëllimi i kushtetutëbërësit, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Ashtu sikundër kjo Gjykatë ka theksuar, duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për më tepër, nga ana e shumicës ka disa pasaktësi në analizën e dokumenteve, si dhe të argumenteve të paraqitura, që çmoj t’i evidentoj:

21.1 *Së pari*, rezulton e paprovuar përmes një dokumenti zyrtar qenia e ndonjërit prej kërkuesve në cilësinë e avokatit që e ushtron këtë profesion. Edhe pse kërkuesi L.B. pretendon se është avokat, ai nuk i ka paraqitur Gjykatës asnjë dokument provues në këtë drejtim. Po ashtu, është e vërtetë se ekziston mundësia që kërkuesi ta ketë fituar këtë cilësi, por përderisa ai nuk i ka paraqitur Gjykatës një dokument provues, shumica nuk ka përse ta prezumojë kërkuesin si të tillë. Nga ana tjetër, edhe pasja e titullit *“avokat”* në vetvete nuk tregon se në momentin e paraqitjes së kërkesës për përshejtim të procesit kërkuesi ka qenë avokat aktiv, pasi legjislacioni ka një sërë kriteresh për t’u plotësuar që të mund të ushtrohet profesioni i avokatit.

21.2 *Së dyti*, duket sikur një nga argumentet e shumicës bazohet edhe në profilin e kërkuesit L.B. si ish-gjyqtar në GJEDNJ (*shih paragrafin 29 të vendimit*), ndërkohë që vetë kërkuesi nuk e ka paraqitur një argument të tillë. Në fakt, diskutimi në rastin konkret qëndron në interpretimin e nenit 399/5, shkronja “ç”, të KPC-së nga kancelari i Gjykatës së Lartë. Unë bie dakord me shumicën për shqetësimin lidhur me ngushtimin e aksesit të individëve me interpretimin që i është dhënë nga kancelari nenit 399/5 të KPC-së, praktikë e



ndeshur dhe te kërkues të tjerë para kësaj gjykate (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në respektim të standardeve, vlerësoj se kërkuesit ose duhet të kundërshtojnë shkresën e kancelarit në rrugë administrative dhe gjyqësore, ose duhet të ndiqnin orientimin për paraqitjen e kërkesës për përshpejtim të procesit përmes përfaqësuesit ligjor.

21.3 *Së treti*, shumica thekson standardet e Gjykatës, sipas të cilave veprimet ose mosveprimet e administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës), bazuar në vendimet nr. 68, datë 17.11.2015 dhe nr. 48, datë 29.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese (*shih paragrafin 27 të vendimit*). Të dyja vendimet e cituara nga shumica, si standard i kësaj Gjykate, janë përkatësisht në kontekstin e veprimeve të parregullta të administratës gjyqësore për sa u përket njoftimeve me shpallje për procesin gjyqësor nga Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe mospranimi të rekursit nga Gjykata e Lartë, edhe pse ishte paraqitur brenda afatit ligjor. Duke çmuar se standardet e kësaj Gjykate duhen vënë në kontekstin e duhur të çështjes, përmes një analize konkrete vlerësoj se rrethanat e kësaj çështje nuk janë gabime procedurale të administratës, por një nga mënyrat e të kuptuarit dhe të interpretuarit të nenit 399/5, pika 2, shkronja “ç”, të KPC-së nga kancelari, si interpretuesi i parë i normës në rastin konkret.

21.4 *Së katërti*, sipas shumicës ka pasur formalizëm të tepruar nga kancelari, në dëm të aksesit në gjykatë, mbështetur edhe në vendimin e GJEDNJ-së *Dylus kundër Polonisë* (*shih paragrafin 28 të vendimit*). Ndërkohë, konteksti i rrethanave në çështjen *Dylus* ka qenë ndryshe nga ai i kërkuesve që kanë iniciuar këtë proces kushtetues. Më konkretisht, Gjykata Supreme e Polonisë ka refuzuar ta njohë rekursin, pasi ky i fundit edhe pse është firmuar nga një avokat, sipas tyre, nuk ishte përpiluar/hartuar nga përfaqësuesi ligjor, por nga vetë rekursuesi, që në fakt ishte me profesion avokat. Sipas saj, “edhe pse në rastin konkret kërkuesi kishte respektuar formalisht nenin 526, paragrafi 2, të KPP-së, rekursi që avokati i tij kishte paraqitur në emër të tij nuk ishte hartuar nga ky avokat, por thjesht riprodhonte përmbajtjen e rekursit që i interesuari kishte hartuar vetë, dhe që i ishte refuzuar herën e parë, kur rekursuesi e kishte

paraqitur vetë (*shih paragrafin 9 të vendimit Dylus*). Ndërsa GJEDNJ-ja ka vendosur se ka pasur shkelje ndaj ankuesit, jo sepse i ishte kërkuar firmosja nga një avokat, por sepse i ishte kërkuar edhe hartimi i rekursit nga avokati, përveç firmosjes, ndërkohë që rekursi si në formë dhe përmbajtje i plotësonte kriteret e cilësisë, dhe nuk kishte të dhëna subjektive në të. Specifikisht, Gjykata Supreme ka krahasuar rekursin e parë të nënshkruar nga vetë kërkuesi (avokat) me rekursin e dytë të nënshkruar nga një mbrojtës ligjor dhe ka dalë në konkluzionin se nuk është hartuar nga mbrojtësi, pasi në përmbajtje ishin të njëjtë. Kjo është arsyeja e refuzimit, pra hartimi i rekursit jo nga mbrojtësi ligjor, dhe jo nënshkrimi prej tij. GJEDNJ-ja këtë qëndrim të Gjykatës Supreme e ka konsideruar formalizëm të tepruar dhe jo proporcional me kriteret e aksesit në gjykatë (*përmbledhje e paragrafëve 40-46 të vendimit Dylus*). Në çështjen në shqyrtim nuk jemi në të njëjtin kontekst rrethanash, pasi kërkuesit nuk e kanë paraqitur përsëri kërkesën të firmosur përmes një avokati dhe hipotetikisht t'u ishte refuzuar nga kancelari, pasi nuk ishte hartuar nga avokati mbrojtës, gjë e cila do t'i jepte vlerë dhe kuptim argumentit të shumicës për formalizëm të tepruar.

22. Në shtesë të kësaj analize, vlerësoj të risjell në vëmendje edhe qëndrimin e GJEDNJ-së, lidhur me rëndësinë e shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit. Sipas kësaj gjykate: “Në këto rrethana, Gjykata merr në konsideratë faktin se kishte, ende, të paktën një mjet efektiv në nivel kombëtar, të cilin mund ta kishin përdorur kërkuesit, më konkretisht, një padi në gjykatën e rrethit me mundësinë e ankimit në Gjykatën e Lartë. Veçanërisht në vështrim të faktit se Konventa është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Shqipëri, sipas nenit 122 § 1 të Kushtetutës, një ankim në gjykatat kombëtare, do t'u kishte dhënë atyre mundësinë të vlerësonin proporcionalitetin e zbatimit të aktit normativ të vitit 2012 në secilën prej çështjeve të kërkuesve...” (Bakui dhe të tjerë kundër Shqipërisë (vendim (dec.) i datës 10.4.2018, paragrafi 80). Më tej, GJEDNJ-ja shprehet: “Për sa më sipër dhe duke pasur parasysh rrethanat e këtyre çështjeve, ajo nuk konstaton se ka pasur arsye të veçanta për të përjashtuar kërkuesit nga kërkesa për shterimin e mjeteve të brendshme në përputhje me ligjin kombëtar. Përkundrazi, nëse kërkuesit do e kishin respektuar këtë kërkesë, kjo do u kishte dhënë gjykatave kombëtare mundësinë që të vendosnin për çështjen e përputhshmërisë së masave kombëtare të kundërshtuara, ose të mosveprimi, me Konventën dhe, nëse



kërkuesit do ta kishin paraqitur gjithësi çështjen në Gjykatën Evropiane, kjo Gjykatë do të kishte pasur përfitimin e qëndrimeve të gjykatave kombëtare. Në këtë mënyrë, kërkuesit dështuan të ndiqnin hapat e duhur për t'i dhënë mundësinë gjykatave kombëtare që të përmbushnin rolin e tyre thelbësor në sistemin e mbrojtjes së Konventës, atë që Gjykata Evropiane është subsidiare e tyre.” (po aty, paragrafi 81). Po ashtu, GJEDNJ-ja ka theksuar se: “Qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është t'i japë një shteti kontraktues mundësinë e adresimit dhe, në këtë mënyrë, të parandalimit ose rregullimit të shkeljes në fjalë të Konventës që pretendohet kundër tij. Është e vërtetë që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës nuk është gjithmonë e nevojshme që Konventa të përmendet qartazi në proceset e brendshme, me kusht që pretendimi të ngrihet “të paktën në substance”. Kjo do të thotë që kërkuesi duhet të ngrijë argumente ligjore me të njëjtin efekt ose të ngjashëm në bazë të ligjit të brendshëm, në mënyrë që t'u japë gjykatave vendase mundësinë për të ndrequr shkeljen e pretenduar. Sidoqoftë, siç shpjegohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, për t'i dhënë vërtet një shteti nënshkrues të Konventës mundësinë e parandalimit ose korrigjimit të shkeljes së pretenduar, kërkohet që të merren parasysh jo vetëm faktet, por edhe argumentet ligjore të kërkuesit për të përcaktuar nëse ankimi i paraqitur në Gjykatë me të vërtetë ishte ngritur paraprakisht, në substancë, përpara organeve vendase (Xhoxhaj kundër Shqipërisë, vendim 9 shkurt 2021, § 249). Për rrjedhojë, mbështetur edhe në këtë jurisprudencë, vlerësoj se fillimisht janë gjykatat e zakonshme ato që duhet të vlerësojnë dhe shprehen për pretendimet e kërkuesve për qasjen formaliste të kancelarit të Gjykatës së Lartë dhe zbatimit prej tij të dispozitave përkatëse të KPC-së, me qëllim që pastaj Gjykata Kushtetuese të jetë në pozita që ta ushtrojë kontrollin e saj në mënyrë më efektive.

23. Po ashtu, theksoj se në një kërkesë të ngjashme me këtë në shqyrtim, është mbajtur në Kolegj (pjesë e të cilit kam qenë dhe unë), qëndrimi se pretendimet e kërkuesit për veprimet e kancelarit të Gjykatës së Lartë kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e të cilave i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe jo atij kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji ka vlerësuar se për ankimin që ka bërë kërkuesi para kësaj Gjykate kundër shkresës administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë, me argumentin e mungesës së kompetencës së tij, legjislacioni në fuqi parashikon mjete në dispozicion që kërkuesi mund t'i shfrytëzojë për të

kundërshtuar veprimet e kancelarit të Gjykatës së Lartë, në mbrojtje të së drejtës dhe interesave të tij (shih vendimin nr. 69, datë 19.4.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 17).

B. Për pretendimin për konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin e tejzgjatjes, dëmshtëpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë

24. Nga sa më lart, rezulton se kërkuesit nuk e kanë kundërshtuar shkresën e kancelarit dhe nuk kanë paraqitur kërkesë të re për përshpejtimin e procesit, të firmosur me përfaqësues ligjor, për rrjedhojë ata nuk kanë të regjistruar asnjë kërkesë për përshpejtim pranë Gjykatës së Lartë.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se “Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, por ajo mund ta ushtrojë këtë kompetencë, duke analizuar faktet e natyrës kushtetuese” (shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese). Në vlerësimin tim, mospasja e një kërkesë të regjistruar për përshpejtim të procesit pranë Gjykatës së Lartë përbën fakt të natyrës kushtetuese që nuk mund të kapërcehet, ndaj mungesa e saj duhet të sillte moslegjitimit të kërkuesve për mosshërim të mjetit juridik, në të kundërt të sa ka argumentuar shumica për këtë element (shih paragrafin 30 të vendimit).

26. Duke konsideruar se kërkuesit nuk kanë pasur kërkesë të regjistruar për përshpejtim të procesit pranë Gjykatës së Lartë, nuk mund të merret në konsideratë pretendimi për konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme, përshpejtimin e procedurave dhe dëmshtëpërblimin. Ky rast është i ndryshëm, nga çështja me kërkues, shoqërinë “Zyra e Përmbartimit Privat ARB”, ku kërkuesi kishte të regjistruar kërkesën për përshpejtim dhe sipas Gjykatës së Lartë ajo ndodhej në fazë studimi. (shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).

27. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: “Megjithatë, Gjykata nuk është e bindur se një kërkesë për përshpejtimin e procedurës do të kishte qenë efektive në rrethanat e çështjes. Edhe nëse supozojmë se kërkuesi i dytë do të kishte bërë një kërkesë për përshpejtimin e procedurës, funksionimi i Gjykatës së Lartë ishte dëmtuar aq seriozisht nga dorëheqja dhe shkarkimi i gjyqtarëve të saj nga detyra (shih paragrafin 25 më lart), sa që



më 31 korrik 2018, kjo Gjykatë, e përbërë nga një trupë gjyqësore e ndryshme nga ajo së cilës i ishte caktuar shqyrtimi i rekursit, nuk do të kishte qenë në gjendje ta shqyrtonte atë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve (shih paragrafët 25 dhe 33 më lart). (...) Në këto rrethana të jashtëzakonshme të kërkesës në fjalë, rezulton se pretendimi i Qeverisë bazuar në mosparaqitjen e një kërkesë për përshpejtimin e procedurës para Gjykatës së Lartë nga ana e kërkuarit të dytë, duhet të rrëzohet” (*Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, vendim i datës 12 tetor 2021, § 79*).

28. Në një interpretim *a contrario*, të sa më lart, vlerësoj se kërkuarit nga muaji shkurt i vitit 2021 kur kancelari i ktheu kërkesën pa veprime, si dhe që nga muaji mars i vitit 2021, kur në Gjykatën e Lartë u krijuan disa kolegje, mund të kishin paraqitur kërkesë për përshpejtim pranë kësaj gjykate, e cila *potencialisht* mund ta shqyrtonte, dhe në një moment të caktuar vonese kërkuarit do të mund të kishin ngritur pretendime për mungesën e mjetit efektiv për përshpejtim pranë Gjykatës Kushtetuese, pra pasi të kishin regjistruar kërkesën për përshpejtim pranë Gjykatës së Lartë dhe mosmarrja në shqyrtim e saj të vazhdonte për një periudhë kohe dukshëm me një vonesë të tillë, që mjeti do të mund të humbte qëllimin përshpejtues (*shih vendimin nr.33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas standardeve të kësaj gjykate, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së në parim janë efektive, ndërsa për sa i takon efektivitetin të tyre në praktikë, ato duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 36*).

29. Në këtë kontekst, *së pari*, kërkuarit duke mos pasur një “kërkesë të regjistruar për përshpejtim”, nuk e kanë ushtruar *de facto* mjetin juridik në dispozicion; së *dyti*, ata duhet ta kishin testuar efektivitetin e mjetit para Gjykatës së Lartë, dhe *së treti*, t’i jepnin mundësinë edhe kësaj Gjykate ta shqyrtonte efektivitetin e tij. GJEDNJ është shprehur se për të qenë efektiv, mjeti juridik duhet të jetë në gjendje të korrigjojë menjëherë gjendjen e cenuar dhe të ofrojë premisa të arsyeshme suksesi. Megjithatë, thjesht prania e dyshimeve në lidhje me mundësitë për suksesin e një mjeti specifik, i cili është dukshëm i pavlerë, nuk është një arsye e vlefshme për mosshkrimin e asaj forme korrigjimi (*shih Vučković dhe të tjerët k. Serbisë [DHM], § 69–77*,

25 mars 2014 dhe *Bakiu k. Shqipërisë, § 80, 10 maj 2018*). Nga ana tjetër, pikërisht moshterimi i mjetit të përshpejtimit për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë sipas nenit 399/5 të KPC-së, passjell dhe mosmarrjen në konsideratë të pretendimit për tejzgjatje të gjykimit të çështjes pranë kësaj gjykate, ku kërkuarit janë palë.

30. Analiza e mësipërme, sikundër parashtrua edhe më lart, u përket kriterëve paraprake, ndryshe nga shumica, e cila pasi ka konsideruar kriterin e shterimit të mjetit juridik si të plotësuar, dhe i ka shkarkuar kërkuarit nga ky detyrim, ka vlerësuar pretendimin për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, duke analizuar me radhë kriteret jurisprudenciale të tejzgjatjes dhe zbatimin e tyre në rastin konkret (*shih paragrafët 35–63 të vendimit*).

31. Si përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj gjykate, rrethanave konkrete të çështjes, dhe fakteve të paraqitura në seancë gjyqësore nga kërkuarit, ata nuk legjitimohen, ndaj dhe kjo duhet të kishte qenë dhe arsyeja e rrëzimit të kërkesës.

Anëtare: Elsa Toska

VENDIM

Nr. 60, datë 24.11.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 46, dhe të nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 99, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”,



miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 01, datë 17.1.2013, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kudo në nenin 1, togfjalëshi “, *institucioneve financiare të mikrokredisë dhe të institucioneve të parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*dhe të institucioneve financiare të mikrokredisë*”;

b) Në nenin 2, pika 1, shkronja “b”, hiqet togfjalëshi “*nenit 4, paragrafi 46, dhe të*”;

c) Në nenin 3, togfjalëshi “, *institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*dhe institucionet financiare të mikrokredisë*”;

d) Në nenin 4, pika 2, shkronja “c”, shfuqizohet;

e) Në nenin 5, shfuqizohen: nënpika “iv” e shkronjës “a” të pikës 1; shkronja “c” e pikës 1; si dhe pikat 4, 5 dhe 6;

f) Neni 5/1, shfuqizohet;

g) Në nenin 6, shfuqizohet shkronja “d” e pikës 1 dhe pika 4;

h) Në nenin 7, shfuqizohet pika 4;

i) Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. emërtimi i nenit ndryshon në “*Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për subjektin financiar jobankë dhe institucionin financiar të mikrokredisë*”;

ii. në pikën 1, togfjalëshi “*si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*si subjekt financiar jobankë ose si institucion financiar i mikrokredisë*”;

iii. kudo në këtë nen, togfjalëshi “, *institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*ose institucioni financiar i mikrokredisë*” dhe togfjalëshi “, *institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*ose institucionit financiar të mikrokredisë*”;

iv. shfuqizohet nënpika “iii” e shkronjës “k” të pikës 2;

v. në nënpikën “iv” të shkronjës “k” të pikës 2, togfjalëshi “*duke përfshirë dhe agjentët/degët*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*duke përfshirë dhe degët*”;

vi. në nënpikën e dytë të shkronjës “p” të pikës 2, togfjalëshi “*nga subjekti dhe nga agjentët*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*nga subjekti*”;

vii. shfuqizohet nënpika e gjashtë e shkronjës “p” të pikës 2 me përmbajtjen: “*të siguruar*

vazhdimësinë dhe sigurinë në emetimin e parasë elektronike (për institucionet e parasë elektronike);”;

j) Kudo në nenet 9, 9/1 dhe 9/2, togfjalëshi “, *institucioni financiar i mikrokredisë dhe institucioni i parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*dhe institucioni financiar i mikrokredisë*” dhe togfjalëshi “, *institucionit financiar të mikrokredisë dhe institucionit të parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*dhe institucionit financiar të mikrokredisë*”;

k) Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, togfjalëshi “*si institucion financiar mikrokrede ose si institucion i parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*ose si institucion financiar mikrokrede*”, dhe togfjalëshi “2 (dy) muajve”, zëvendësohet me togfjalëshin “3 (tre) muajve”;

ii. në pikën 5, shkronja “c”, togfjalëshi “*institucionit financiar të mikrokredisë ose të institucionit të parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*ose të institucionit financiar të mikrokredisë*”;

iii. pas pikës 6, shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:

“7. Banka e Shqipërisë, nëse e gjykon të arsyeshme, mund të kërkojë paraqitjen e vërtetimeve të përditësuara mbi gjendjen gjyqësore, ndjekjen penale dhe gjendjen e detyrimeve tatimore të lësnuara nga organet kompetente, në rast se afati i vlefshmërisë së dokumentacionit të paraqitur përfundon para datës së miratimit të licencës.”;

l) Në nenin 12 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, togfjalëshi “*si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*si subjekt financiar jobankë ose si institucion financiar i mikrokredisë*”;

ii. pika 3 shfuqizohet;

m) Në nenin 13, pika 1, togfjalëshi “*si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*si subjekt financiar jobankë ose si institucion financiar i mikrokredisë*”;

n) Në nenin 14, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, togfjalëshi “*subjektit financiar jobankë, të institucionit financiar të mikrokredisë ose të institucionit të parasë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*subjektit financiar jobankë ose të institucionit financiar të mikrokredisë*”;

ii. në pikën 1, shkronja “a”, togfjalëshi “*subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike*”, zëvendësohet me



togfjalëshin “*subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokreditë*”;

iii. në pikën 2, togfjalëshi “*institucionit financiar të mikrokreditë ose institucionit të parësë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*ose institucionit financiar të mikrokreditë*”;

o) Në nenin 15, pika 1, togfjalëshi “*si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokreditë ose institucion i parësë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*si subjekt financiar jobankë ose si institucion financiar i mikrokreditë*”;

p) Kudo në nenet 16, 17, 21, 26, 27, 28 dhe 29, togfjalëshi “*subjekti financiar jobankë, institucion financiar i mikrokreditë ose institucion i parësë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*subjekti financiar jobankë ose institucionit financiar i mikrokreditë*”;

q) Shkronja “i”, e pikës 2, të nenit 21, shfuqizohet;

r) Në nenin 30, në pikën 1, togfjalëshi “*si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokreditë ose institucion i parësë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*si subjekt financiar jobankë ose si institucion financiar i mikrokreditë*” dhe në pikën 4, togfjalëshi “*subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokreditë ose institucionit të parësë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokreditë*”;

s) Kudo në nenin 31, shfuqizohen togfjalëshat: “*ose institucionit të parësë elektronike*”, “*ose institucione të parësë elektronike*”, “*ose institucion të parësë elektronike*”, “*ose institucioni i parësë elektronike*”, dhe togfjalëshi “*si institucion financiar të mikrokreditë ose si institucion i parësë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*si institucion financiar i mikrokreditë*”;

t) Pika 3, e nenit 32, shfuqizohet;

u) Kudo në “*Kërkesën drejtuar Bankës së Shqipërisë për dhënie licence*” (aneksi i rregullores), hiqet togfjalëshi “*i institucionit të parësë elektronike*”;

v) Kudo në formularin nr. 7 (aneksi i rregullores), fjala “*vendet*” zëvendësohet me fjalën “*mjediset*”;

x) Në formularin nr. 9 (aneksi i rregullores), togfjalëshi “*institucionit financiar të mikrokreditë ose institucionit të parësë elektronike*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*ose institucionit financiar të mikrokreditë*”;

y) Formulari nr. 10 (aneksi i rregullores) shfuqizohet.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2022.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 61, datë 24.11.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kreut II, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 21, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 2, pas pikës së fundit shtohet pika me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në nenin 21, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”.”;

b) Në nenin 7, pika 1, shkronja “c”, nën-pika “viii”, hiqet togfjalëshi me përmbajtjen e mëposhtme:

“sipas formularit nr. 12 (faqe 4), pjesë e kësaj rregulloreje”;

c) Në nenin 16 bëhen ndryshimet e mëposhtme:



i. Pika 1 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Banka, që kërkon të hapë degë, filial, agjenci ose zyrë përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, merr miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë dhe i paraqet një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për hapjen e një dege ose agjencie:

i. vendimin e organit vendimmarrës të bankës për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Shqipërisë;

ii. vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë, sipas rastit nga dega ose agjencia e propozuar;

iii. rregulloret e degës ose të agjencisë të propozuar, ku të përcaktohen veprimtaritë që do të ushtrohen;

iv. plan-biznesin për degën ose agjencinë për tri vitet e para të veprimtarisë;

v. shumën e kapitalit për t'u investuar jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës, si dhe shpenzimet e tjera operative;

vi. informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të degës ose të agjencisë, të shoqëruar me një përshtetë të shkurtër të kompetencave të tij/ tyre;

vii. parashikimin, nga ana e bankës, të rezultetit financiar të saj pas realizimit të këtij zgjerimi, si dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të bankës;

viii. strukturën organizative të degës/agjencisë, së bashku me numrin e punonjësve të propozuar;

ix. emërtimin e propozuar për t'u përdorur nga dega, që duhet të korrespondojë me emërtimin e bankës;

x. informacion për skemën e sigurimit të depozitave në vendin ku do të hapet dega;

xi. informacion mbi mjaftueshmërinë e rregullave dhe të procedurave të kontrollit të brendshëm dhe të funksionit të përputhshmërisë së bankës, për mbulimin e funksioneve të kontrollit të veprimtarisë së degës ose agjencisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

xii. informacion për kushtet ekonomike dhe politike të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të dega ose agjencia,

xiii. vlerësim të tipareve të sistemit bankar dhe/ose financiar të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të dega ose agjencia;

xiv. informacion për skemën e mbikëqyrjes bankare në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të dega ose agjencia.

b) Për hapjen e një filiali:

i. vendimin e organit vendimmarrës të bankës për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Shqipërisë;

ii. vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë, nga filiali i propozuar;

iii. rregulloret e filialit, ku të përcaktohen veprimtaritë që do të ushtrohen;

iv. shumën e kapitalit për t'u investuar jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës, si dhe shpenzimet e tjera operative;

v. informacion mbi mjaftueshmërinë e rregullave dhe të procedurave të kontrollit të brendshëm dhe të funksionit të përputhshmërisë së bankës, për mbulimin e funksioneve të kontrollit të veprimtarisë së filialit;

vi. plan-biznesin e filialit dhe parashikimin për ndikimin e zgjerimit të rrjetit në gjendjen financiare të bankës, për tri vitet e para të aktivitetit;

vii. informacion për drejtuesit kryesorë të filialit;

viii. informacion për identitetin, vendqëndrimin/ rezidencën ose selinë, si dhe të dhënat tregtare të vitit të fundit për çdo person që do të zotërojë pjesëmarrje influencuese në filial;

ix. veprimtaritë bankare dhe financiare që filiali parashikon të kryejë;

x. informacion për legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit, që zbatohen në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filiali;

xi. informacion për kushtet ekonomike dhe politike të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filialit;

xii. vlerësim të tipareve të sistemit bankar dhe/ose financiar të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filialit;

xiii. informacion për skemën e mbikëqyrjes bankare në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filialit.

c) Për hapjen e një zyre përfaqësimi:

i. vendimin e organit vendimmarrës të bankës për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Shqipërisë dhe për emërtimin e personit që do të drejtojë zyrën e përfaqësimit;

ii. vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë nga zyra e përfaqësimit e propozuar;

iii. rregulloren operationale të zyrës së përfaqësimit të propozuar;

iv. shumën e kapitalit për t'u investuar jashtë vendit (nëse është e aplikueshme), si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës, si dhe shpenzimet e tjera operative;

v. informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të zyrës së përfaqësimit, të shoqëruar me një përshtetë të shkurtër të kompetencave të tij/ tyre;

vi. parashikimin, nga ana e bankës, të rezultetit financiar të saj pas realizimit të këtij zgjerimi, si dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të bankës;

vii. kohezgjatjen e parashikuar të veprimtarisë së zyrës së përfaqësimit.”;



ii. në pikën 2, në paragrafin e parë, pas togfjalëshit “parashikuar në pikën 1”, shtohet togfjalëshi “, shkronjat “a” dhe “b”;

iii. pika 3 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për hapjen e një dege, agjencie ose filiali të bankës jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm kur krijon bindjen se pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, sipas shkronjës “a” ose “b”, të pikës 1 të këtij neni dhe bazuar në analizën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, janë plotësuar kriteret e pikës 2, shkronja “a”, të nenit 14 të kësaj rregulloreje.”;

iv. pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“3/1. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për hapjen e një zyre përfaqësimi jashtë Republikës së Shqipërisë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni.”.

d) Pas nenit 24/1, shtohet neni 24/2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 24/2

Kërkesat mbi agjentët

1. Në rastet kur banka, vetëm në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave, synon të ofrojë shërbimet e pagesave nëpërmjet agjentit, përveç sa parashikohet në nenin 21, të ligjit, “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë, edhe informacionin/ dokumentacionin e mëposhtëm:

a) informacionin sipas formularit nr. 16 të kësaj rregulloreje;

b) për agjentët, të ndryshëm nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial, që vërtetojnë se:

i. personi nuk është në ndjekje penale;

ii. personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii. personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);

iv. personi nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm (nga Zyra e Përbarimit Gjyqësor);

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.

2. Banka mban në dosje të veçanta, vërtetimet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, për administratorin dhe personat përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të bankës.

3. Kërkesat e parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme në procesin e licencimit të bankave dhe në rastet e agjentëve të rinj.”.

e) Pas formularit 15, shtohet formulari 16, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2022.

KRYETAR
Gent Sejko

ANEKSI 1

FORMULARI NR. 16

LISTA ME TË DHËNAT E AGJENTËVE TË BANKËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

Nr.	Emri i agjentit	NUIS (Numri unik i identifikimit të subjektit) / Nr. personal i dokumentit të identifikimit	Vendndodhja (adresa) e agjentit	Administratori i agjentit/personi përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave (emër, atësia, mbiemër)	Nr. personal i dokumentit të identifikimit të personave në kolonën (5)	Rrethi	Qyteti/ komuna	Kontakte (email, telefon)	Shërbimet e pagesave që do të kryejë agjenti ³							
									1	2	3	4	5	6	7	8
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)								

³ Banka përzgjedh me shenjë “X” shërbimin/ të gjitha shërbimet e pagesave, sipas pikave 1–8 të aneksit 1, të ligjit, “Për shërbimet e pagesave”, që agjenti do të ofrojë dhe që janë të përfshira në aneksin e licencës.



VENDIM

Nr. 62, datë 24.11.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN
DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT
DHE TË UNIONEVE TË TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; si dhe të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 5.10.2016, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 5, pika 2, hiqet togfjalëshi “një ose disa nga” dhe shfuqizohet shkronja “a”;

b) në formularin nr. 1 shfuqizohet nënpika e dytë, me përmbajtjen “të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave”;

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2022.

**KRYETAR
Gent Sejko**

VENDIM

Nr. 63, datë 24.11.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR KËRKESAT
MINIMALE TË SIGURISË NË
AMBIENTET KU KRYHEN
VEPRIMTARITË BANKARE DHE
FINANCIARE, DHE PËR
TRANSPORTIN E VLERAVE
MONETARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 70, pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 57, pika 2, 58 dhe 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; si dhe të nenit 61, shkronja “b” dhe nenit 65, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare, dhe për transportin e vlerave monetare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 1.6.2016, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 2, pas togfjalëshit “*“Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar,*”, hiqet togfjalëshi “*si dhe*” dhe pas togfjalëshit “*të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,*”, shtohet togfjalëshi “*të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave,”;*”;

b) në nenin 3, pas togfjalëshit “*degët e bankave të huaja*”, shtohet togfjalëshi “*institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike,*”;

c) në nenin 4, pika 1, pas togfjalëshit “*ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”*” shtohet togfjalëshi “*, në nenin 5, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave,”;*”;

d) në nenin 4, pika 2, shkronja “a” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:



“Agjent - ka të njëjtin kuptim me termin “agjent” të përkufizuar në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe me termin “agjent i institucionit të parasë elektronike” të përkufizuar në rregulloren “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”;

e) në nenin 4, pika 2, shkronja “i” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“ATM - (Automated Teller Machine) - ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në ligjin “Për shërbimet e pagesave”;

f) në nenin 6, pas pikës 5, shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Bankat, vetëm në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave, që kryejnë veprimtari me agjentë siç parashikohet në ligjin “Për shërbimet e pagesave”, janë përgjegjëse për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga këta të fundit.”;

g) titulli i kreut III, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Kërkesat minimale të sigurisë në ambientet e subjekteve financiare jobanka, zyra të këmbimit valutor, shoqëritë të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre, institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike, që kryejnë veprimtari me sportel dhe/ose me agjentë”;

h) në nenin 13, pika 1, pas togfjalëshit “shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, shtohet togfjalëshi “institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike dhe”;

i) në nenin 13, pika 2, pas togfjalëshit “zyrat e këmbimit valutor”, shtohet togfjalëshi “, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike”;

j) në nenin 13, pika 3, pas togfjalëshit “shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, shtohet togfjalëshi “institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike dhe”;

k) në nenin 13, paragrafi 5, pas togfjalëshit “shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, shtohet togfjalëshi “, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike”;

l) në nenin 13, pika 6, pas togfjalëshit “Subjektet financiare jobanka”, shtohet togfjalëshi “, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike”;

m) në nenin 15, pas togfjalëshit “ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, shtohet togfjalëshi “, në ligjin nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2022.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 64, datë 24.11.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 53, pika 4, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 55, të nenit 56, pika 2, të neneve 69, 124 dhe 125, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 29.8.2008, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 4, pika 2, pas shkronjës “d”, shtohen shkronjat “e” dhe “f”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“e) indeksi orientues” - përfaqëson normat ndërbankare të ofruara të interesit, të cilat publikohen nga autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuar për administrimin e tyre dhe/ose norma të tjera interesi që kuotohen në treg në mënyrë të vazhdueshme dhe janë transparente për publikun e gjerë e që njehsohen me normat e interesit të instrumenteve të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të vendeve të



ndryshme. Këto norma përfaqësojnë normat referencë që përdoren gjerësisht në çmimin e transaksioneve financiare;”;

“f) *klauzolë e ndryshimit të indeksit orientues*” - është parashikimi kontraktor i përcaktuar në kontratën e kredisë, e cila i jep të drejtë bankës të zëvendësojë indeksin orientues, në rastet e aplikimit të interesit të përbërë, nëse ndodh një ndërprerje e kuotimit të këtij indeksi orientues për monedhën e kredisë. Kjo klauzolë aplikohet vetëm me kusht që, nga autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuar për administrimin e indeksit, të ketë një përcaktim të qartë të datës së ndërprerjes së kuotimit të indeksit orientues për monedhën dhe zëvendësimin e tij me një indeks orientues alternativ të publikuar nga këto autoritete.

Banka e Shqipërisë publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, në çdo rast, burimin e informacionit (faqen zyrtare të internetit) të autoritetit rregullator apo të autoritetit të autorizuar për administrimin e indeksit, që publikon indeksin orientues alternativ përkatës;”;

b) në nenin 5, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

i. pika 9, ndryshon si më poshtë: “Bankat nuk ndryshojnë, pa pëlqimin e klientit, gjatë kohëzgjatjes së kontratës/marrëveshjes së kredisë metodën/metodologjinë e llogaritjes së normës së interesit dhe/ose elementet përbërëse të saj, penaltitetet në rast vonese/kamatëvonesat, si dhe çdo parashikim tjetër që e ngarkon klientin me kosto financiare, për të cilën/at është rënë dakord me klientët në momentin e lidhjes së marrëveshjes/kontratës së kredisë.”;

c) në nenin 7, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, shkronja “c”, hiqet togfjalësh “(norma e marrëveshjes së riblerjes e Bankës së Shqipërisë, norma e bonove të thesarit, libor, euribor, tribor)”;

ii. në pikën 1, pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “h” me përmbajtjen e mëposhtme:

“h) *klauzolën e ndryshimit të indeksit orientues*;”;

d) në nenin 14, ndryshohet titulli, i cili bëhet “Të fundit” dhe shtohet pika 3 sipas përmbajtjes së mëposhtme:

2. “3. *Klauzola e ndryshimit të indeksit orientues nuk zbatohet për marrëveshjet e kredive të miratuara, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, me përjashtim të rasteve kur banka merr masat e nevojshme për përfshirjen, me miratimin e kredimarrësit, të klauzolës së ndryshimit të indeksit orientues në marrëveshjet e kredive të lidhura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.*”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të

Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

KËRKESË
Nr. 559/4, datë 1.12.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 13.6.2013, ‘Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë–Elbasan’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 8,625 (tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Për pasurinë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personi që preket nga ky projekt, i cili ka emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në ARRSH, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 8,625 (tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA PARAPRAKE E PRONARIT, PASURIA PRONË PRIVATE E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 13.6.2013, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR TIRANË–ELBASAN”

Nr. rendor në VKM nr. 545/2013	Të dhënat për pronarin					Sip. shtesë për shpronës. (m ²)	Vlerësimet	Vlera (lek)	Vlera Totale (lek)	Shënime
	Emri i pronarit	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale		Çmimi (lek/m ²)			
18	Xhavit Abdulla Shaba	1170	126/39	Arë	340	23	375	8,625	8,625	Konfirmim ASHK (Shpronësuar me VKM-në nr. 545, datë 13.6.2013, për sipërfaqen 165 m ² . Referuar VKT-së nr. 57, datë 26.10.2017 dhe nr. 64/1, datë 7.6.2017, kërkohet për shpronësim sipërfaqja shtesë prej 23 m ² .)
Vlera totale paraprahe						23		8,625	8,625	

**KËRKESË****Nr. 560/4, datë 1.12.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Tiranë–Elbasan’ (shtesa)”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 439,450 (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasurinë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të

Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personi që preket nga ky projekt, i cili ka emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në ARRSH, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 439,450 (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni**



LISTA PARAPRAKE E PRONARIT, PASURIA PRONË PRIVATE E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 794, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “TIRANË–ELBASAN” (SHITESA)

Nr. rendor në VKM nr. 794/2015	Të dhënat për pronarin						Vlerësimet		Vlera	Shënime
	Emri i pronarit	zk	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip. shtesë për shpronës. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Totale (lek)	
10	Hysni Halit Sherifi	1997	127	Arë	2,600	935	470	439,450	439,450	Konfirmim ASHK (Shpronësuar me VKM-në nr. 794, datë 22.9.2015. për sipërfaqen 1365 m². Referuar VKT-së nr. 57, datë 26.10.2017 dhe nr. 64/1, datë 7.6.2017, kërkohet për shpronësim sipërfaqja shtesë prej 935 m².)
Vlera totale paraprake						935		439,450	439,450	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë